

BIBLIOTEKA

E

8JH-32  
HPI

SHTELT

GJIROKASTER

GENC HOXHA

Një mësuese  
në Larishtë

tregime



SIIH-32  
HPI

GENC HOXHA

Një mësuese  
në Larishtë

tregime



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

## Ara e vogël buzë xhadesë

Po afronte mesi i natës e në shtëpinë e Nexho Loparit drita rrinte ende ndezur. Së largu ajo dritë e vagëlluar kandili të bëhej se kërcente si xixëllonjë. Sa humbiste në njëren kthinë të shtëpisë, shfaqeji në anën tjetër, diku duke lënë pas errësirën e diku tjetër duke zbuluar loparin Nexho në prag të derës, nën hënë, me limë e drapër në dorë, pastaj dy të vegjlit futur në shtrojat e holla gjithë blana arnash, togun e kashtës së rrahur në hajat, pak më tej pellgun pranë pusit, ku njomeshin thekërishtet.

I vetmi njeri që vinte re lëvizjet e dritës dhe merrte me mend përgatitjet që bëheshin atje ishte Dalipi, djali i madh i fqinjtit. Atë natë Dalipi flinte jashtë në pllajë, me lopët, në këmbë të Nexhos, i cili kishte një jetë të tërë pajtuar lopar në fshat e mbante gjallë shtëpinë me hakun që merrte prej tyre.

Pati një çast që drita e kandilit as nuk lëvizi, as nuk u shua. E shoqja e loparit, një grua thitime, veshur me një fustan të zi dalëboje, pasi përkëdheli fëmijët në gjumë e u hodhi sipër fannellën e saj të leshtë, i shkoi të shoqit pranë.

Duket Nexhoja e ndjeu, se ngriti kokën drejt saj, mblodhi tok, në njëren dorë limën dhe draprin e mprehur dhe pyeti:

— Fjetën fëmijët?

— Fjetën qëkur, Nexho... Po ngrehu; merr dhe ti një sy gjumë, — u përgjigj ajo dhe i lëshoi pëllëmbën në sup. Ndërsa burri ndjeu ngrohtësinë e asaj pëllëmbe të vogël, gishtat eshtakë të gruas ndien djersën e tharë mbi këmishë.

— Po! thekërishtet a u njomën? — pyeti prapë ai.

— Gjer nesër gati janë, po nuk e di a do mjaftojnë, Nexho... Janë ca të holluara nga kalbja. Zbulova gjysmën e plevicës e mezi zgjodha një grusht.

— Po mushkën e Sefos e ushqeve?

— Aty më parë i mbusha grazhdin me kashtën e grurit që rrahëm sonte.

— U lodhe, moj e gjorë, pse nuk thua! — shtoi me sinqeritet Nexhoja dhe i përkëdheli pëllëmbën mbi supin e tij. Gishtat e tyre u pleksën për një çast si ato thuprat e lajthilë të sërenditura në gardh.

— Jo, Nexho; — tha e shoqja me gjysmë zëri dhe iu fsheh shikimit të tij. Ishte hera e parë që ajo nuk i fliste të vërtetën. Megjithëse nuk i fshehu gjë me rëndësi, fytyrën ia prushiti një valë e nxeh të, që i vërshoi nga gjoksi e iu ngjit përpjetë. Atë kohë Nexhoja ndjeu si u drodh pëllëmba e vogël brenda dorës së tij.

— M'i jep mua... — foli më të lutur e shoqja e i mori nga prehri limën bashkë me draprin e imprehur.

Pastaj gruaja kapërceu pragun, doli në oborr dhe i lëshoi mbi samarin e mushkës mbështetur pas gardhit. Që nga pragu Nexhoja e ndoqi me sy gruan, si hyri në ahur e doli duke shkundur kashtën e ngjitur në fustan, si nxori ujë nga pusi e nisë të lante llërët e përveshura, si derdheshin stërkalat e plaquriteshin në pellgun ku njome-

shin thekërishtet. Dhe ashtu, ulur siç ishte, i dha trupit prapa me krahët hapur anash që të shpihej. Vetëm tani, që mbaroi së mprehuri draprin e shkëmbët ato pak fjalë me të shoqen, ndjeu t'i kapiteshin sytë për gjumë. Ndjekja e lopëve nga pas gjithë ditën, mbartja e dy duajve nga ara, rrahja e grurit në havan, mprehja e drapërinjve... të gjitha këto kishin qenë një punë e mundimshme, e filluar që nga mëngjesi e deri në mesnatë.

Ara e tij e vogël buzë xhadesë ishte pjekur e para në fshat dhe kjo nuk ishte gjë e paktë për një shtëpi me hambar të zbrazët që në të dalë të janarit. Veç kësaj, edhe ai tani do të kishte çfarë t'u lëshonte partizanëve në sofër... Nga ai grurë që solli në kurriz dhe e rrahu në havan, atë natë e shoqja bëri bukë e ushqeu fëmijët. A nuk ishte ky shkaku që ajo nuk pranonte të thoshte se ishte lodhur?... Pastaj, edhe nëse lufta kishte hedhur në mal gjithë ata burra të Barbardhës, kishin mbetur aq të tjerë që t'i dilnin krah. Jahjai i pati dërguar të birin, Dalipin, që t'i ruante lopët, Sefja i mëhallës së «Diellit» i kishte dërguar mushkën. Bektashi me Belen (që të dy pleq) kishin ngulur strumbullar të ri në lëmin e përbashkët të fshatit, kurse Aloja, një javë më parë i kishte premtuar se grurin do t'ia bluanë në mulli pa i marrë hak...

Edhe Nexhoja u ngrit nga vendi të merrte një sy gjumë, megjithëse nuk ia kishte qejfi të futej brenda; ndoshta nga gëzimi i arës me grurë të mbarë që priste draprin, ndoshta ngaqë ishte mësuar të flinte jashtë me sy hapur, për të mos e gjetur ndonjë e keqe bagëtinë. Duke u capitur, hyri në hajat e u zgjat të merrte kandilin mbi parmakun e shkallës, ku e kishte lënë e shoqja. Po nuk arriti dot atje. Befas qëndroi në vend

e mbajti vesh. Iu bë se dëgjonte një shungullimë të largët që shëmbellente edhe si gjëmim i mbytur, edhe si bubullimë. Po nuk ishte as njëra dhe as tjetra. Nexhoja doli përsëri në prag që të mund të dëgjonte më mirë. Aty vuri re se nga ana e xhadesë shponin errësirën dy fasha drite dhe u kujtua se ajo që dëgjonte ishte uturimë makine. Gjumi i kapërceu aq shpejt, si të ishte send që mund t'ua hiqte syve me një të lëvizur të dorës. Gëzimi i dritës iu fshi në çast dhë mblohdhi duart grusht. Nexhoja e dinte mirë se këto lëvizje të ushtrisë italiane vec të këqija linin pas, ashtu si dinte që edhe partizanët u vinin hakut. Gryka e pérroit solli prapë uturimën, duke e pérplasur në faqen e bregut, në avllitë aty rrrotull dhe në muret e shtëpisë përdhese të Nexhos. Kjo e inatosi edhe më tepër. Me nofullat të shtrënguara, diçka foli e pështyu në gurët e kalldrëmit.

— Më the gjë, Nexho? — pyeti e shoqja, që po afrohej nxituar e duke fshirë duart e lagura me copat e fustanit.

— Jo, moj Shegane, joo. Ç'faj më ke ti... Shava atë kodoshen në xhade. — Ndërko'hë, në vrull e sipër ajo iu ngjit pas trupit dhe e shtyu brenda, si të donte ta mbronte nga ndonjë sherr që i kanosej Nexhos në oborr. Pastaj, si kuposi derën me një kërcu të madh sa një shkëmb, shoi kandilin me një frymë e hyri pas të shoqit në shtroja. Për disa minuta më dhomë ndiheshin vetëm frymëmarrjet e tyre të shpeshta dhe zhurma që vinte nga jashtë nëpërmjet hatullave. Nexhoja rrrotullohej më të majtë e më të djathëtë me mendje në xhade.

— Nexho! Fli, të kegen... Ç'i vë veshin asaj së mallkuare...

Që të mos e shqetësonte më shumë të shoqen, Nexhoja u shtir sikur flinte. Por ama veshin nuk

ia ndante uturimës. Kishte dëgjuar se një javë më parë në Lumas ushtarët italianë u kishin vënë zjarrin grunjérave tē arrira. «Po sikur tē ngulen nē xhade e nesér tē mos më lénë t'i afrohem arës?» Kjo pyetje po e shqetësonte qëkur. Një mendje i thoshte tē ngrihej nga rrobat e tē bënte poshtë. Ashtu nē mëdyshje, psherëtiu thellë e u ngrit ndenjur. Mendimet ia ndërpreu një zë i përgjumur fëmije: «Hoop, hop... Yaa... Yaa.» Ne-hos i sëmboi nē zemër ai zë.

— I gëzohen vrahut nē gjumë, iu bëftë nëna, — foli e shoqja, duke u shtyrë nē anën tjetër tē këndit. Lëvizi shtroja që mbulonte fëmijët.

— Shegane!... Pa mbaj vesh e dëgjo! Më duket se e thyen qafën, — lëshoi zë Nexhoja e kërceu nē dritare. Ajo arriti sakaq atje.

— Nuk dëgjohet gjë, — tha. — Sikur e përiu nata.

— Unë po vishem. Do tē zbres që sonte nē arë. Kot më shtyve nē rroba.

— Mos fol ashtu, tē keqen! Ç'është ajo tē zbresësh që sonte? — tha gruaja e drithëruar.

— Nuk rri, po më lësho, tē them! Nuk u zihet besë atyre kodoshëve, joo. Atje këmi bukën e fëmijëve, Shegane.

— Ooh, mos e thuaj atë fjalë, Nexho, mos... — thirri ajo e i zuri gojën me pëllëmbë. Në dhomë u bë zhurmë.

— Gdhiu mëngjesi, o babë? Ta zgjoj Lamin, ëë? — pyeti më i madhi i djemve përgjumësh, duke shtyrë mbulesat e duke fërkuar sytë. Atëherë burrë e grua u hodhën pér nga ata e i qetësuan si mundën. Pastaj Nexhoja, duke shfryrë e ngashëryer, u kthye nē shtroja. Kanati i drunjëtë i dritares u harrua hapur. Nëpërmjet saj hynin nē dhomë freskia e natës, drita e hënës, zukatja e insekteve dhe më rrallë një tringëllimë këm-

bore që Nexhoja e njihte mirë. Ajo tringëllimë këmbore, vinte nga ana e pllajës, ku Dalipi atë natë të ngrohtë ruante lopët jashtë. Për një shpirt të qetë e të patrazuar, të gjitha këto do të ishin të këndshme dhe do t'i ndillnin gjumë, ashtu si ndodhi vërtet me dy të vegjlit, që u krodhën në plot ëndrra të bukura për lëmin.

\* \* \*

Në të aguar Nexhoja u ngrit, nxori mushkën nga ahuri, i hodhi samarin e i dha ujë në një govatë lisi. Pas tij dolën dhe e shoqja me fëmijët. Të vegjlit, me të parë mushkën, u turrën drejt të atit me të lutura që t'i hipte sipër. Nexhoja u përkëdheli kokat e qethura, i mori hopa dhe i vendosi njërin pas tjetrit mbi samar, ku që më parë kishte shkurtuar shkallët e litarit për këmbët e tyre. Fytyrat e të katërve rrëzëllennin nga reflekset kuqërreme të agimit. Në sytë e të mëdhenjve trishtimi i natës kishte lënë gjurmë vetëm në gropëzat nën vetull, ku u dallohe-shin ca njolla të murrëtyera. Ata u vunë në radhë njëri pas tjetrit, dolën nga deriçka prej lese e bënë prapa shtëpisë përdhese mbuluar 'me plloca guri. Kur po i afroheshin lëmit, Nexhoja dalloi pranë strumbullarit dy sfurqe, një lopatë dhe një kandar, S'kishte dyshim se ato ishin lënë aty nga një dorë fshatari për vrahun që do të shinte Nexhoja atë ditë, veçse fshehur. Ai qëndroi mbi murin e lëmit e priti të shoqën të afrohej e ta pyeste. Po ndërkohë fëmijët pyetën më parë:

— Nënë, kush i ka sjellë ato?

Ajo u hodhi vetëm një shikim të shpejtë ver glave, pastaj ngau të shoqin me të qeshur:

— I bëre njerëzit me huqe, o Nexho. Po, që ta marrim vesh se kush i ka sjellë, rri e ruaj natën, pasi të futim grurin brenda. — Ajo fjala «rùaj», e thënë pa të keq, e bëri Nexhon që t'i ngrinte e qeshura në buzë. Tundi kokën lehtë e hoqi kapistrën e lidhur në bërryl, pa kthyer fjalë. Pas kësaj hapat zuri t'i bënte më të mëdhënëj e më të shpejtë. Zbritnin tatëpjetë të heshtur, duke menduar secili në mënyrën e vet pér zemërgjerësinë e bashkëfshatarëve, pér grurin, bukën e, më pak, pér atë uturimën e natës. Më poshtë, ku lisat anës rrugës ishin prerë pér të ngritur mullarë gjethi e linin shteg të zbulohet pllaja, Nexhoja dalloj lopët e përhapura në kullo-të tek e tek, sipas qejfit, sikur të mos kishin pasur njeri që t'i ruante. Një copë rrugë e bëri me sytë ngulur andej e pa shikuar ku lëshonte këmbët. Po Dalipin nuk po e ndeshte gjékundi. «Thua t'i ketë lënë vetëm Dalipi e t'ia ketë këputur gjumit në shtëpi», mendoi.

— Babë, o babë, — i bëri zë që sipër mushkës Lami. — A ka lulëkuqe ara jonë?

— Hii-hii, — qeshi i vëllai. — Lulëkuqe thotë ky!

— Ka, o, po cfarë, — ngulte këmbë Lami e ngiste me bërryl të vëllanë.

— Jo, — kundërshtonte i madhi. — Lulëkuqet i ka tharë vapa...

Nexhoja, që hiqte mushkën, nuk e kishte mendjen aty, ndaj dhe nuk po përgjigjej, ndërsa e shoqja qeshte me fjalët e tyre. Kur djemtë vunë re se i ati nuk po ia ndante sytë pllajës, lanë fjalët e diçka pëshpëritën midis tyre. Pastaj më i madhi i foli me të lutur e si me ankim:

— Babë!... Sot mos shko në mal se do të shij-më grurin. Aman, thuaji edhe ti, nënë... — Ndërsa Lami thirri: — Ja kështu, hoop, hoop, ya, yaaa,

— e rrahu me thembrat e këmbëve barkun e mu-shkës. Kafsha shkrofëtiu e trembur nga ngacmimi. E ëma flaku thekërishtet në anë të rrugës e i arriti para se të anohej samari. Nexhoja u kthyesh me të shpejtë mbrapa, shtrëngoi kapistrën e i përkëdheli krifën mushkës që turfullonte e hazdisur, po fëmijët nuk i qortoi. I porositi me të urtë që të mos bënin më ashtu e, veç kësaj, u premtói se do t'u bënte me copa litari nga një kamxhik që të ndiqnin mushkën në lëmë... Po, pa mbaruar fjalën dhe pa e cliruar kapistrën e mbështjellë turrë në dorë, kafsha hingëlliu, zgjati veshët mbi supin e tij me sytë e xhamtë të hapur jashtë mase. Mbi rrugë dëgjoheshin hapa të nxituar e fëshférinin gëmushat. Të gjithë kthyen kokat an-dej e pritën ikush do të shfaqejet. Ishte Dalipi. Ky kërceu nga mezhda në rrugë, i mbuluar në djersë, mbushur kokë e këmbë me rrodhe, aq sa mezi njihej.

— Po ti, more... A kështu ruhen lopët? — iu kanos Nexhoja.

Dalipi me atë vrull i shkoi pranë e i rrahu supin. Tjetri kujtoi se Dalipi deshi ta merrte me të mirë dhe gjithë inat ia shtyu dorën.

— Do të krisë... Nexho... Për kokë të babait... që do të krisë sot, — fliste e gulçonte Dalipi. Burrë e grua filluan të shihnin njëri-tjetrin pa marrë vesh gjë. Edhe fëmijët u përkulën mbi samar e mbanin vesh të dëgjonin për atë që do të kristë.

— U hoqa rrugë partizanëve, Nexho. I nxora shkurt gjer në Gurin e Përgjegjur. Atje zunë pri-të, — u shpjegua Dalipi me një frymë, i gjëzuar aq, sa edhe syfë i flisnin. — Kaq mora vesh unë. Tashti ika të mbledh lopët. — Tha kështu e ka-përceu në anën tjetër të rrugës, si ata djemtë e

rinj në ditë dasme, që nxitojnë me vrap të japid sihariqin: «Erdhi nusja!»

Nexhoja deshi t'i bënte zë të qëndronte, por ishte vonë. Dalipi u humbi nga sytë.

— Mban larg që këtej ai Gur i përgjegjur? — pyeti e shoqja me kureshtje.

— Ndonjë orë, — tha Nexhoja, duke përfytyruar atë vend të zgjedhur me meraik. — Tamam vathë. Shegane... Mirë u ka rënë ndër mend.

— Do bëhet luftë, babë?! Do ta shohim ne? — pyeti më i madhi i djemve.

— Jo, do ta dëgjojmë, — tha Nexhoja dhe u shqetësua, kur mendoi se poshtë në xhade mund të kalonte ushtria e huaj. Megjithatë u nisën. Qindra metra më tutje, tej vijës së mullirit të Alos, u shfaqën në xhade ca njolla të murme, të mëdha e të vogla. Ajo që dallohej më mirë, ishte një kamion i mbuluar me mushama. Rreth kamionit lëviznin ushtarë me helmeta. Nga bërryli i xhadesë dolën edhe të tjerë, duke bërë një karvan të gjatë. Ata ishin larg e zërat nuk arrin të plotë, po, nga lëvizjet dhe zallahia që bëhej atje, kuptohej mirë se nxitonin. Shumë prej tyre kacavirreshin mbi spondin e prapmë e humbisnin në barkun e mushamasë.

— Qenkan għidher këtu, të mallkuarit! A i sheh, moj grua?! — lëshoi zë i habitur Nexhoja e qëndroi në vend njéheresh, sa hundët e mushkës u ngjeshën në shpatullat e tij. E shoqja doli përpàra e i ndenji në kraħ. Vuri dorën si streħe mbi ballë dhe përfshiu me sy kamionin, kafshët dhe ushtarrët e huaj.

— Po tashti, Nexho? — tha e drithëruar e i shtrëngoi dorën të shoqit me frikë.

Mbi mushkë fēmijet qasurin e ngiteshin me njéri-tjetrin, pa pyetur pér shqetësimin e prindërve. Ata mbanin mend fjalët e Dalipit, që kishte

thënë «do kërcasë» e prisnin veshëngritur të dëgjonin. Vetëm kur kamioni u ndez e shungullooi zhurma e motorit, ata u shtangën. Edhe mushka u tremb, po nuk i shpëtonte dot nga dora Nexhos. Para se të nisej kamioni, një motoçikletë kaloi me shpejtësi anës xhadesë, ku ishte vargosur karvani i ngarkuar rëndë me lloj-lloj hekurish-tesh, që vezullonin në rrezet e diellit. Ndërkokë u dhanë atje dhe tre kamionë të tjerë.

— C'bëhet kështu, Nexho? Nga mbinë këto të mallkuara? — tha e shoqja.

— Ububuuuu, sa frikë që kam, — u ankua Lami. — Kthehemë në shtëpi, baba.

— Jo, baba, joo, — tha më i madhi.

— Fushoniii! — shfryu Nexhoja i nxehur, duke i lëshuar së shoqes kapistrën në dorë.

— Prit, Nexho... mos, të keqen. Le të thyejnë qafën njëherë, pastaj, — dhe e përfshiu për krahu. E mbajti kështu derisa autokolona u fsheh prapa kthesës. Pastaj u nisën. Nexhoja parandiente diçka të keqe, po goja nuk ia nxinte t'ia thoshte gruas. Shahej me veten që atë natë kishte mbetur në shtëpi, në vend që të gdhihej në arë. Tërë vitin i kishte ndenjur arës mbi kokë, që kur mbiu fara e derisa u poqën kallinjtë. Edhe se lopët duheshin ndjekur pas, ai kishte gjetur kohë t'i qëronte barërat e liga, i kishte hapur vija që të mos e gërryenin ujérat, i kishte zënë shtigjet një më një që të mos ia shkelnin kafshët e egra.

Në këtë e sipër ranë në përruan e thatë e dolën në xhade. Nexhoja hoqi draprinjtë nga samari, i dha së shoqes të sajin, ndërsa të vetin e nguli në jakën e xhaketës prapa qafës. Së largu, mbi xhade, zverdhonte ara, si një rrugoz i ri mës dushqeve të krasitura. Hap pas hapi iu afruan, kapërcyen hendekun e ranë në lëndinë. Ndërsa e shoqja ulte fëmijët nga mushka, Nexhoja mbësh-

tolli litarin dhe e lidhi fundin e tij pas një kulumaku. Pastaj me një frysme zuri të ngjitte të përpjetën e shtegut që ishte shkelur rishtas nga dhjetëra gjurmë potkonjsh, si të kishin futur par mendën. Ato gjurmë bënë që t'i therrte në zemër. Me sa dukej, e keqja ishte bërë. U dha në buzë të arës. Shtegu me gjembaçë ishte spastruar. Gruri ishte bërë lëmizhde, shkundur përdhe e pa kallinj. Arës i kishte mbetur për nishan vetëm kashta. Nexhoja nuk mundi t'i mbante lotët që i rrodi hën faqeve e iu bashkuar në mjekër. Bukën e fëmijëve e kishin ngrënë kafshët e ushtrisë së huaj. Ata që kishin mbetur në lëndinë, nuk dinin gjë ende. Dy të vegjlit ishin ulur këmbëkryq ballë njëri-tjetrit e hanin mëngjes me bukën e mbetur, që në mbrëmje. Mbi copat e bukës e ëma u vuri edhe pak djathë. Ajo nxitonte të mbaronte punë me ta e të shkonte të korrtë pas Nexhos. Aty u afrua edhe mushka. Lami këputi ca fije bari të thatë e ia zgjati duke i thënë:

— Ha, Gjesë, se do të lodhesh sot. Do të shijmë grurin.

Po mushkës më shumë i pëlqeu të lëpinte pëllëmbët e fëmijës, të kripura nga shëllira, sesa barin e thatë. Gruaja u mat t'i bënte zë të shoqit, që të zbriste edhe ai të merrte ndonjë kafshatë bukë. Po fjala i mbeti në gojë. Nexhoja kishte ngrirë në këmbë buzë arës e rrihte me kurrizin e draprit pëllëmbën e dorës. Ai nuk i foli, por i bëri shenjë më kokë të ngjitej atje. Ajo diçka parandjeu. La në bohçe copën e bukës që kishte ndarë për të dhe u ngjit me një frysme.

— Ç'ke kështu, Nexho? — pyeti ajo dhe menjëherë pas kësaj lëshoi një klithmë të dhimbshme kur pa gjëmën. I shoqi e rrroku për beli, pa e lënë të rrëzohej në tokë, e foli:

— Na iku nga duart buka e fëmijëve, Shega-

ne. Na e shkelén... Na e hëngrën me kafshë, kodo-shët! — Duart e tij ndérkohë po njomeshin nga lotët e gruas. Ajo kishte filluar të qante me ngashërim: mallkonte fashistët me shpirt e bluante në duar ca fije kashte.

— Mbaje veten, Shegane, — i lutej ai. — Mjaft kështu... Tashti léri lotët e më sill djemtë këtu!

Gruaja dëgjoi ato fjalë e ngriti kokën ta shikonte. Sytë e saj pyetnin të habitur: Si do të mund ta duronin fëmijët atë pamje?

— Më sill djemtë, të thashë! — tha Nexhoja i vendosur dhe e hxori në shteg gati me të shtyrë.

— Jo, Nexho... Nuk éshtë mirë ta shohin... Mos ua prish gëzimin, — i lutej ajo, duke u shkrirë në vaj. Po Nexhoja nguli këmbët në të vetën.

— Duhet, duhet, Shegane, — tha ai dhe i rrahu shpatullat e dobëta me pëllëmbë.

Fëmijët, njëri pas tjetrit, ngjitën të përpjetën e qëndruan para të atit me gojën plot e duke u përtypur. Nexhoja u përkëdheli kokat, ashtu si kishte bërë në mëngjes, kur i hipi në mushkë. Pastaj i futi në arë. Duart e tij vazhdonin t'i përkëdhelnin duke u dridhur, ndërsa buzët nuk po i bindeshin të nxirrin asnjë fjalë. Më tej qëndronte e shoqja, me kokën ulur, pa guxuar t'i shihte djemtë në sy; ajo priste të dëgjonte ç'do të thoshte Nexhoja.

Fësh-fësh, bënин zhurmë këmbët e tyre duke shkelur kashtën e thatë. Nga ajo zhurmë zemra e nënës u drodh. Hyri edhe ajo në arë t'i arrinte e t'i rrëmbente të vegjlit, po ndérkohë foli Nexhoja:

— Shikojeni arën tuaj, o djem e... mbajeni mend. Ushtria e huaj na e hoqi bükën nga goja, — fliste ai me zë të lartë dhe, duke u përkulur,

mbushte duart me kashtë. Fëmijët dëgjonin të shtangur, pa e kapërdirë dot bukën e përtypur. Kishin ngritur kokat e vogla e me sy të picërruar shikonin të atin në gojë. Atë çast ata kishin harruar lëmin, mushkën dhe kamxhikët që porsa u kishte premtuar ai.

— Por unë do ta mbjell prapë e do ta ruajmë bashkë, o djem, — shtoi befas Nexhoja.

Pas këtyre fjalëve fëmijët iu ngjeshën Nexhos pas trupit e i përkëdhelën dorën që mbante draprin. Ndërkokë, përtej koriges, nga ana e Gurit të Përgjegjur shungulluan të shtëna.

— Krisi, baba! Krisi! — thirri Lami. Të gjithë njëherësh u kthyen andej nga vinish kismat e armëve.

— Partizanët po marrin hak edhe pér ne, — tha Nexhoja dhe ngriti fëmijët në krahë, lart, lart, me sa mundte, që ata të shihnin më mirë.

## Djemtë e qarkorit

Shtëpia e Met Repishtës ngrihej në prehër të korijes, pak e veçuar nga shtëpitë e tjera të fshatit. Tre veta ishin nisur për atje e ende u kishte mbetur edhe një copë e përpjetë.

Ai që hiqte rrugën, dukej se e njinte mirë vendin, se herë-herë ngadalësonte hapat e u lëshonte zë dy të tjerëve që dihatnin të lodhur.

— Këtu... kujdes, éshtë rrëpirë dhe...

— Nëma dorën mua... ashtu, kérce. Nëma dhe ti tjetri... Hopa... — Në këtë mënyrë ata u shmangeshin edhe vendeve të ngritura, edhe gropave të mbushura rrafsh me dëborë gjatë shtegut.

Kërt-kërt, ngjishej dëbora e butë nën këmbët e tyre e, sa më lart ngjiteshin, aq më mirë dallonin gjithë dritat e vagëlluara që deri më parë pengoheshin nga avllitë. Një qetësi e akullt ndehej përreth, aq sa të bëhej se në fshat nuk kishte mbetur frymë njeriu. Po nuk ishte kështu. Atje ku ishin dritat, njerëzit ishin mbledhur pranë zjarreve e shpinin gjymtyrët e mardhura nga të ftohtët e dimrit. Kishte një javë që lufta ishte shtyrë larg e rrallëherë gjer këtej arrinte të dëgjohej ndonjë shungullimë e mbytur artilerie, që ngjante si gjëmim.

Me të zbardhur dita, fshati do të gjallë-

rohej përsëri. Burrat do të shtynin me sup dyert e mbërthyera pas pragut nga ngrica e natës e me lopatat e drunjta të lëmenjve do të pasttronin dëborën e oborreve. Gratë do të ndiznin furrat e do të shtinin bukët e mbrujtura që në mbrëmje. Ndërsa fëmijët do të mblidheshin me potere e frymën do ta mbanin në komandën e vendit, për t'iu gjuar pushkëve të partizanëve që u vetëtinin tytat.

Ata të tre, pasi i erdhën qark një shkëmbi të madh që shërbente si mur avllie, e shtynë derikën e thurur me purteka, hynë në oborrin e Met Repishtës, një plaku të mirë e të vuajtur, që jetonte vetëm me të shoqen.

— Ja, këtu do të qëndroni sonte, — tha njëriu që i kishte sjellë aty. Pastaj u shty më tej, rrëzë murit, e qëndroi përpara ca të çarave të ngushta si të prera nga tehu i një thiike, nga të cilat mezi dallosheshin ca shirita drite që zgjatoshin mbi dëborë.

— Met... O Met Repishta, — thirri ai e goditi lehtë me noçkat e gishterinjve në kanatin e dritares.

Në çast një zë i trashë burri u përgjigj që brenda:

— A ti, Mero kryetari, je, aaa?

— Unë jam, unë... Se ai adashi im i hëngri të së... Atë kokë kishte, atë festë i vunë, — ia pati që jashtë ky me ballin mbështetur në kanat.

— Po shqyr, o, se u bëre për të lyer me miell... — u dëgjua të thoshte me shpoti Met Repishta.

Dy të tjerët rrinin mënjanë, me jaka të ngritura, duke përplasur këmbët që u thernin nga të ftohtët. Që atje ndiqnin me sy, si humbën shiritat e dritës e si pak më vonë u shfaqën më



tej, duke mbuluar një pjesë të oborrit. Në derë u dhà i zoti i shtëpisë, me një xhaketë të mballosur, duke i mbajtur dorën si strehë fitilit të kandilit. Kur ndeshi me kryetarin e këshillit e pas tij nuk dalloi ndonjë tjetër, Met Repishta ndërroi ménjëherë jo vetëm në zë, por edhe në çehre.

— Po prapë vetëm ti, ooo? O po ta dija... — filloi t'i hakërrohej.

— Kësaj radhe, si ta do zemra... — ia preu fjalën tjetri e u hoq praptazi. — Ja ku t'i kam miqtë, — tha e bëri me dorë nga ata të dy.

— Po ashtu thuaj, o kryetar vëllai... — lëshoi zë Met Repishta dhe, ende pa dalluar mirë kush ishin e sa ishin, kapërceu pragun e thirri në drejtim të derickës:

— Urdhéróni, shokë, urdhëroni brenda, se ju mori frymën dëbora. — Nga vrulli që mori, kandili u shua.

— Ptuuu, e flamosur, — shau i nxehur e në errësirë u përqafua me miqtë.

Ndërkohë kryetari i këshillit shkrepit çakmakun e kandili u ndez përsëri. Met Repishta mundi t'i shquante më mirë të porsardhurit e shtangu. Miqtë nuk ishin partizanë, po dy djem të rinj të veshur qytetarçe e duarbosh. Një gjë të tillë e kishte ndier që kur i përqafoi, por nuk donte ta besonte. Mori inat me kryetarin e nuk e kuptoi as vetë si u përbajt. Në hajat i lëshoi së shoqes kandilin në dorë dhe priti sa ajo i futi djemtë brenda. Kryetari i këshillit, që ishte ndarë që jashtë me ata, i rrahu supin plakut e u mat të largohej. Po tjetri i preu rrugën.

— Bukur, besa.. A kështu e kishim fjalën, aaa?

— pyeti gjithë nerva. — Të thashë më sill partizanë... Do të të sjell më the... Po... — Jashtë ishte errët e Meroja nuk mundi të dallonte ç'spreh-

je i kishte marrë fytyra bashkëfshatarit. Po, nga vrazhdësia me të cilën ishin thënë ato fjalë, kuptohej qartë se Met Repishtës i kishte mbetur hatri keq.

— Shëët, — bëri ky me frikë, që ata brenda të mos dëgjonin ndonjë kërcu të plakut. Pastaj iu afrua e i foli nën zë:

— C'ke, ore, që merr zjarr? Edhe këta të lufftës janë. Para një ore erdhën me një letër të Qarkorit... për komandën e vendit. Dhe ti e di që ata kanë zbritur në fshatrat e Rrëzës për atë punën e gjyqit.... Fundja si të duash. I marr vetë dhe ja.

Met Repishta pshërëtiu i turbulluar e i ktheu krahët kryetarit të këshillit. Sikur gjithë natën të hahej me të, nuk do të nxirrte gjë. Të nesërmënen po. Kishin ditën përpara e le ta shkoqiste atë punë. E ç'faj kishin ata brenda! Me duart që i dridheshin nga inati, po i vinte llozin derës e mërmëriste me vete:

«Por ama, që këshilli të lahet me këtë radhë e të më thotë se edhe ty të zgjodhën si bazë, nuk do të pranoj kurrë. Ku partizanët e ku këta djemulinj... Po, do të më thonë që të ruajmë mos rëndohesh. E përse të mendojnë kështu? Mos vetë Mero kryetari, Demiri... Sefja i Goxhajve... janë më mirë.. Të gjithë një ferrë na ka çjerrë, veç zemrën ta kemi të gjerë. Këtë duan edhe partizanët»...

Në dhomën përdhese zjarri ishte rritur në vatër e flakët ngjiteshin përpjetë të harbuara. Met Repishta vuri opingat përfund derës dhe u ul në këndin e krahut të djathtë, mbi një postiqë të rrjepur. Tani përpara kishte dy djemtë e rinj, që zunë vend rishtazi, pasi ishin ngritur në këmbë për respekt të tij. Njëri vinte më i gjatë në trup e i hequr në fytyrë. Tjetri flokëzi, me

faqe tē mbushura e me një kasketë lëkure që e mbante në kupë tē gjurit për ta terur. Rrobat i kishin tē lagura e fundet e pantallonave, që i mbanin pranë zjarrit, u lëshonin avull. Nebija, e shoqja, një grua fytyrëverdhë, veshur me një triko leshi tē zezë, erdhi e varri në çengel një kusi. Mbi ujin e kusisë dilnin ca patate tē mëdha si popla, me siguri tē ruajtura mënjanë qëkur për një natë si kjo. Pastaj doli prapë e solli nga hajati një krah dru tē thata.

— Dimër i madh ky, — theu heshtjen Met Repishta e shtriu duart gjithë damarë, tē trashë e tē murrietyer në drejtim tē flakëve,

— Ju këtej e paskeni hedhur dimrin... Ndërsa ne andej..., — ia pati djali me kasketë, duke e parë në bebe tē syrit tē zotin e shtëpisë, që deri atëherë vetëm një gjë kishte bërë: I kishte hetuar nën vetullat e trasha ngjyrë piperi, si tē donte t'i peshonte.

Met Repishta nuk e pati tē vështirë ta kapte se ku qëlloi ai djalë dhe vetëtimthi i erdhën ndër mend fjalët që i kishte pëshpëritur në vesh kryetari i këshillit: «Edhe këta tē luftës janë.»

— Ashtu vërtet... atë dimër që zure në gojë ti...

— Azem, ma thonë, — plotësoi djali e ukthye më mirë nga plaku.

— Ta gëzosh, — tha Met Repishta, — po ty?...

— Mevlan Shkaba, — u përgjigj gjatoshi, që trazoi zjarrin me një urë tē ndezur që shkumëzonte përfund.

Plaku thithi tymin e duhanit me gjithë mu-shkëri e, duke shkundur hirin e cigares në plloqën e vatrës, foli:

— Atë dimër ne e hodhëm që ç'ke me tē dhe e shtymë tutje. Tashti në vend tē komunës kemij

komandën e vendit e marrim frymë lirisht. Por as më thoni, o djem, si ju solli rruga këtyre anëve në këtë kiamet?

Met Repishta deshi të thoshte: «Kështu duarbosh e të veshur tebdilçe», por e mbajti gjuhën e nuk e shtyu fjalën më tej.

Djemtë shkëmbyen vështrimet me njëri-tjetrin dhe nuhatën aty për aty se plakun e hante një merak, ndaj u kishte qëndruar disi i ngrysur gjer atëherë. Në pamje Met Repishta u dukej njeri i vuajtur e i shtruar, po diçka të sertë ruante ai njeri me ata 60 vjetët që kishte mbi vete e që ia tregonin qartë edhe thinjat, edhe rrudhat, edhe kërrusja e trupit.

— Lufta, xhaxha, lufta, — u përgjigj Mevlani, duke i theksuar fjalët. — Pastaj edhe neve sikur na deshi qejfi të ngjitemi malit. Edhe Qarkori kështu mendoi.

«Qarkori», përsëriti plaku me vete. Këtë fjalë ia kishte përmendur edhe kryetari i këshillit në prag të dërës.

— More, kush është ky Qarkori? Se unë përvete..., — tha e u përtyp si e si të gjente ndonjë fjalë tjetër.

— Qarkori, xhaxha, është shtabi i Luftës në qytet, bille edhe për të gjithë qarkun, — shpjegoi Azemi.

Mevlani nga ana e tij pohoi me kokë e ndërhiri që plaku ta kuptonte më mirë atë që po i thoshin.

— Ju në fshatin tuaj keni komandën e vendit, kështu?

— Po, e kemi, — u përgjigj Met Repishta i përqendruar me të gjitha shqisat për të mos i shpëtuar asgjë nga ato që po dëgjonte.

— Edhe kjo komanda juaj ka në krye një shtab që drejton, apo jo? — shtoi Mevlani, duke

bërë ca shenja me thëngjill në plloçën e vatrës.

— Unë për vete di që në krye ka Partinë, — u hodh i nxehur Met Repishta e u shty pas murit. Vetullat e trasha iu bashkuani rrudhat sikur iu thelluan më tepër në ballë. Që nga këndi futi dorën në kamaren që kishte në krah e nxori që andej një shuk letra e ua lëshoi në prehër dy të rinjve.

— Unë për vete s'kam haber nga shkronjat, — tha po me atë vrullin e parë plaku. — M'i lexon nipi i vogël sa herë që m'i sjell... thonë apo nuk thonë në fund: Partia. Edhe Ligori kështu tha, kur varrosi të birin, para fshatit: Djalin ia fala Partisë... Ashtu de... — turfullonte plaku e mezi mbushej me frymë, pa u lënë radhë djemve të flisnin.

— Ne këtej s'kemi dëgjuar të dalë ndonjë tjetër mbi Partinë. E në daltë, le të matet po të dojë!

Mevlanit dhe Azemit iu bë qejfi që plaku ngulte këmbë në të tijën, paçka se, po të vazhdonte ashtu me atë inat, nuk do të ndaheshin mirë.

— Ke të drejtë, xha Met, ashtu është, po ne e kishim fjalën te Qarkori. Edhe kjo është një degë e Partisë. Ja, si të ta them. Trupi është Partia, por trupi ka edhe gjymtyrë, — filloi të shpjegonte Azemi duke lëvizur me duar.

— A, kështu ndryshon puna, o i uruar, se gjesh më latë pa mend, — tha Met Repishta e zuri vend mirë këmbëkryq.

— Medemek Qarkori drejton luftën në qytet. Po ju atëherë me se luftoni? Se ndryshe këtej maleve, ku ia bën bamb e të kafshon plumbi.

— Po mjaft, o burrë, mjaft, se i lodhe djemtë me të gjykuar, — u hodh e foli e shoqja, që gjer

atéherë vetém kishte dëgjuar pa u ndier. — Ja, nesér vishen partizanë dhe...

— Rri, moj ti, se ne muhabet po bëjmë, — ia pati plaku e filloi të dridhte një cigare tjetër.

— Po nëse pyes, ç'të keqe ka, eëë? Shih në u zien patatet e na nxirr të përtypim nga njëzë.

Në zjarr kusia po valonte me të madhe, duke lëshuar stërkala uji mbi prush. Nebija u ngrit, hoqi me kujdes kusinë e shkoi t'i zbrazte në një tepsi bakri në fund të dhomës.

— Mirë e ke ti, xhaxha, që pyet... po a ke dëgjuar se kush i shtyp e i shpërndan këto komunikata që na i tregove, — tha Mevlani, duke i vënë palë-palë mbi njëra-tjetrën, — se kush ia hedh në erë depot armikut, se kush ua nxjerr në pritë autokolonat partizanëve, pastaj se kush i qëron spiunët?

— Komunistët, lëshoi zë Met Repishta i vendosur. — Kjo dihet...

— Ashtu është... Ata janë në ballë, — ndërhyri Azemi e i qeshi Mevlanit si të thoshte: «Hëéëhëë. S'të lëshoka pe xhaxhai kur është fjala për Partinë dhe komunistët.» — E pastaj shtoi: — Po ata nuk janë vetë. Pas tyre punojnë e luftojnë qindra të tjerë.

Met Repishta tundi kokën lehtë dhe zbërtheu kopsën e këmishës. Kuh-kuh, u kollit e si padashur i shpëtoi pyetja:

— Po ju... A jeni komunistë? Them... meqë më numëruat gjithë ato gjëra...

Djemtë u panë sy më sy e 'ngurruan të përgjigjeshin, jo se do të nxirrin ndonjë sekret e druheshin nga plaku, por se u vinte zor të mburreshin me atë emër që Met Repishta e kishte për zemër. U skuqën njëherësh e po rrinin në mëdyshje, pa folur.

— Grua! Mjaft me ato rrangalla se na bëre

zhurmë! — iu kanos plaku që nga këndi. Pastaj prapë i yshти djemtë t'i përgjigjeshin.

— Nuk më thatë gjë, more djem.

— Mevlani komunist është, — tha Azemi.

— Medemek... ti, Mevlan, qenke komunist. Shumë mirë, djalë, shumë mirë, e t'i rrosh Partisë! — tha plaku e i ra lehtë në gju me pëllëmbë.

Pas kësaj ishin djemtë që hetonin me vëmendje fytyrën e Met Repishtës. Ato rrudhat e thella të ballit dhe të faqeve përnjëherësh sikur ishin fshirë nga një dorë e padukshme e mbi to ishte nderë një prush i kuq.

Nebija po përgatiste darkën më tej, e heshtur, duke lëshuar mbi një tepsi ca thela bukë e një rrrotull të vogël djathë, që bashkë me patatet e ziera do t'u shijonin djemve të lodhur nga rruga.

— T'jua shtroj darkën? — pyeti të shoqin.

— Prit sa të mbaroj këtë cigare, — iu përgjigi plaku nxituar, pa e pasur mendjen aty. Në një rast tjeter puna e parë që duhej të bënte ishte të pyeste miqtë, por ai nuk bëri kështu. Dicka e brendshme e shtynte të pyeste përatë.

— Ti duhet të dish patjetër, o Mevlan.... A është e vërtetë vrasja e një Mero Lupi... Meqë je...

— Tani vrasja e tij ka marrë dhenë e nuk e dinë vetëm komunistët, o xha Met, — u hodh e foli Azemi, duke i buzëqeshur çiltër.

Nebija, me të dëgjuar atë emër, erdhi gjithë vrull e zuri vendin e parë, midis djemve, të mbante vesh.

— Fol ti, Mevlan, se ke qenë vetë në atë aksion, — i pëshpëriti Azemi e i ra me bërryl shokut në ijë.

— Tregona, të keqen, tregona si u qërua ai i nxirosuri, — foli Nebija si me të lutur.

— Po hë, more djalë!... Si e vunë në nishan, eëëë? — pyeti plaku me cigaret e trashë harruar në cepin e buzës.

Mevlani psherëtiu lehtë, ngaqë i vinte zor të tregonte për vete. Por, meqenëse ata ngulnin këmbë, e për më tepër, kur dalloj se diçka më e madhe shprehej në sytë kureshtarë të dy pleqve, filloi:

— Partia kishte marrë vendim me kohë për vrasjen e tij, po Mero Lupi ishte dhëlpër e ia kishte ndier erën së keqes. Por edhe, ne, ama, në gjurmë i rrinim.

— E pastaj? — tha plaku duke mbajtur me zor kollitjen që i erdhi në fyt.

— Po do ti, — vazhdoi Mevlani, — na vjen një ditë një mjek yni e na thotë: «Nesër Mero Lupin e keni peshqesh tek unë. Nuk di se çfarë ka, po do të vijë të vizitohet në ora 12». Ne kaq deshëm. U bëmë gati pesë veta.

— Dy prej tyre shoqe, thuaj, — ndërhyri Azemi.

— Po, në njësit kishim edhe dy vajza, — tha Mevlani.

— Trimat e nënave! — s'u përmbajt Nebija dhe hodhi sytë nga i shoqi me habi.

— Ato, mos harroj të them, ishin ngarkuar t'i binin pas Mero Lupit kur të dilte nga shtëpia e të hetonin në e ruanin më shumë veta nga sa e mendonim ne. Unë për vete kisha zënë kreun e rrugës, nga do të tërhiqej Shaba, që priste jo shumë larg shtëpisë së doktorit tonë. Ndërsa një shok tjetër, me një karrocë ngarkuar me qymyr, priste më tej e gjoja merrej me thasët.

Met Repishtës i silleshin ndër mend lloj-lloj kujtimesh nga peripecitë e tij e nuk ngopej së

dëgjuari. Nebija në mënyrë të pavetëdijshme bënte po ato lëvizje, me duar e me mimikë, si Mevlani. Asaj i rrihte zemra harbuar e me sytë e mendjes shihte përpara Mero Lupin të shtrirë përdhe.

— Kur ja, Mero Lubia, kështu ia kishin ngjitur nofkën në qytet atij, u dha vetë i tretë, veshur me rrobat e oficerit, ngjeshur me rripa për mesi e me grada të verdha mbi supe. Çehren e kishte të vrarë më shumë nga frika e më pak nga sëmundja, që nuk arritëm ta merrnim vesh, — tha Mevlani e qeshi. — Përpara i ëdel Shaba është ia numëron në kokë, në gjoks e ku mundi, pesë plumbë me radhë. Horrat, që kishin detyra të ruasin, s'u bënë burra, por ia mbathën ku sytë këmbët me lebeti.

— E pastaj? — pyeti Met Repishta i ngazëllyer.

— Pastaj ne u tërroqëm sipas planit që kishte bërë njësiti guerril. Shaba erdhi me mua e avlli pas avllie shkuam në bazën tonë. Tani mua dhe Azemin jà ku na ke.

— Po Shaba ç'u bë? — pyeti Nebija, si e qëndruar nga një ankth.

— Atë Qarkori e nisi që të nesërmendiku gjetkë në mal, — tha Mevlani.

— Ju lumtë dora, more djem, se paskeni qëruar një... E të më ndjeni se u solla si ftohtë me ju në fillim. Këtej erdhi fjala se vranë Mëron. Se e vranë komunistët. E, të them të drejtë, edhe u gëzova, por edhe peng më mbeti. Desha t'i laja vetë hesapet me të, po ja që nuk që e thënë, se ju djemtë e Qarkorit u treguat më të shpejtë, — tha Met Repishta e brofi nga vendi. Pas tij u ngrit edhe e shoqja e i ra pas. Të dy djemtë shtangën të habitur e filluan të pëshpëritnin me njëri-tjetrin.

Nebija hoqi tepsinë e mbushur me patate nga

magjja, hapi kapakun e saj, ndërsa Met Repishta nxori që andej një dru lisi me lëvozhgë të plasaritur dhe e solli në kënd. Druri vende-vende ishte i pahitur me miell.

— Kam tetë vjet që e ruaj, — tha Met Repishta dhe e lëshoi ndër këmbë. E shoqja i afroi kandilin dhe po i bënte dritë. Azemi dhe Mevlani nuk po merrnin vesh gjë, veç shihnin kureshtarë atë dru lisi me një vijë sharre shkuar për së gjati e me një fije litari të lidhur nyjë në mes. Me duart që i dridheshin Met Repishta po mundohej t'i gjente fillin e ta zgjidhte.

— Më ndihmuam miqtë ta blija, me sa u mundej. Tetë behare me radhë e kam fshehur në barrën e druve kur zbritja në qytet, aq sa i mësova të gjithë sokakët nga qenë e nga s'qenë, por ëhëë...

Litari u zgjidh e dy lugje të holla u ndanë nga njëri-tjetri. Met Repishta i hodhi në zjarr. Nga barku i tyre doli një grumbull i gjatë lec-kash mbështjellë me gjalmë. Dy të rintjtë, tërë sy e veshë, prisin të mësonin ç'kishte atje brenda e të dëgjonin rrëfimin e penguar të plakut.

— Kot isha lodhur me ato ecejaket e mia. Vonë, shumë vonë mësova se ai kishte kapërcyer detin. Kur prapë më thanë se u fanit, po kësaj radhë tjetërsoj. Me të huajin bashkë. Ashtu thashë e prapë ngarkova mushkën me dru e vajta në qytet pesë behare të tjera me radhë. Nuk i qasesha dot me këtë, duket më nuhati dhelpra. Edhe këtë behar po këtë punë do të bëja, — tha Met Repishta, që zbuloi një pushkë të vajisur e të ruajtur mirë nga ndryshku. Nebija i mblodhi shuk leckat e lyrosura e i hodhi në zjarr. Në çast flakët u rritën e dhoma e mxirë nga tymi u ndriçua, si brenda saj të kishte hyrë dielli. Met Repishta hoqi llozin prapa, e shtyu pastaj lehtë përparrë

e hoqi këmbëzën, me tytën drejtuar nga trarët.

Çëkk, u dëgjua tingulli i thatë që lëshoi ajo. Në veshët e plakut ajo «çëk» u dëgjua si një krismë që jehoi gjatë.

— Merre, Mevlani, merre, djalë. Ta kam falur, — tha Met Repishta e ia lëshoi në duar.

— Tu rrittë ndera, o xha Met, — falënderoi Mevlani duke përkëdhelur me pëllëmbë faqet e pushkës, që shkëlqenin nga drita e fortë e flakëve.

— Ne kemi edhe tonat, — shtoi pastaj ky e nxori nga brezi një revolver. — Po këtë nuk do të ta kthej si kutinë e duhanit, se është pushkë nga të popullit, e them se do të këndoje mirë.

— Kam besim, — tha Met Repishta dhe rrëmbeu djalin në krah mie dashuri.

— Për ty, Azem, janë këto të tjerat — u dëgjua të thoshte me zë të mallëngjyer Nebija, që ishte larguar për një çast e u kthye pranë tyre.

Në njérën dorë mbante një qese të vogël, ndërsa në tjetrën tregoi një grusht fishekë. Fishekët majëmprehtë kishin dalë nëpërmjet gishërinjve e grushti i saj ngjante si një topuz i vogël.

— Ju morët hak edhe për ne, ndaj...

— Partia, nënë, Partia merr hak për të gjithë sot dhe ju sonte po e tregoni se e keni në zemër Partinë, — i tha Azemi asaj dhe iu hodh në qafë. — Po nuk na treguat se ç'dert kishit me Mero Lupin, — foli me zë të lartë, ende pa u çliruar nga krahët e Nebijes.

— Më vrau vëllanë, qeni, — psherëtiu Met Repishta. — Ka qenë beu i fshatit dhe më bëri gjémën. E për se thua?... Për një copë tokë. Por është histori e gjatë ajo e gjyqit me qeverinë, o djem. Hamë njëherë ato që na ndodhen, pa juar rrëfej më pas, — dhe, ende pa zënë vend në këndin e tij, i foli së shoqes:

— Grua! Shtroju djemve të hanë, se i ka lodhur rruga!

## Çobani Bendo

Bendon nuk po e merrte gjumi. Ashtu me kokën mbështetur në pëllëmbë të dorës, kthehej sa në njërin krah në tjetrin.

Shokët le kompanisë, pranë tij, flinin të lodhur e të mardhur. Gjithë ditën kishin bërë rrugë të gjatë pér të ardhur te stanet. Papritur, dera e kasolles, thurur me purteka lajthie, u shty me zor. Bendoja ndjeu mornica në trup. Në kasollen tjetër përballë, nëpér të çarat e gardhit, u duk të regëtinte një dritë e dobët. Bendoja u ngrit dhe doli jashtë. Me majën e opingës shtyu një jastëk bore që ngrihej pranë këmbëve. Pastaj u mbështet mbi pushkë e me mëngën e xhaketës fshiu pjesën e zezë që u zbulua. Ishte një kërcu i mbetur aty prej vitesh. Ai vetë e kishte sjellë në stan. U ul mbi të. Pushkën e shtriu mbi gjunjë. Nga xhepi nxori qesen e duhanit dhe nisi të çridhëte cigaren. Po ta shikoje Bendon ashtu ulur, me atë kapuçin prej leshi që mbajnë çobanët e që i zbulonte vetëm fytyrën, me atë xhaketët e shajaktë; me ato vetulla të mbledhura pér të mbrojtur sytë nga thëllimi i natës, të dukej si një trung lisi që kishte shtrirë rrënjenë nën borë.

Dikush iu afroa.

— Qenke ti, Bendo? — dëgjoi t'i flisnin.  
— Na... dridh një duhan, — tha Bendoja  
dhe i zgjati qesen rojës së shtabit, një djali të  
shkurtër e trashaluq.

— Je gjë sëmurë? — pyeti roja.  
— Jo, — u përgjigj Bendoja, — nuk kisha  
gjumë e thashë të dal njëherë.

Roja ndezi cigaren në atë të Bendos, që  
digjej me një erë të fortë e u largua përsëri  
nga kasollja me dritë.

Bendoja pinte duhan duke e thithur tymin  
thellë. Shikimin e kishte tretur në mugëtirë.  
Në këmbë të plajës zbriste përroi që shpinte  
ujë në mullirin e Dautit, ku bluante gjithë  
fshati.

«Jazi ka ngrirë», mendoi Bendoja. «Dauti pret  
pijanverën». Që andej dëgjohej rrallë e lehura e  
një qeni. Ishte natë e fshati nuk dukej. Por Ben-  
doja e dinte se, pasi të lije mullirin e të zbritje  
çukën e dëllenjave, fillonin shtëpitë e para, me  
oborret e thurura me gardh. Në dimër ato hepo-  
heshin nga pesha e borës. Por, kur zinin e kullo-  
nin ujërat e mugullonte bari, fshatarët merreshin  
ditë të tëra me ngritjen e tyre. Ata që e kishin  
zanat gardhin, thurnin, të tjerët sillnin hunj të  
fortë nga pylli. Shtëpitë e gurta, mbuluar me  
plloça e të shpérndara kuturu, ditën të dukeshin  
si ca shkëmbinj të rrokullisur nga mali e të  
ngulut në oborret e buta. Atje Bendoja kishte lënë  
nënën dhe gruán. Muaj të tërë larg tyre atë e  
digje malli. Dhe ja tani, aty në stane, Bendoja  
priste të kthehej Shahini, intendent i kompanisë,  
që ishte nga një fshat me të. Kur kompania ishte  
ndalur në kasollet e stanit, Shahini, megjithëse i  
lodhur, që varur tatëpjetë nëpër natë. Shokët ishin  
të pangrënë. Veç kësaj, shtabi e kishte porositur  
të lidhej me ata të këshillit e të mësonte për

forcat balliste, sa veta bëheshin e ku qe vendosur komanda e Agos, që shinte sipas qejfit, deri atëherë, nën hijen e bajonetave gjermane. Ishte fjala që, pa zbardhur mëngjesi, kompania të hynte në fshat. Agon shtabi e donte të gjallë. Edhe të tjerët kështu, në qoftë se s'do t'u dhimbsej lëkura. Ndryshe, plumbin ballit, kishte thënë komandanti. Apo s'kishin qëndisur një plan ata të shtabit.

Bendoja nuk reshitte së piri duhan. Përreth kishte pllakosur heshtja. Ai përkëdheli tytën e pushkës. Ajo ishte e ftohtë dhe e lëmuar. Medorën e madhe prej çobani Bendoja kishte përkëdhelur edhe qenin balik, edhe qengjat, sido që vetë nuk kishte pasur kurrë asnje dele. Vite të tëra çoban në stanet e Agos. Vite të tëra Agon në qafë. e rrodhe në oborrin e shtëpisë. Agoja i gjatë si stërhell iu fanit i gjallë.

— Qen, — shau Bendoja, — kërrabën e hodha e tashti kam pushkë. A e di ti, se të kemi ardhur kaq pranë në stane?... Pastaj, edhe një plumb ta kam ruajtur mënjanë. Ja ku ta kam... ta dish.

Një hije e gjatë pa formë u shtri mbi borë. Dera e kasolles së shtabit u mbyll duke fshirë hijen. Bendoja thithi edhe një herë bishtin e cigares, që po i digjte gishtat, dhe e hodhi.

— Erdhi intendanti, — foli roja, duke fërkuar pëllëmbët i gëzuar, sikur intendanti të kishte bërë gjithë atë ecejake nëpër natë vetëm për të.

Bendoja u ngrit vrulltas në këmbë.

— Nuk jemi vonë për të zbritur poshtë? — e pyeti roja.

— Ka kohë, — u përgjigj Bendoja. — Fshati është afër...

Intendanti nuk vonoi të dilte.

— Hej, — lëshoi zë në drejtim të tyre ai,

— më nxirrni pak Bendon, por pa zhurmë. Dëgjuat, pa zhurmë!

— Këtu më ke. Po të prisja, — tha Bendoja dhe u lëshua drejt tij nxituar.

Intendanti, një mesoburrë me trup të bëshëm si të Bendos, por me qafë të shkurtër që i humbiste në jakën e madhe të palltos, zbriti më poshtë.

— Hë, si doli? Si ishin andej? Tanët ç'thoshin, — e mbyti me pyetje Bendoja. Dorën ia kishte hedhur në sup e në fytyrë ndiente avullin e tjetrit, që ende gulçonte nga lodhja e mezi mbushej me frymë.

— Të gjithë mirë sa s'bëhet... Nëna u gëzua kur i thashë se ti je në stane. Të presin të shohësh djalin...

Bendoja shtangu. Trupi iu ngroh nga gjaku që i buçiti në damarë. Në gjoks zemra po i rrihte me forcë.

— Dja... lë! — belbëzoi ai dhe shtrëngoi dorën e intendentit.

Roja, mbetur mënjanë, s'po lidhte dot fjalët e s'po kuptonte gjë. Ai pa dy veta që u rrökën për beli e po rrrotulloheshin si fugë. Kërën që shkërmonej kokrra-kokrra. Intendent Shahini i lutej ta lëshonte, po ku pyeste Bendoja. Ai ishte bëre me djalë e s'mbahej nga gëzimi.

— Po këta kështu? — foli me vete roja.

Befas qetësinë e natës e çau një krismë. Maja e maleve ia përcollën njëra-tjetrës, e jehona e saj u tret thellë nga ana e pyllit. Qentë e fshatit filluan të lehnin e të angullinin.

— C'bëre, Bendo?! — thirri vrazhdë intendent Shahini. — Dhe kjo na duhej! — dhe iu shqit nga krahët. Gishti që kishte prekur padashur

këmbëzën e pushkës i mbeti për një çast i përthyer si një pikëpyetje.

Bendoja u hutua.

— Po kjo? — tha ai.

Ata të shtabit u dhanë në derë. Nga kasolla ja tjetër dolën shokët e kompanisë, të përgjumur, me pushkët e pajimet në duar.

— Kush qëlloi? — thirri komandanti me zë të rreptë. Drita në kasolle u shua dhe asnjeri nuk mundi të dallonte ç'shprehte fytyra e tij. Por nga zëri kuptohej se ai nuk po përmblahej. Të gjithë ndalën në vend e po mbanin vesh.

Bendoja rrinte i përhumbur, si në ëndërr. Pushka e tij ende lëshonte tym. Në qafë ndiente afshin e saj të ngrohtë. Intendent Shahini i ishte afruar komandantit e po i shpjegonte me zë të penguar.

— Pushka e Bendos... Unë... atij i ka lindur djalë... Unë, unë e shkreha pushkën e tij padashur...

Partizanët, me të dëgjuar ato fjalë, lëvizën të shqetësuar.

— Të rreshtohet kompania, — urdhëroi komandanti prerë. Tha dhe diçka tjetër nëpër dhëmbë, por asnjeri nuk e dëgjoi. Dy të tjerët, që kishin dalë me të, i hapën rrugë e ai hyri në kasolle.

— Ptuuuh, — pështyu një partizan ndër këmbë. — U zbuluam.

— Të marrët! — shfryu Zaloja.

— Po tani?... — pyeti një tjetër. — Thua mori fund aksioni!?

— Ç'do të bëjmë me intendentin? — pyeti një amëtar i shtabit që përjashta.

— Të mbahet në mbikëqyrje, — tha komandanti. — Do të ulemi, e shokët le të vendosin.

Dera e kasolles kishte mbetur hapur e kom-

pania ndiqte lëvizjet e atyre që ishin përjashta. Bendos i binte në fytyrë vetëm drita e zbehtë e hënës, që herë shfaqej e herë fshihej pas reve të zeza që i rrëmbente era. Në ballë e mbulonin djersë të ftohta. Veshët i zienin nga krisma. Veten e ndiente ngushtë sa s'bëhéj. Intendent Shahini i kaloi pranë e bëri në drejtim të hangarit të shembur, ku ishte lidhur mushka e ngarkuar me dy thasë të mbushur përgjysmë, shoqëruar nga dy partizanë, që po zbatonin urdhrin e shtabit. Bendoja u mat t'i fliste, por prej turbullimit nuk arriti ta hapte dot gojën. Shokët qenë rreshtuar dhe ai, pa e kuptuar as vetë, nisi të çapitej rëndë-rëndë për atje.

— Me jetë e paç! — e uroi Kadriu.

— Këtu ka tradhti, — ngulte këmbë Mersini, duke folur me ca të tjerë më tej.

Bendoja e dëgjoi dhe u drodh.

— Jo, — e kundërshtoi një zë. — Si ta nxë goja!?

— Na shpëtuam... Hajde t'i zësh tan, — shfryu me zemërim një partizan. — Apo nuk bëmë dy ditë rrugë gjer këtu!

Hamendjet e torturonin Bendon. Gëzimi për djalin që i kish lindur në shtëpi herë platitej e herë ngruhej mal mbi fjalët — fshikuj që i përplaseshin nga të gjitha anët e s'e linin të merrete frymë. Atij as që i kishte shkuar në mendje se fisheku i lënë mënjanë për Agon do të bëhej shkak të zbuloheshin kompania e shokët, pastaj të ngarkonin me faj intendentin, ta quanin të marrë, tradhtar e kushedi se çfarë.

— Ufff, — psherëtiu thellë. Faji po e mundonte e nga kjo ndjeu dhembje koke. U ul, mori një grusht borë dhe e vuri në ballë. Bora e ngrirë u tret menjëherë. Uji i fohtë në fillim

i lagu kurrizin e dorës, pastaj kyçet e i rrëshqiti nën mëngë, gjer thellë në bërryl.

Atë kohë lehjet e qenve, që kishin lënë mu-llarët ku ishin struktur nga të ftohtët e natës, ndiheshin nga ana e përtejme e fshatit.

«Ata po ikin!» mendoi Bendoja. «Ja, qentë po i ndjekin me të lehura. Atje është lundra. Por nuk do t'i lë të shpëtojnë. Unë i zgjova, e prapë unë do t'i vë në gjumë për tërë jetën. Unë do të bëj timen. Pastaj shokët për të gjitha le të më gjykojnë.»

Dora që shtrëngonte rripin e pushkës dhe tjetra, që ftohte ballin, u varën në gjoks e që-ndruan mbi vezmet. Gishtat i prekën majat e plumbave, të futur në gjerdan. Dora e djathët iu pengua. Një, dy, tre, numëroi Bendoja. Në brez i vareshin tri bomba. Duart pastaj bënë rru-gën e kundërt, si për t'u siguruar edhe një herë. Vendosi... Duke shkelur mbi borën e ngjeshur, bëri nga kasollja ku kishte fjetur kompania, me një mendim të ri, që e nxiste për veprim, për hakmarrje.

Në përgatitje e sipër për t'u tërhequr nga stanet, gjithë vëmendja e partizanëve ishte përqëndruar te shokët e shtabit dhe askush nuk vuri re lëvizjet e kujdeshme të Bendos.

Në përrua era e kishte hedhur borën pirgje-pirgje e ajo mezi çahet. Bendos po i merrej fryma nga nxitimi. Duart i ishin bërë gjak të kuqe prej thëllimit, ngaqë të përpjetën e kishte ngjitur këmbadoras. Përroi i kishte hapur punë. Mezi gjeti, nëpër mugëtirën e natës, rrjedhën ku mund ta hidhët më lehtë e që mbante mend mirë. Por edhe aty i doli për keq. Akulli nuk e mbajti dhe ai u fundos gjer në brez në ujë. Pushkën e kishte hedhur krahaqafë për të qenë më i lirë. Veç gulçimit të tij dhe kërcitjes së

borës nën këmbë asgjë tjetër s'pipëtinte. Për çudi, në veshë i gumëzhinin, përziér pa ndarë edhe krisma e pushkës, edhe e qara e një fëmije që ai s'dinte si ta shëmbëllente, edhe fjalët e shqetësuara të shokëve.

«Mirë, keq, unë e vendosa dhe ika. Ajo që u bë, ndodhi pa dashje. Po ty, o Ago lubia, nuk të lë të më ikësh», mendonte Bendoja.

Po binte mëngjesi e retë po përflakeshin. Fshatit i kishte dalë në krah. Mbi çukë, tymi i oxhakëve ndiqte mjegullën që po ngrihej me përtesë. Sytë po digjnin nga djersët. Kapërceu me një të hëdhur një kanal e u dha në ca shelgjishta të kacavjerra e të rënduara nga bora. Krak-krrau, u ngritën të trembura një tufë rosa të egra. Trembja e rosave e siguroi se kishët arritur në vah më parë se ballistët, që kishin lënë konakët e ngrohtë e po tërhiqeshin nga fshati.

— Tani, vetëm po kaluan mbi trupin tim, — tha Bendoja me zë, disi i lehtësuar.

U hodh mbi një lundër të vjetruar që ishte lidhur pas një trungu me një litar të trashë gjithë nyja. Dallgët e lumit e kishin ngjitur atë pas bregut e uji llokoçitej me zhurmë në bark të saj. Nga brezi nxori një thikë me teh të mprehtë dhe goditi fundin e kalbëzuar. Uji buiti si burim. U hodh në breg e i dha varkës një të shtyrë. Bendoja pa si ajo po mbushej me ujë të turbullt dhe po fundosej.

\* \* \*

Kompania po ndiqte rrugën që nxirrte në pyllin e pishës. Të gjithë ishin të shqetësuar që ngjarjet kishin marrë një rrugë të tillë. Çanin

borën me mundim e me kokat varur. Komandan-  
ti nuk e gjente dot me mend si arriti Bendoja  
të gabojë aq rëndë. Në fillim një krismë, pastaj  
një partizan që i njihte shtigjet e asaj ane për-  
fiton nga errësira e largohet. E përse ta bënte  
ai këtë? «Vallë, kanë të drejtë Mersini me shokë?» — pyeste veten komandanti. Intendentin  
e kishte thirrur për të dytën herë e ky betohej  
e vinte dorën në zjarr për veten, që kishte zbra-  
zur pushkën me dorën e tij padashur dhe për  
Bendon, që ishte njeri i qëruar.

«Jemi rritur bashkë e kemi hequr bashkë. Nuk  
ia bën Bendua të keqen kompanisë. E njoh mirë  
unë, njëlloj si vëllanë. Veç të jetë qmendur...»  
kishte thënë më në fund intendentin.

— Po binte mëngjesi dhe partizanëve po u lë-  
byreshin sytë nga shkëlqimi i borës. Asnjeri s'fiste,  
veç sillnin ndër mend atë që ndodhi e që  
kishte të bënte me dështimin e aksionit, me  
nderin e kompanisë. Papritur, nga ana e lumit  
shüngulloj një plasje e fortë, si bubullimë e  
zgjatur, që u dëgjua deri matanë pyllit. Rreshti  
i gjatë i partizanëve ndali në vend si me ko-  
mandë.

— Bendua, — thirri intendent Shahini, —  
komandant! Bendua, për besë! Do të ketë dalë  
në vah dhe u ka zënë pritë, — fliste ai e sytë  
i shkëlqenin nga një gëzim i brendshëm. Ko-  
mandanti nuk iu përgjigj. Bëri mënjanë dhe  
ngriti dylbitë të shihte. Pamja ishte e zbehtë.  
Nga ajo anë kishte mjegull dhe nuk shquhej gjë.

Ende pa u tretur mirë gjëmimi i bubullimës, u  
dëgjuan ca krisma të tjera që jehuan gjatë nëpër  
faqet e monopateve të mbuluara me borë.

— Komandant! Ky është Bendua. Ia njoh  
kokën atij unë, — këmbëngulte intendentin.

Nga ana e lumit vinin deri aty zhurmat e

luftës. Të tjerët ia kishin ngulur sytë komandanit e prisnin që ai të jepte urdhër e të lëshoheshin poshtë.

— Kompania të vazhdojë rrugën, — urdhëroi komandanti. — Ju do të vini me mua, — e shënoi me gisht dhjetë partizanë. — Intendent Shahini jo. — Partizanët dolën vrulltas nga kolona. Ata morën rrugën tatëpjetë me hap të nxituar. Përpara çante komandanti me sa i hanin këmbët.

Bendoja kishte zënë vend pranë bregut. Pas tij dallgët e lumi shtynin gjatë rrjedhës copa akulli. Shelgu që kishte zgjedhur si pozicion e mbronte mirë. Gjerdanin e fishëkëve dhe bombat i kishte lënë aty pranë. Plumbat i vërshëllën mbi kokë. Ai u kishte hedhur befas ballistëve bombën e parë, e ata që kishin mbetur gjallë po i afroheshin tinëz. Qëllonte rrallë e në shenjë. Merrte nishan! herë një qylaf, herë një sup apo shpatullat e ndonjërit që bënte të ngrihej e të turrej drejt tij. Pastaj çlironte nofullat e shtrënguara e shfryntë me mllef.

— Në!... — shfrente me zemërim. Pas krismës, nga ana tjetër heshtte një pushkë.

— Na edhe ti, shushunjë e ndyrë!

— Më vau çobani i kuq, — u ankua dhimbshëm një zë.

— Qenka Bendua, çobani yt, o Ago! — u dëgjuar të thërriste një zë i alarmuar.

— Ma sillni këtu, se do ta rrjep si cjad! — thirri Agoja i tërbuar, kur mori vesh se kush ua kishte zënë shtegun e shtinte mbi ta. Ai mallkonte veten që nuk ia' kishte nxjerrë shpirtin e nuk e kishte djegur si miun, që më parë, kur e kishte pasur hyzmeqar.

Agoja bërtiste e cirrej, por kokën e ruante. Përpara kishte nxjerrë dy a tre të tjerë.

— Dil sheshit e mos rri në bisht! — i thirri Bendoja.

Ballistët filluan të lëviznin drejt tij, pastaj disa prej tyre, të tèrbuar nga marazi, i dhanë karar, e u çuan të hidheshin mbi të. Bendoja këtë priste. Rrëmbeu bombat e ua hodhi ndër këmbë.

Vendi u drodh me gjëmim.

«Thua... e vrava atë derr!?» — pyeti veten dhe në çast u kujtua se shtabi Agon e donte të gjallë.

Kur plasën bombat, partizanët ishin afruar dhe u kishin marrë krahët ballistëve. Automatiku i komandantit hapi zjarr e po grinte në të majtë e në të djathtë. Në krah të tij, partizani Zalo s'përmbahej. Bënte përpara e qëllonte më këmbë. Tani Zaloja kishte ndërruar mendje. Këtë në kompani e mbanin për nishanlli të madh.

Ballistët u befasuan. Për një copë kohë të shtenat e pushkëve të tyre u rralluan. Dikush thirri llahtarshëm!

— Po na rrëthojnë!

— Të çajmë këtej!... — thirri një tjetër e mori të ikte me vrap në drejtim të vahut. Disa u çuan nga pozicionet e nisën, të tèrhiqashin praptas. Agoja jepte e merrte si i xhindosur. Thërriste, lutej e qëllonte, por edhe vetë tèrhiqejej me të tjerët për të shpëtuar kokën. Veç më kot. Deri në njëfarë vendi iu dëgjua zëri i ngjirur, por pastaj as u ndje e as u duk më. Si dukej, Zaloja, që nuk i ndahej këmba-këmbës, e kishte ngopur syrin në nishan, ashtu si dinte vetë.

Kaloj kështu më shumë se një orë. Dara e rrëthimit sa vinte e ngushtohej.

Buzë lumit dëbora nxinte nga gjurmët e bombeve të plasura, nga balta e rrënjet e shelgjish-

tave, nga gëzhojat dhe gjurmët e tjera të asaj ndeshjeje për jetë a vdekje, atij mëngjesi dimri.

— Bendo! — thirri komandanti, duke çarë midis katër a pesë ballistëve të vrarë dhe i shkoi pranë. U ul gjunjas dhe ia mori kryet në prehër.

Bendoja lëvizi me mundim. Cepat e buzëve iu hapën me zor. U përpoq të buzëqeshte. Dy damarë i kërcyen në nofulla nga dhembja e plagës, pastaj se ç'desh të thoshte.

Komandanti i bëri shenjë që të mos fliste. U përkul mbi të dhe me një zë të thellë foli me pësh-përimë:

— Eh, Bendo, Bendo!...

Erdhi aty edhe Mersini, që atje te stanet kishte dyshuar për tradhti.

Partizanët e tjerë vazhdonin të ndiqnin këmba-këmbës ballistët, që i kishin shpëtuar rrethimit.

## Krugë nëpër natë

Gjithë atë ditë dëbora kishte rënë me plaska të mëdha, thua se s'do të pushonte kurrë. Në një mot të tillë, dikush varej tatëpjetë monopatit përkrah pyllit të pishës. Njeriu dukej fare i shkurtër ngaqë gjunjët i humbisnin thellë. Gjurmët që mbeteshin prapa, mbuloheshin shpejt nga dëbora që vazhdonte të binte dhe për më tepër sepse kapotën e hiqte zvarrë si branë. Si kur ai të provonte të kthehej andej nga kishët ardhur, zor se do të shkelte dy herë në të njëjtën vazhdë. Nxitonate tatëpjetë duke dihatur. Jakën e mbante ngritur dhe brenda saj sikur e ndiente më pak thëllimin. Duart i kishte mblehdhur grusht në fund të xhepave. Me njërin bërryl shtrëngonte pas trupit pushkën, që i varej në sup.

Në shtab ishte vendosur që partizani Kaso të zbriste natën në fshat. Ato dy ditë mund të kishin ndodhur gjëra që ata nuk i kishin parashikuar. Dimri kishte mbyllur rrugët papritur dhe këmbë njeriu s'kishte bërë për këtej. Dy ditë më parë ata kishin lënë të plagosur në shtëpinë e Kasos një shok të shtabit. E kishte marrë plumbi keqas dhe s'mundën ta bartnin me vete gjer në spitalin partizan. Me të shtënë në dorë një grusht ilaçe, shtabi i batalionit vendosi t'i niste me

partizanin Kaso, që duhej të arrinte pranë të plagosurit sa më parë. Komandanti gjithashtu u dërgonte të falat plakut Tale dhe nënë Xikos, dy pleqve të mirë që strehuan të plagosurin dhe që e mbanin derën hapur e zjarrin ndezur kur-doherë pér partizanët.

Në majën e përtejme partizanin Kaso e zuri nata. Thërmijëza të akullta i përplaseshin në fytarë. Ai e ndiente si shndërrroheshin ato në sum-bulla uji e i kullonin nëpër mjekër. Edhe pse dëbora binte me erë, pylli nuk oshëtinte. Halëzat e degëve qenë ngjitur me njëra-tjetrën nga një cipë e hollë akulli dhe era nuk fërshëllente dot nëpër to. Përreth, qindra silueta. Drurët dhe gëmushat kishin marrë ca forma të çuditshme. Një sy i pamësuar do t'i merrte pér lukuni kafshësh të egra; që nga çasti në çast mund të të lëshoheshin, por atij nuk iu ngjall një përfytyrim i tillë. Ekte midis tyre i qetë. Ishte rritur atyre anëve. Pastaj, vitet e luftës kishin bërë të tyren. Mundohej të priste sa më shkurt dhe shpeshherë i dilte pér keq e rrëzohej gropave të mbushura rrafsh me dëborë. Ngrihej duke u kapur pas shkurreve dhe kërcente më tutje. Pastaj fuste dorën e lagur në gjii, e terte mirë dhe e rraste prapë në xhepin ku mbante ilaçet. Përrpara i doli një rrëpirë. Hoqi pushkën, u ul ndejjur, e vuri atë në prehër dhe zbriti rrëshqan Thi aq shpejt, si të fluturonte. Kishte edhe shumë rrugë pér të bërë. U lodh. Kapakët e syve po i kapiteshin pér gjumë. Këmbët e ngrira po i këputeshin, sikur mbi kurriz të mbante një barrë të rendë. Sa më tepër bënte në drejtim të fshatit, aq më e gjatë i dukej rruga. Në kohë të mirë ai me siguri ëdo të kishte arritur qëkur në shtëpi, pranë shokut të plagosur.

— Po sikur...

Jo, ai nuk donte tē mendonte keq pēr lë. Duhej tē shpejtonte dhe tē sillte ndér mend gjëra që i jepnin forcë, e ndillnin drejt njerëzve tē dashur, tē cilët e prisnin.

Dy ditë më parë ai ishte takuar me prindërit vetëm disa çaste, pas aq muajsh ndarjeje. Vetë i dhjetë ishin dhënë në derë pas një rruge tē gjatë. Portën ua kishte hapur xha Talja, i ati. Kur e panë tē plagosurin, ua rrëmbyen nga duart dhe e vunë në kënd. Babë e nënë u dhanë aq shumë pas tij, sa e harruan edhe tē birin. I zbuluan plagën, ndezën zjarrin, pastaj plaku Tale hapi një sënduk e nxori që andej një shishe tē mbushur me raki tē fortë...

Duke ecur nëpër pyll, partizani përfytyroi nënën me kandil në dorë, se si ajo doli në katua e u kthye që andej me një filxhan qumësht që ia kishte shtrydhur dhisë, si ia shpélau plagën me raki e i lagu buzët me qumësht, si i kishte ndenjur komandanti pranë tē atit dhe e pyeste përhallet e i fliste për luftën, për këshillin nacionalçlirimar, për lirinë... Më në fund iu kujtua edhe ndarja me nënën, që i puthi tē gjithë më radhë në ballë, nën yllin e kuq tē kapelave... Përcjellja që u bëri i ati gjer përtëj shtegut...

Partizanit Kaso nuk i vinte keq që ata s'ishin dhënë aq shumë pas tij, përkundrazi, i vinte mirë. Ja, a nuk po kthehej ai përsëri pranë prindërvë? Do tē rrinin bashkë një copë herë rrëth zjarrit bubulaç e do tē çmalleshin. Ai ndihej i lumtur për takimin e afërt, ndaj i queshte edhe buza.

— Uhhh, — lëshoi zë e u shkund nga mendimet. Pa e kuptuar, kishte arritur në përrua e i qenë futur këmbët në ujë. U tërhoq prapa dhe pastaj vazhdoi rrugën, duke iu shmangur rrëkesë, që gurgullonte nën dëborë. Këmbët i shponin

nga tē ftohtët, por ai mundohej tē harronte edhe lodhjen edhe cingërimën e asaj nate.

— Edhe pak, se vamë, — i jepte zemër vetes.

Korija mbi fshat nxinte. Filloi t'u shmangej sa mundej vendeve tē rrafshëta. I kishin mbetur edhe tre-katërqind metra pér tē hyrë në korije, po ngazëllimi iu shua në çast. Nga ana e fshatit ranë pushkë. Në fillim dy tē shtëna, pastaj një tjetër. Ndaloj në vend e nuk po dinte c'rrugë tē merrte. Ngriti njérën dorë dhe uli jakën poshtë që tē mund tē përgjonte më mirë.

«Ç'të ketë ndodhur vallë?» — mendoi.

Krismat tregonin se punët në fshat nuk ishin mirë. Si tē bënte? Shoku i plagosur priste ilaçet. Të kthente rrugë, as që i shkonte nëpër mend. Era, pér çudi tē tij, sikur ishte platitur. Tani kjo e ndihmonte tē përgjonte më mirë ç'bëhej matanë korijes. Pranë tij kërcitnin ankueshëm degët e hepuara, që shkarkonin déborën. Partizani Kaso lëvizi pér tē mos u mpirë nga tē ftohtët dhe u ngjit në një vend tē lartë. Që aty i zunë sytë ca drita tē vagëlluara. Nuk i erdhi mirë. Në natë dimri si ajo, njerëzit mbylleshin herët e binin shpejt. Ishte përqëndruar i téri me sy tē ngulur drejt dritave, aq sa iu përlotën. Dritat lëviznin si tē ishin xixëllonja. Sa shuheshin një palë, ndizeshin tē tjerat. Më pas ato filluan tē rralloheshin. Të fundit humbën nëpër natë ato tē kreut, në shtëpinë e vellezërve Qazeti, që deri atëherë i kishin ndenjur mënjanë Luftës. Sado që u mundua se mos dallonte ndonjë dritë andej nga binte shtëpia e tij, nuk mundi që nuk mundi. Edhe lehjet e qenve nuk po ndiheshin si më parë. Krismat ua kishin prishur gjumin e ata angullinë sa angullinë e u strukën mullarëve pér t'i shpëtar cingërimës.

— Qentë!.. — shfreu me mllef partizani Kaso

dhe pështyu me neveri, si të kishte në gojë një send me shije të keqë. Shfreu kështu dhe hoqi me rrëmbim pushkën nga supi. Pastaj me gishtat e ngrirë zërtheu bombat e brezit dhe i rrasi në xhep mbi pakon e ilaçeve. Në gjoks zemra i rrihte harbuar. Hovjet e saj sikur matrin kohën që po kalonte. U nis. Për të hyrë në shtegun që nxirrte në fshat, duhej të kalonte rrëzë ledhit të selishtës, së cilës i mbaheshin dherat nga një gardh i dendur lisash. Nën hijen e tyre edhe ditën zor se dallohej, e jo më natën. Nëpër atë shteg kishin dalë ata dy ditë më parë, ndaj të gdhirë. Ndërsa do të priste tërthor shtegun, ndaloi në vend dhe mbajti vesh. Diçka kishte ndier... Një si rënkim i zgjatur vinte nga e djaththa. Veshët nuk e kishin gënjer. Me sytë e hapur jashtë mase mundi të dallonte nëpër mugëtirën e dëborës një trup që hiqej zvarrë me mundim. U dëgjua një tingull metalik. Pushka e tij e mori fishekun në gojë. Me një të hedhur vringthi, zuri vend pas një trungu të prerë me kapuç të madh dëbore. Që atje indiqte lëvizjet e atij trupi, që gulçonte e që pas çdo gulçimi bënte përpara vetëm një pëllëmbë.

«Në qofsh ballist... peshqesh plumbin ke», mendoi pa ia ndarë sytë e duke hetuar me veshët pizgë përreth.

Dëbora binte si më parë. Trupi, i rënë përmbyss, sepse mbeti i palëvizur. Tani nuk gulçonte më, po vetëm regëtinte e, sa vinte, fundosej në dëborë. Cili ishte ky njeri? U ngrit nga vendi me kujdes dhe iu afrua. Që aty mundi të shihte më mirë. Njérin gju e kishte të përthyer. Koka i rrinte mënjanë me faqen mbështetur mbi llërën e djathitë. Krahun tjetër e kishte shtrirë përpara me gishtat ngulur në dëborë. Prapa tij zgjatët një vazhdë dredha-dredha që pothuaj po

mbulohej nga dëbora. Mbi shpatullat, pllaskat e mëdha mezi shtronin. Dukej sheshit se digjej nga zjarrmia, sepse mbi rrobat e shajakta dëbora shkrihej aty pér aty. Kasoja u përkul mbi tē pannjohurin me njëfarë turbullirë e ankthi bashkë. E ktheu nga vetja ngadalë. Pastaj u përkul edhe më. Në çast u drodh. Fytyra e përskuqur nga thëllimi iu zverdh sikur nëpér rrumba tē mos i lëvrinte më pikë gjaku. Kishte njojur Sevon, kryetarin e këshillit. Lëshoi pushkën anash dhe e rrëmbeu në krahë. Zemra e partizanit u ligështua. Ngriti kokën e hodhi një shikim në drejtë tē fshatit. Atje duhej tē kishin hyrë gjermanët. Shoku i shtabit ishte në rrrezik...

— Sefo, o vëlla!... — i lëshoi zë dhe e shkundi lehtë. Zéri i doli i ngjirur dhe pér herë tē parë nuk i ngjau si i tij, por si i dikujt tjetër, që ende nuk e kishte hasur në jetë. Balli i Sevos qe përlyer në gjak. Merrte frymë me mundim e koka e rëndë si shkëmb i varej. Partizani s'kish te kohë tē mendonte më gjatë si kishin vajtur punët. Një gjë qe e qartë. Këshilli ishte vënë në dijeni, nga i ati, pér shokun e shtabit... pér ilaçet që priteshin...

— Sevo! O Sevo! Jam unë Kasua, — i thirri me zë tē lartë pranë veshit e me pëllëmbën e dorës i fshiu currilat e gjakut. Pas kësaj, i zbërtheu jekun, mori një grusht dëborë e nisi t'i fërkonte fort gjoksin leshtor.

Sevos i bëhej sikur ai zë vinte nga një botë tjetër e largët. Pak më vonë, kapakët e syve iu përpilitën pér një çast, pastaj mundi t'i hapte përgjysmë. Po sytë e vagëlluar nuk panë gjë tjetër veç errësirës së theilë. Si nëpér éndërr ai njoju zërin e Kasos. Përmblodhi forcat, u mbush me frymë e foli me mundim:

— Në kasollen e vreeeshtiit.... Atje...

Partizani Kaso vuri re si i dridheshin Sevos buzët dhe i erdhi keq që tjetri e kishte të vësh-tirë të fliste. Por atij i duhej të mësonte edhe më. Ishte përqendruar me të gjitha shqisat dhe priste duke e shtrënguar pranë gjoksit. Tjetri vazhdonte të regëtinte. Pastaj përsëri nxori zë me mundim:

— Më lër mua... Ata të presssin...

— Mjaft, — u nxitua të thoshtë !Kasoja.

Nuk donte ta lodhte më tepër. Në atë gjendje që qe, Sevoja nuk duhej të fliste. Atë që i duhej e mësoi. Të tjerat merreshin me mend... Në fshat kishin hyrë gjermanë. Shokun e shtabit e kishin hequr nga shtëpia... Ai ndodhej në kasollen e vreshtit. Po si e kishin ngjitur deri atje?...

Vreshti nuk ishte larg, po rruga qe e vështirë. Nga ajo anë, era mbushte gjithmonë përrenjtë me dëborë. Vetë i dytë ishte e pamundur. ta çaje. Si të bënte? Si shoku i shtabit ashtu edhe kryetari i këshillit kishin nevojë për dorën e tij. Njëri priste në kasolle, tjetri i dergjej në krahë.

Ashtu i menduar filloj të kërkonte nëpër rrabat e shajakta të Sevos. Gjeti kutinë e duhanit dhe e hapi. Nga fundi i saj fluturuan disa letra cigareje që u ngatërruan me fijet e dëborës e humbën tutje. Nuk kishte duhan. Plaga e ballit vazhdonte të rrëndhë duke nxirë dëborën e tra-shë e duke hapur në të ca vrimëza të vogla.

Duke parë ballin e Sevos, iu kujtua puthja e nënës tek e pati përcjellë në fund të oborrit. Lëvizi vendit. U ngrit në gjunjë e futi dorën në xhepin ku mbante ilaçet. Pakoja e vogël e ilaçeve i mbeti e shtrënguar në gishta. Një valë e nxehkëtë iu ngjit nëpër damarë dhe e mbuluan djersët. Ato pak ilaçë ishin për dikë tjetër. Por edhe Sevoja, ashtu i humbur nga dhembja e plagës, priste diçka nga dora e partizanit, e dja-

lit të fshatit... A nuk kishte dalë ai natën, nën zjarrin e rojave gjermane, që Kasoja të mos binte në kurth? Partizani nuk e dinte këtë hollësi. Për të që të dy ishin të dashur dhe për të dy duhej të bënte diçka atë natë. Më vonë çdo përpjekje do të ishte e kotë. U mbush me frymë e psherëtiu thellë. Zemra vazhdonte t'i rrihte si më parë me goditje të forta. Koha nuk priste më. Ndodhej midis dy jetëve i vetëm e me një pako të vogël ilaçesh. Me njërin e lidhëte lufta... Me tjetrin jeta e fshatit, puna, fukarallëku, buka që nxirrin nga po ato dhera.

Që të dy ishin të shtrenjtë për të. Që të dy të Luftës e me Partinë... Mblodhi veten, afroi pakon pranë buzëve dhe e shqeu me dhëmbë lidhësen, ngaqë gishtat mezi i lëvizte se i kishin ngrirë. E ndau më dysh. Filloi ta mjekonte plagën me atë melhem të butë ashtu si dinin partizanët. E vtmja gjë që mund të bënte ishte të fitonte kohën e humbur.

— Sevo, — i bëri zë Kasoja kur mbaroi së lidhuri plagën.

Gulçimet e penguara të Sevos dhe zërin e partizanit i rrëmbeu era, që përsëri filloi të çmendej. Sevoja mezi lëvizi. Ishte në një gjendje të tillë, që nuk merrte vesh se ç'bëhej rrëth tij. Kasoja u ngrit edhe një herë mbi gjunjë, hoqi kapotën dhe e mbështolli mirë me të. Pjesën tjeter të ilaçeve e bëri shuk dhe e rrasasi në xhep. Bombat i futi në gji, ndërsa pushkën e hodhi krahaqafë.

«Duhet gjetur një vend tjetër», mendoi e pa përreth.

Rrëmbeu trupin e rëndë të Sevos në duar dhe u mat ta lëshonte më tutje, pas një gëmuše që iu duk si një kënd i fshehtë, për ta ruajtur nga era.

— Sevo, po tē lë vetäm... Po do tē kthehem shpejt... — tha Kasoja me tē belbëzuar, duke u përkultur përgjysmë. Por nuk arriti tē bënte një hap, sepse atë çast i plagosuri lëvizi me mundim dhe i hodhi njérën pëllëmbë pas qafe. Kasoja ngriu në vend zemërlënduar dhe i penduar një-kohësish që po tregohej tepër i nxituar në vendimin që kishte marrë. E si mund ta linte vetäm në atë cingërimë therëse që tē merrte frymën dhe në mëshirën e kafshëve tē egra tē pyllit!

— Jo! Jo, — tha Kasoja me zë. — Nuk do tē tē lë, o vëlla, — dhe ndërkaq e hodhi mbi shpinë tē plagosurin e u nis përrugë. Tani capitej me hapa tē vegjël duke têrhequr këmbët zvarrë e duke marrë përpara dëborën e trashë që çuhej me zor. Ndodhitë e asaj nate i kishin grumbulluar në zemër një duf, që i jepte forca për t'i bërë ballë lodhjes. Ashtu, vetë i dytë, pak e nga pak doli në shtegun e njohur. Ja, vetäm dy ditë më parë komandanti i kishte thënë plakut tē mirë. Tale: «Amanet shokun, baba. Është luftë dhe shokët i kemi tē shtrenjtë».

Duhej shpëtuar. Ata do tē luftonin përsëri bashkë si në Gurin e Kamjes... Edhe Sevoja, të cilin mbante mbi kurriz, do tē rronte!

— Dale, pa do tē na e dëgjoni këngën e pushkës, o derra, — shfryu me millef partizani Kaso, duke menduar që po atë natë tē kthehej për tē njoftuar shtabin.

Rruja e përpjetë dhe pesha e rëndë që mbanë, e mbushën tē tërin me djersë. Kasoja ecte nëpër natë me sy tē picërruar. Te një vend, këmbët nuik e mbajtën dot drejtpeshimin dhe ai u plandos anash.

— Ohh! — bëri ai i dëshpëruar, sepse nuk mundi ta ruante dot Sevon që tē mos i lën-duhej plaga. Ndërkohë dëgjoi dhe ofshamën e tē

plagosurit, që herë pas here i lëshonte gulçe fryme rrëzë veshit. Kasoja u zhyt i gjithi në dëborë. Iu desh një copë herë të rropatej, por edhe të tregonte kujdes që të ngrihej prej andej pa e lëshuar Sevon. Kur ia doli mbanë, mbushi gjoksin me ajër të ftohtë, aq sa i hanin mushkëritë.

Tani pjesët e zbuluara të trupit kishin filluar t'i shponin sa herë ia fshikullonte era e natës. Ai e ndiente se kishte humbur mjaft kohë, ndaj përpinqej me ngulm të arrinte në kasolle. Çap pas çapi shtegu e nxori atje ku duhej. Vetëm kur dalloi kasollen, që së largu ngjante me një shkëmb të madh, ngulur mbi shtresën e bardhë, atij i erdhi zemra në vend.

— Hej! — thirri me zë të përmbajtur e buzëdridhur nga lodhja e stërmundimi. — A ka njeri aty!?

— Kaso! Jam unë... — dëgjoi t'i përgjigjeshin nga brenda.

— Baba!... Ti këtu!? — thirri i gëzuar si fëmijë Kasoja, që kishte njojur zërin e të atit dhe aty për aty forcat sikur iu përtërinë.

— Sa të kam pritur, o bir! — tha i ati me zë të mallëngjyer, në pragun e kasolles.

— Solla Sevon, baba!... Më ndihmo!...

— Oh! Po si kështu... E paskan bërë të keqen ato të flamosura pushkë që dëgjuam.

Babë e bir e futën të plagosurin në kasolle dhe e shtrinë mbi kashtën që shërbente si shtrojë që në vjeshtë. Pastaj plaku Tale shkrepi çakmakun dhe kasollja u mbush me dritë. Në skaj shoku i shtabit lëvizi nëpër gjumë.

— Si është? — pyeti Kasoja, duke ulur shikimin te fytyra e shokut dhe nxori pakon e ilaqeve nga xhepi.

— Më mirë, bir, më mirë, duket se po merr për mbarë... Po kjo e keqe kështu, o bir! Na i

kafshoi me plumba i ligu djemtë! — foli babai,  
i ligështuar nga pamja që kishte para sysh. —  
Të lumtë, paske shpëtuar Sevon, — dhe i përkë-  
dheli plagën që i kishte mjekuar i biri. — Dëgjo,  
pas pak do të vijnë Zaçja me Hamdiun për të  
na marrë që të strehohemi në shpellën e pyllit.

Një ndjenjë krenarie e përzier me mallëngjim  
për guximin e babait e kujdesin e bashkëfsha-  
tarëve po e pushtonte partizanin Kaso dhe sikur  
po ia hiqte pak nga pak lodhjen e rrugës.

## Këmisha e dhëndërisë

Ishët natë vjeshte. Shiu kishte filluar ndajnatëherë dhe nuk kishte të pushuar. Rrufetë shkrepnin dendur dhe ajri i lagësht ngjante i athët, sikur pas çdo murishteje e mullari të digjet barut. Njerëzit qenë mbyllur brenda e mbanin vesh ato zbrazje të qiellit.

I fundit po kthehej në shtëpi Lelo Pertusha. Ky ishte një burrë i moshuar, me kurriz të gërmuqur që, tek ecte, matej një hop para se të lëshonte këmbën. Ai seç belbëzonte me duf. Në çdo tre-katër hapa qëndronte në vend, hetonte prapa e godiste me bastun gurët e kalldrëmit, si t'i hakërhohej ndokujt. Shtëpia e tij ngrihej buzë një shkëmbi, diku më tej, e ai mezi priste të arrinte gjer atje. Kur shkeli në prag, portën e rëndë e shtyu me këmbë. Kanati u përplas me zhurmë pas murit si të thyhej. Pastaj në muret e hajatit bubulluan ca si sharje, ca si mallkime. Hyri në dhomë. Plaku u mbush të thoshte diçka, por aty për aty kapërdiu fjalët. Hodhi bastunin me forcë në një cep të dhomës e u shty pas murit.

— Sa u vonove, o burrë!... Në këtë kiamet thashë se mos të gjeti gjë, — i foli e shoqja që nga këndi i vatrës.

— Erdha shpejt, thuaj, — ia ktheu plaku.

— Ulu... ulu tē ngrohesh, — e luti gruaja me zë tē paktë.

— Jam ngopur... Jam përcëlluar me tē ngrohur, — tha ai tek qëndronte në këmbë duke fërkuar pëllëmbët pas shajakut tē xhaketës.

E shoqja turfulloj. Pas krahëve iu rrëzua me fërfërimë cerga e leshtë. Fjalët e tē shoqit i mori pér qesëndi. Psherëtiu dhimbshëm e zuri tē çukiste me mashë drutë e zjarrit. Qindra xixa morën përpjetë oxhakut, ndërsa disa prej tyre u shpërndanë gjer në gjunjët e plakut, si shkëndijat kur rrëh mbi strall masati.

— Përse më hyn në hak?... — u ankua ajo me një zë tē pafajshëm.

— Nuk e kam me ty, moj, jo, — u nxitua ta qetësonte ai, — po me ata kodoshë gjermanë që erdhën e na e kafshuan fshatin.

— Çfarë po më thua, o 'burrë!? Gjermani gjer këtu!?

— E, de, e, — bëri ai i ulur shesh në anën tjetër tē këndit e ktheu me vrull krÿet e bardhë nga dera. Pastaj nisi tē shante i ndërkryer: — Ah, o Safet Brinjë. Ah, o bajgë e lopës... Ore kallaуз, që më ta bëfshin mishin copa! Ai, ai u bë sebep që u dogjën me themel Mëngorët, — s'përmbahej plaku. — Se mos shtiu fall gjermani dhe e gjeti që nga ajo dëré kanë dalië tre djem partizanë.

— Bobo, bobo; ç'i paska gjetur tē gjorët! — tha e shoqja me drithërimë e rrahu gjunjët me pëllëmbë.

— Moj, thuaj mirë që ia nisi ky bir shi, se, si i rrëmbente era flakët, hataja do tē bëhej sonte.

— Po ç'u bënë? A e thyen qafën?

— Ku ta gjesh ta thyenin, — u përgjigj pla-

ku. — Mbenë këtu... Thonë se i mori në konakët e tij ai bajra... agai.

Jashtë shkreptiu dhe atij i mbeti fjala në gojë.

— Bëhen shumë? — e pyeti ajo, duke u përkulur nga ai.

— Një bylyk, — tha plaku Lelo. — Të gjithë të mbërthyer kokë e këmbë në hekur. Eshtë turp i dheut tu' thuash njerëz atyre biçimsëzëve... Apo nuk u kallën datën fëmijëve me ato armët e zeza si të mbira në bark.

— Po fshati? A i ndihu fshati Mëngorët?

— U ngjitëm gjer atje, po nuk na lanë të afroheshim. Na i zbrazën mbi kokë ato armët e zeza. Vetëm njerëzit hoqëm mënjanë... Po ti, nuk i dëgjove të shtënat?

— Unë?... Jo, — tha pa të keq gruaja e mblo-dhi supet pas qafës si të mërdhinte. — Ndofta i kam pandehur shkreptima.

— E po, na, shikoji gjurmët atëherë, — tha plaku e lëvizi vrulltas mbi rrugoz.

Ngriti dorën mbi krye dhe hoqi festen nga koka me rrëmbim. Nga shtrëngimi i grushtit, mbi plloçën e vatrës u rrëzuau pika uji.

Sytë e gruas u hapën me habi. Festja e tij që shpuar tejpërtej si me një gozhdë të nxehjtë. Përreth vrimës, qimet e buta ishin përzhitur. Nëpër të dallohej përcëllimi i zjarrit.

— Shpëtova paq, — tha plaku e ia përcolli në prehër së shoqes.

— Ohh, — bëri ajo e ligështuar, — iu thaftë dora, katilit! — dhe e mbështolli shuk në grushë, si të kishte frikë mos e qëllonin përsëri.

Pas fjalëve që u këmbyen, në dhomë ra një heshtje e nderë. Dëgjoheshin vetëm ngashërimet e lehta të gruas. Sytë e saj qenë lëngështuar.

Ajo puliti qepallat. Mbi faqet e rrreshkura iu këput një lot.

— Edhe ne e kemi djalin në mal, — foli ajo me pëshpërimë.

Plaku u ngrit, u çapit për nga e shoqja dhe i mbuloi supet. Trupi i paktë i saj hovte përpjetë nga ngashërimi.

Shiu vazhdonte të binte me rrëmbim. Kohë më kohë shtëpia e vogël dridhej sikur do t'i zbërtheheshin muret. Burrë e grua rrinin të heshtur si pa gojë. Dukeshin sikur dremitnin, po në të vërtetë gjumi nuk u vinte në sy. Secili bluanë në mend ato që kishte parë e dëgjuar atë mbrëmje. Nuk dihej sa kishin që rrinin ashtu. Erdhi një çast dhe kokat e tyre u zgjatën në përgjim. Ata shkëmbyen vështrime habie.

— Ndjeve gjë! — pyeti Lelo Pertusha.

— Si pushkë më ngjanë!

S'vonoi shumë dhe në portë dikush trokiti. Ato zhurma mezi vinin gjer brenda.

— Kush të jetë, o burrë!?

— Po hë! Ku di unë!

— Pastaj u dëgjuan shkoqur këmbë rrëzë murit.

— Lelo!... O xha Lelo! — thirri një zë pas kanatit të dritäres.

Edhe zëri ishte i pakët, ndaj ata nuk mundën ta shquanin dot. Plaku brofi në këmbë duke u mbrojtur pas murit të oxhakut.

— Prit njëherë, — e luti gruaja. — Mos ia hiq rezen!

— Kush je ti, more!? — pyeti Lelo Pertusha që brenda me faqen mbështetur në kanatin e stohtë.

Unë Sykoja, xhaxha... Sykoja i Hajdinit jam.

— Kë po djegin?

— Hiçnjeri, — ia ktheu ai përjashta. — Po ti dil e na hap portën, se kam një llaf.

— Erdha, bir, erdha, — tha plaku e rrëmbeu kandilin. Nga nxitimi vetëm sa shkeli në opinga. Hoqi llozin e u ndodh ballë për ballë me djalin që quhej Syko. Era e lagësht e natës ia rrahu gjoksin dhe e bëri të rrëqetëj. I porsaardhuri gulçonte.

— Shuaje kandilin, — i tha ai dhe nuk priti, por e shoi vetë me një të fryrë.

— Fute brenda djalin! — thirri gruaja që nga dhoma.

— Hyr, o Syko; e na thuaj, ç'ishin ato pushkë?

Tjetri, sikur të mos e kishte dëgjuar, as nuk hapi gojë e as nuk kapërceu brenda pragut. Ashtu në errësirë Lelo Pertusha e ndjeu se tjetri po ia fshihte shikimin.

— Fol, ore... Si është puna? Ke një llaf më the!

— Kam sjellë dy partizanë. Te pusi i lëmit janë... Duan... të bisedojnë veças, — foli me zë të penguar Sykoja. Tani, ndryshe nga më parë, tek fliste, fryma e ngrohtë e tij i përplasej plakut në fytyrë.

— Veças the!? Po përse!?

— Me mua doli edhe Kalemi. Gjermanët na pikasën, po Kalemi theri përpjetë nga korija që të humbiste gjurmë, — tha tjetri.

— Më thuaj ç'ka ngjarë! — ngulmoi plaku dhe ia shkundi bërrylin që ia gjeti në errësirë me hamendje. Atë çast zemra e tij ndolli për keq.

— Kanë me vete Dalipin...

— Dalipin!?

— Xhaxha, — belbëzoi Sykoja më dhembje e i lëshoi kokën e lagur në gjoks.

Plakut Lelo i erdhi i papritur ai lajm. Për një çast iu morën mendtë prej hidhërimit. U hutua, u rrëmbush dhe gjunjët iu bënë të pafuqishëm për ta mbajtur në këmbë. Në gjoks zemra i rrihte harbuar, sikur do t'i dilte nga kraharoni. U përpoq të lëvizte, të thoshte diçka, por buzët nuk i bindeshin. Vetëm mundi të mbështetej me kurriz në parvazin e portës. Aty, si në një ëndërr të gjatë e të trazuar, iu fanit i biri i burrëruar, ca flakë të mëdha që harboheshin përpjetë duke lëpirë errësirën, pastaj një palë krushq që zbraznin pushkë hipur mbi kuaj, një nuse e veshur krejt në të bardha... Safet Brinja i ulur, në një sofër me gjermanët, e shoqja e kruspulluar në kënd... Por gjer aty, se përfytyrimi iu këput në mes. Pas vetes ndjeu hapa që hiqeshin osh nëpër truall dhe bëri çudi. Nuk donte të besonte. Ktheu kryet mbrapa. Veshët nuk e kishin gënjer. U qirua nga duart e Sykos e u matë të lëvizte për andej.

— Ç'hall kishte djali, o burrë? Përse nuk e fute brenda? — e pyeti e shoqja me duart zgjatur përpara si e verbër.

— Ka sjellë dy partizanë ky... Kërkojnë t'u ndihim, — iu përgjigj plaku, duke u përpjekur ta mbante veten më sa mundte.

— Partizanët! — thirri ajo si fëmijë. — Ma ndjeu zemra, o Lelo, ndaj u ngrita. Po Dalipi!

A është Dalipi me ta?

— Jo, — tha plaku. — Nuk ka ardhur.

— S'ka gjë. Njëlloj është, — foli ajo e mallëngjyer, — thuaju të vijnë, o Syko, se i myti të ftohtët. U bën zjarr nëna, i than nëna ata.

— Vijnë nga larg... — ia rrëmbeu fjalën nga goja i shoqi. — Kërkojnë veg t'u ndihim. Një shok u ka mbetur në duar.

— Oi, oii! — bëri ajo me lëngim. — Ç'hall e paska gjetur nënëzezën!

«Ehh», bëri edhe plaku Lelo i trondit, pa fshehur përbrenda një psherëtimë. Por e mblo-dhi veten shpejt e tha:

— Po ti hyr, hyr brenda. Na e lër neve atë punë, — dhe e shtyu të shoqen lehtë. Pastaj u kthyte nga njeriu që rrinte si i harruar nën strehët e çatisë që rridhnin çurg.

— Syko, rrëmbe veglat!

— Ku janë, o xha Lelo?

— Këtu pas derës. Kërko me duar se i gjen.

— Djalin ma lër mua, — tha gruaja. — Ti nisu për vete se ja, erdhëm ne.

— Jo, — i tha plaku me ton të trembur. — Nuk bën mirë të dalësh jashtë... Ti je e sëmurë.

— Paçka! — ia ktheu ajo. — Ka nevojë tri-mi për një nënë pranë, — dhe sakal u tërroq brenda me shpirt të lënduar, duke u mbajtur pas murit.

Tek largohej ajo, u dëgjua gërvima e portës. Diçka trokëlliu. Plaku pëshpëriti fshehtas:

— Shiko se të shpëton goja, o Syko! Të paktën sonte të mos e mësojë. E kishte këputur malli për Dalipin... Zë e vë kujën dhe...

Jashtë flakëroi. Lelo Pertusha çau nëpër shi. Mbi supe i trokëllinin veglat e mihjes. Te pusi arriti me një frysë. Të dy partizanët që prisin atje, ia ndien hapat e i dolën përpëra. Plaku i toku një më një. Sa të ftohta i kishin duart ata!

— Si ngjau kështu, o djem!? — i pyeti.

— Mori plagë të mëdha, xhaxha. Në gushë e preu plumbi... Na kishin bërë pritë në Gurin e Përgjegjur, — tha njëri nga partizanët duke nxjerrë fjalët ngadalë, sikur numëronte tespihet.

— Si, — bëri çudi plaku Lelo, — që aq larg po e sillni?!

— E ku na hynte në sy rruga, — foli tjetri me keqardhje.

— Nder! të madh më paskeni bërë... Nuk do t'jua harroj sa të jem gjallë!

— E donim si vëlla Dalipin. Nuk na bënte zemra të ktheheshim e ta linim gjetkë. Plot njerez të mirë na e kërkuan ta mbanin, por...

— Më rrofshi! — uroi plaku e u rrahu supet.

— Ku e kam tim bir? Pa ta shoh njëherë!

— Më tej, xhaxha. Rrëzë murishtës së lëmit, — tha njëri prej tyre e hoqi rrugë. Plaku Lelo i shkoi pas.

Si ngjitën të përpjetën e një ledhi, partizani qëndroi. Plaku u ul gjunjazi me pëllëmbët e hapat. Diku më tutje preku diçka të ashpër që s'kishte të bënte as me baltën e njomur dhe as me barin e thatë. Nga ajo prekje u rrëqeth. Ishte trupi i të birit. Shokët i kishin hedhur përsipër një pallto të tyren. Futi dorën që i dridhej nën mbulesë dhe duke ngarë rrëshqanthi nëpër të i gjeti gushën. Gishtat iu qullën nga gjaku i mpiksur. «Bir, o bir», — mërmëriti me zë të përmalluar. Pastaj u përkul edhe më mbi trupin e ngrirë e i takoi ballin me buzë, në mënyrë që t'i priste rrugën ndonjë fjale të nxituar prej hidhërimit e të turpërohej në sy të partizanëve.

— Them ta vendosim në selishtë, — foli duke u ngritur. — Dua ta kem pranë që të çmalem sa herë... Më shumë s'bëjmë dot sonte..

— E mësuam. Në llafosi ai djali që na pruri deri këtu. Ju kanë ardhur «miq» në fshat. Përpak desh iu futëm në hundë, — tha njëri nga partizanët.

— Po ka akoma natë, — u hodh e tha tjefti duke rrahur kondakun e pushkës. Ai foli me

nofullat shtrënguar dhe zëri i doli si fëshkëlli-më.

Plaku lëvizi dhe ata e ndoqën nga pas. Shtynin degët e një peme e hapën rrugë nëpër të. Mbi krye u shkundeshin me fëshfërimë fletë të rënduara nga shiu që vazhdonte të binte me potere. Por ata ishin lagur gjer në mish e nuk donin t'ia dinin. Në trup gjaku u vlonë i nxehjtë. Dikush filloi të mihte. Dherat qenë ngopur qëkur dhe kazma ngulej thellë pa zhurmë.

Pas njëfarë kohe u dëgjuan ca çapitje afër tyre. Partizanët brofën dhe rrëmbyen armët e mbështetura pas trungut të kumbullës.

— Mos u druani, — u tha plaku atyre, — është ime shoqe. Po vjen të na ndihë. «Ka nevojë trimi për një nënë», tha kur e mori vesh. Ajo nuk e di që ju keni sjellë Dalipin tonë. Unë ia kam fshehur të vërtetën.

Partizanët qëndronin në këmbë pranë tij, të padukshëm nga nata, dhe mbanin vesh çapitjet e ngadalta të saj. Ata u tronditën prej atyre fjalëve që u tha plaku Lelo dhe heshtën.

— Veç mos më gjykonit për keq, o djem, — dhe u preku duart e mbërthyera pas hekurit të ftohtë të pushkëve. — Eshtë në të mirën e fshatit kështu... Në të mirën e... Dalipit.

Tek priste me ankth qoftë edhe një fjalë nga ata, nata u zbardh nga një vetëtimë e beftë. Jephona e bubullimës u prit e u përcoll nga honet dhe përrrenjtë aty pranë, si kur të mos donte të platitej. Atë çast partizanët mundën të shquanin midis degëve të pemës nënën e shokut të luftës, që zbriste në rrugëzën e ngushtë ku vetë kishin shkelur pak më parë. Dhe atyre u ngeli në sy ai trup i paktë i saj, mbështjellë me një cergë që i varej gjer poshtë këmbëve. Ajo mbante nën sjetull një bohçe.

— S'do ta harroj kurrë këtë natë, — tha partizani që kishte folur i pari kur u tok me plakun Lelo.

— Po Dalipi më la një amanet për nënën!

— tha tjetri me zë të ulët.

Gruaja u afrua edhe më, e ata ia dëgjuan edhe zërin:

— Ku e le, o Syko?

— Këtu! — tha ai i habitur.

Ndërkojë plaku Lelo shkundi degën e kumbullës, në mënyrë që ajo ta kuptione të vente atje. Ai ishte i tronditur e ndaj nuk i lëshoi zë.

— Pyes për atë trimin, — tha gruaja, — se ju ndjeva që përtej.

Sykoja e shpuri rrëzë murishtës duke e mbajtur për krahu. Tani plaku Lelò dhe të dy partizanët ishin larg. Ata as nuk mund të shquanin gjë dhe as mund të dëgjonin çfarë thoshte ajo atje. Fëshfërima e gjethive të mbeturë nëpër degë dhe zhaurima e shiut u oshëtinin në veshë. Po nuk mund të duronin gjatë në atë gjendje.

— Ti vazhdo të mihësh edhe ca, — i foli njëri nga partizanët shokut. Pastaj hodhi pushkën në sup e bashkë me plakun u nisën për tek ajo. E gjetën të pladosur mbi trupin e ngirë të Dalipit. Ajo herë ngrihej e herë binte përsëri mbi të. «Trim i nënës», «Dhëndër i nënës», — pëshpëriste me lëngim. Në duart e saj shpështilej një send që sikur zbardhët në terrin e natës dhe ata e morëri me mend se ajo po i vishtë diçka si një këmishë të bardhë.

— Vetëm qenke?... — Ku e ke Sykon? — i foli plaku Lelo, pa ditur ç't'i thoshte tjetër.

E shoqja nuk iu përgjigji, por ngriti kryet në drejtim të zërit e pyeti vetë me zë të mekur:

— Kush është me ty, o Lelo?

— Një partizan, — tha ai.

— Më jepni një dorë, — kërkoi ajo, pa iu drejuar askujt e lëvizi krahun. Në sfondin e zi krahut mezi u dallua zbehtë, por partizani ia gjeti pëllëmbën. Gruaja u ngrit me mundim.

— A u mbajt djali?... A la ndonjë amanet?

— e pyeti ajo me kërshëri, se e njoihu që nga dora se nuk ishte i shoqi.

Partizani u drodh. Aty për aty trupin ia mbuluan djersët.

— Kishteurrejtje të madhe vëllai ynë. Edhe pse me plagë, luftoi sa për dy veta bashkë... Nënës... kur të ma takoni... i thoni të mos derdhë lot...

— Po ju?... A do t'ia shpini amanetin në vend?

— Si jo, moj nënë, — tha i befasuar partizani.

— Prit njëherë, — ndërhyri plaku. — Fshati i këtij trimi është larg që këtej...

— Njëlloj është, — foli ajo me pëshpërimë.

— Ma thanë mua... Ja, në vend të saj po i kapërdij unë lotët, — dhe i fshiu sytë me mëngë.

Atë kohë pranë tyre u qas Sykoja. Ai mezi mbushej me frymë.

— Nënë Beje! Atje të gjitha u bënë gati. Edhe drutë, edhe barin e thatë e shpura. Bile edhe ca më tepër seç më porosite.

— Ikëm ne, o Lelo, — tha ajo duke u mbështetur fort pas krahut të Sykos, — kur të mbaroni punë, mi i sill të dy partizanët në shtëpi. Dua të qmallem si me Dalipin.

— Qofsh e ndëruar, moj nënë! — tha partizani, i prekur thellë prej fjalëve të saj. — Nuk vijmë dot. Kemi gjithë atë rrugë për të

bërë... Po me sot me nesër do të të trokasim vetë në portë.

— Ju pres, — tha ajo duke u larguar në-për natë.

— Sa ia pata frikën se mos ndodhte gjë me të, — belbëzoi plaku Lelo i lodhur dhe u përkul mbi trupin e të birit.

— Mua më duket se ajo e njohu, xhaxha,

— tha partizani duke e ngritur në duar shokun.

— Nuk ma ha mendja, — ngulmoi plaku.

— Ndryshe hajde ta mbaje atë.

...Po mbusheshin dy orë të mira që Lelo Pertusha qe kthyer në shtëpi. Rrinte në kënd me kokën mbëshetur në gurin e oxhakut e nuk ndiente të ngopur me tym duhani. Gjithë atë kohë jepte e merrte me vete se kur dhe me ç'fjalë do t'ia thoshte asaj të vërtetën. Nënë Beja i qëndronte përballë me supe të zbuluara, duke rrahur në havan një grusht me kokrra elbi të pjekur. Kryet e mbante me shikim në prushin e vatrës, sikur diçka e çmueshme i kishte mbetur atje. Por një rënkim i thellë i plakut e shkundi nga mendimet.

— Të të pjek edhe një kafe? — e pyeti ajo me mirësi.

Midis tyre ra përsëri heshtja.

— Ndqdhi tani... Po ti mos u ligështo, o Lelo ...Djalit ia bëmë të gjitha nderimet... — tha plaka.

— Partizanit, thuaj, moj grua, — tha plaku Lelo duke parë ngultas.

— Jo, ore Lelo, jo, — tha nënë Beja e tundi kokën disa herë me dhembje. — E njohu nëna të bulkurin e vet. Ishte Dalipi ynë... Ma njohu dora sa i preka ballin... — por nuk mundi të vazhdonte më tej. Porta e harruar pa lloz bëri zhurmë. Në hajat u ndien këmbë. Pastaj në dhomë u shfaqën dy yetë. Të zotët e shtëpisë i njohën. Ishin Kalemi me gruan. Në

çastin kur ata po ngriheshin t'i takonin e t'i bënin vend, në prag shkelën njëri pas tjetrit edhe shumë bashkëfshatarë të tjerë. Gojë më gojë lajmi ishte shpërndarë si era që frynte përjashta dhe njerëzit, pa e përfillur shiun dhe kërcënimin e të huajit, vinin aty që t'u ndodheshin pranë plakut Lelo e nënë Bejes, që ia falën djalin Luftës.

## Lulan Ostrovica

Në të perënduar të diellit në pyll pushoi së godituri një sëpatë që gjithë atë ditë vjeshte kishte mbushur vendin pérreth me atë kércitjen zhurmëmadhe të pasuar nga gjëmimet e drurëve që rrëzoheshin. Pastaj nuk vonoi shumë dhe nëpër rrugëzën e ngushtë, të baltosur nga kullimi i ujërave, e me bërrylakë, që zbriste tatëpjetë, po uleshin një kafshë e ngarkuar me dru të njoma të prera rishtas dhe i zoti i saj. Ky ishte një burrë i thyer në moshë, me fytyrë thate, i veshur me të shajakta që i rrinin lirë në trup. Në kurri zvarrë i varet që i rriten gjatë e me lëkurë të zhvoshkur kushedi përsë. Maja e trarit hiqej zvarrë dhe e bënte atë burrë të lëkundet sa majtas djathtas, duke e munduar keqas në atë zbritje.

Këlltuppp — këlltuppp, lëshonte kafsha këmbët mbi gjurmët e veta që kishte lënë në mëngjes. Stërkala balte ngriheshin, përpjetë duke i lagur barkun dhe gushën ku varej këmbora shamatore. Me llucë ishte spërkatur edhe i zoti, që e ndiqte një hap më tutje. Sa herë kafsha rrëmbehej që të shpëtonte nga ngecja nëpër driza, burri shtynte trarin anash e lëshonte zë:

— Prit, moj Larë, prit... Ja dhe pakëz të tatëpjetë kemi. — Nga buzet e tij zëri dilte përkë-

dhelës, tamam si t'i fliste një fëmije. Kurse kafsha ia kthente me hingëllimë, me kryet qarkuar përgjysmë nga ai. Shpejt e shpejt duart e të zotit, që e përdornin sépatën aq mirë, i lironin rrugën. Burri u druhej edhe shkurreve edhe gurëve të fshehur nën llucë, se kafsha mund të pengohej dhe e keqja bëhej në çast. Kur merrnin përsëri udhë, ai nuk i fliste por vetëm i përkëdhelte vithet e shëndosha zbuluar me qime të shkurtra e të buta. Në atë përkëdhelje ai ndiente ngrohtësi e njëherësh qullej nga djërsa e saj. Sa herë bënte këtë veprim, ligështohej e merrte inat me veten që Larën e kishte ngarkuar padashur rëndë.

— Të lodha ca, o e gjorë. Por edhe për të kullotur nuk hoqe keq. Të lashë të zgjedhësh bar sa deshe. Veç dije se që nesër e tërë javës do të bëjmë nga dy e tri rrugë. Dëgjon!?

Ndërsa ky i fliste, kafsha ngjishte hundët në gjoksin e shkopsitur të të zotit. Burrit iu ngroh mishi i zbuluar nga ngrohtësia e avulli që dilte gülçe-gulçe. Atij ia kishte ënda të rrinte një copë herë ashtu, por dita po thyhej e ca më tepër. i vinte keq për Larën me barrën e rëndë ngarkuar.

— Ikim, — tha e u nisën. Kaluan nëpër një lëndinë, pastaj ngjitën të përpjetën e një përroi me ujë të ftohtë brisk e sa më poshtë zbritnin, aq më, e thekshme ndihej oshëtima e lumit. Dy net më parë kishte rrjedhur një shi që nuk mbahej mend dhe nga më i motshmi i fshatit. Tamam sikur të ishte shpuar e shtrydhur qielli. Burri në të ecur e sipër qeshi me vete. Sepse atë çast iu kujtuan fjalët e plakut Myslim që kishte thënë: «Bjer, o shi, që të lahen ndyrësirat e luftës.» «Po kemi djemtë në mal, o bush», — që hedhur Rahmi mullixhiu. «Jashtë

është gjermani me ata larot e Ballit e jo djemtë tanë. Harrove sa djem e çupa të luftës mbajtëm në fshat dy dimra të tërë?»

— Djemtë... — belbëzoi burri nën zë e sytë iu rrëmbushën.

Ashtu, duke menduar e folur me vete, ai vuri re se kafsha i ishte larguar, kishte rënë në shesh e ecte buzë lumi. Por erdhi një çast që ajo u drodh e frikësuar, shtyhej përpara me ngulm duke hingëllirë egër. Ishte gati të kërcente përpjetë, të shkëputej nga i zoti që i mbanë kapistrën shtrënguar e të merrte vrap në drejtim të fshatit, që dallohej prej andej vetëm nga një tis i kuqërrëmtë tymi që përflakej nga rrezet e die llit në të perënduar. E kishte rritur vetë Larën e huqet ia dinte mirë, po një egërsim të tillë nuk ia kishte parë kurrë.

— Shiko, shiko. Po trembesh nga një kec!? — foli burri e i shkundi përpara hundëve kapistrën. Aty për aty hetoi me shikim nga ana e lumi, por nuk ndeshi atë që kërkonte. Shkëmbi që kishte shpëtuar nga mbytja një kec të vogël, të përhimtë, ndodhej shumë më poshtë se vendi ku kishin qëndruar. Blegërimat as që dëgjoheshin deri aty. Kafsha e ngarkuar turfulloi keqas edhe një herë dhe në atë lëvizje të shpejtë goditi me drutë majëmprehta shpatullën e të zotit. Goditja e sëmboi burrin, por kapistrën nuk e lëshoi. U dëgjua vetëm një si rënkim dhe përplasja e trarit ndër këmbë.

— Oj! Po kjo kështu!? — tha me zë, i habitur, dhe mbërtheu vështrimin në drejtimin ku shihnin sytë e xhamtë e të zgurdulluar të Larës. Me një lëvizje të shpejtë të krashut hoqi sëpatën nga litari. Atë çast nëpër degët e fletët e drizave aty pranë digka lëvizi me zhurmë. Iu bë se në drejtim të tij lëvizte një trup njeriu. Kjo disi e

qetësoi. Lëshoi një «uf» të gjatë, pastaj thirri gjithë inat:

— Kush je ti, more, se na hape punë?

Nga ana tjetër nuk erdhi përgjigje. Nga ato lëvizje të çuditshme përmbi rrugën e lumit burrej u bë nervoz e thirri përsëri:

— More, kush je, po të pyes? Hëë, ore, fol!?

— ndërsa dora që mbante sëpatën ishte ngritur përpjetë vetveti. Tek nuk po merrte përgjigje, mbushi gjoksin me frymë e diçka tjetër u mat të fliste. Por nuk arriti të nxirrte zë. Atë kohë para syve të tij u zbulua i plotë trupi i një partizani që kërcceu nga sipër, në rrugën gjithë baltë. Ky ishte një mesoburrë, nga ata që s'ia përcaktion dot moshën që ka në të vërtetë, ftyrërreshkur, veshur me një pallto të rëndë e me këpucë me qafa. Ky, si ra në rrugë, bëri përpara, në drejtim të të panjohurit që mbante i hutuar ende kafshën pér kapistre, kaloi pushkën nga krahqafa në dorën e majtë, me grykën shtrirë horizontalisht. Nga ana tjetër burri që priste më tej me këmbët ngulur në baltë lëshoi kapistrën e uli mbi opingë pjesën e metaltë të sëpatës. Që të dy hetonin vëmendshëm njëri-tjetrin. Fshatari rrahu me përkëdheli vithet e kafshës e u çapit në drejtim të partizanit, duke vënë buzën në gaz. Kur u ndodhën ballë pér ballë, hapi gojë i pari:

— Si je, o shoku partizan!? Rruga të paska larë në djersë!? — pyeti disi i hutuar nga ai befasim. Ndërsa me vete hahej pér brenda që të fshihte atë zemërimin e parë, kur ende nuk po merrte vesh se ç'po ndodhëte.

— Mirë, xhaxha!... Por edhe ti nuk qenke lodhur më pák, ama, — ia ktheu tjetri, i penguar nga dihatja. I zgjatën dorën njëri-tjetrit. Që të dyja pëllëmbët u shtrënguan fort. Pér disa

sekonda midis tyre ra heshtja, e cila trazohej nga tallazitja e dallgëve të lumit e këmbora e Larës që përtypte bar me hundët futur midis drizave.

— Ç'është gjithë ky nxitim?... Të ndjek njeri, apoo? — pyeti burri e në të folur e sipër ngriti sépatën në mënyrë të atillë, si të thoshte: «Tash-ti hiç mos ki merak. Jemi dy veta.»

— Jo, xhaxha, jo... Të më ndiqte kush mua, ia prisja hovin me këtë, — tha partizani e rrahu disa herë radhazi pjesën e drunjtë të pushkës.

— Unë të thirra. Përse nuk m'u përgjigje? — i tha fshatari duke lëvizur supin, që, me sa dukej, i therte ende nga goditja e druve të barrës. Pastaj nxori kutinë nga një xhep i thellë e shtoi:

— Na, dridh një duhan të fortë!

— Nuk të kam dëgjuar, xhaxha, — tha partizani, si për t'u shfajësuar. — Të pashë vetëm kur u hodha në rrugë.

— Po as tani nuk po më dëgjon, — e ngau fshatari me dorën e nderë që mbante kutinë.

— Nuk e heq, — tha partizani duke lëvizur duart në mënyrë të papërcaktuar. — Më rrofsh, xhaxha!

Tjetri nuk e ngau më. «E heq ti, e heq, po ke hall se mbetesh gjatë po ta dredhësh», foli me vete e shpejt e shpejt drodhi si dinte dy cigare të trasha dhe njérën ia afroi në buzë partizanit, pa i lënë kohë të kundërshtonte. Shkrepit masatin dhe i ndezën: Gulçet e para të tymit i thithën thellë. Pas një çike, partizani me cigaretën varur në cep të buzëve ngriti kryet të shijhte diellin. Po kulaçit të zjarrtë i dukej vetëm gjysma. Pjesa tjetër ishte fshehur prapa malit të Lenijes. Mënyra se si rrudhi ballin e si thithët tymin partizani, dëshmonin haptazi për ngutje të tepruar. Ai pyeti:

— Mban larg që këtej Gurakuqi?

Nga fjalët që dëgjoi, fshatarit iu çel fytyra. Ky vetë ishte nga fshati që kërkonte partizani e i erdhi mirë që do ta bënte rrugën bashkë më të.

— Është ca larg, por rrugën e kemi shesh më të shumtën. Ja, — dhe shtriu bishtin e së-patës në drejtim të fshatit që nuk shquhej prej andej.

— E po toke, xhaxha! Mua më duhet të iki.

— Prit, — tha fshatari, — të shpie xhaxhai ty. Nga Gurakuqi jam dhe unë, — e në të folur e sipër iu qas Larës së vet, i mbështolli kapistrën si mundi në samar dhe e fshikulloi lehtë me një shkarpë të thyer që e rrëmbeu ndër këmbë. Partizani qëndroi më tej e po e shihte ngultas. Kafsha shkrofëtiu e çau përpara dhe ata të dy dy nisën të ecnin krah njëri-tjetrit me hap të nxituar, me cigaret djegur përgjysmë.

— Pse nuk thua që do të qmallemi sonte, o shoku partizan. Na dogji malli t'ju shohim... Ke për ta parë vetë se si do të mblidhen njerëzit. Po bëhet viti që na zunë veshët karar nga plasjet e luftës. Hë, më ju lumtë, se ia skuqët gjermanit... Këtej nga ne, si nishan u kanë mbetur **kockat** dhe ca tase të **hekurta ku u hedhim** hirrën qenve. **Unë për vete qen nuk kam** dhe në tasin që më ra për hise i jap ujë Larës, ja **kësaj**, — e tregoi kafshën që tundej rëndë-rëndë nga pesha. Aq i ishte bërë qejfi fshatarit nga Gurakuqi, sa nuk po dinte si t'i lidhët fjalët. Partizani dëgjonte e qeshte pa të keq nën zë. Rru-ga përsëri i bëri të djersinë dhe tanë ata ndienin në fytyrë freskun e asaj mbrëmjeje vjeshte dhe ca pikla të imta shiu.

— Me sa ma thotë kjo imja, ti, o shoku partizan, nuk paske shkelur këtej. Apo...

— Mirë e ke. Vij për herë të parë, xhaxha; — u përgjigj partizani.

— E dee... — bëri tjetri e fshikulloi kafshën, që herë pas here rrrotullonte qafën në drejtëm të zotit.

— Oh! Po ti harrove trarin, xhaxha, — e kujtoi partizani.

— Nuk e harrova, jo. E lashë vetë... që mos të të vonoja.

— Stëngëz për pjergull e preve?

— Është shpejt vjeshta për stëngëza. Rrushve u ranë fletët qëkur. Për shtëpinë, o shoku partizan, për shtëpinë.

— Pse, ta shkundën shirat e pardjeshme shtëpinë?! — pyeti i habitur tjetri.

«Kur nuk e sheh, s'ke si e njeh», foli me vete fshatari.

— Gjermani, thuaj, se shiu këtu na lag e këtu thahemi. Po ti nuk ke faj, o shoku partizan, se vjen andej nga bëhet akoma luftë. Edhe mua, po të të pyes për andej, di vetë ç'të më thuash...

Partizani, tek dëgjonte fjalët e bashkudhëtarit, diçka belbëzoi. Më tej buzët e tij nxorën zë:

— Jemi ende larg?

— Po arrijmë, — tha prerë fshatari. — Gratë i ndezën kandilat. Ja, i shquan dot?!

Kur po qarkonin anash një korijeje me dushk, e cila pengonte të dukej i tërë fshati, fshatari ngau fjalën atje ku deshi.

— A njeh djem nga të Gurakuqit, o shoku partizan?

Sepse partizani bëri sikur nuk e mori vesh mirë atë që kërkonte bashkudhëtarit. E shikoi mi-

qësisht me bisht të syrit, sa e lejonte mugëtira, e pyeti:

— E si t'i njoh, kur thashë se nuk kam qenë ndonjëherë?

— Ta kam llafin për ata që kemi në mal. Se nuk ka shtëpi nga tonat që të mos ketë nxjerrë partizanë.

— E di, xhaxha, e di... Plakut Myslim i bë-hen tre... Ka Refatin, Alon... dhe...

— Shahinin e vogël, — ia rrëmbeu fshatari nga goja.

— Po, — pohoi partizani, pastaj shtoi: — Për Meleqin po e di...

— E morëm vesh dhe na dhembi zemra, — tha fshatari. — S'është mbushur muaji që në këmbë të tij u ngjit i ati, Ademi... A e njohe ti?

— Jo, xhaxha! Thonë se është goxha i moshuar...

— Eshtë, pos! I ka hipur të gjashtëdhjetat, — shpjegoi fshatari, pastaj, si të ishte kujtuar për diçka, ndali në vend e mbërtheu për bërryli partizanin.

— Na, more. Po pak më parë sikur më the se nuk njeh njeri nga tanët. Përse ma tirrje llafin?...

Ai që foli, dukej vërtet i nxehur. Sytë e tyre u ndeshën një hop në tisin e errësuar.

— Jemi në luftë, xhaxha. Harrove se keni në fshat edhe...

— Mos ma zér në gojë atë... Fshati u vuri drunë Shanove, — u hakërrye fshatari. Në të folur e sipër ky ndjeu mbi supin hollak dorën e partizanit.

— Xhaxha! A ta thonë Lulan Ostrovica? — pyeti papritur partizani.

Fshatari u befasua e gati sa nuk i ndali fryma.

— Ah! Po si kështu?! Unë e ti nuk jemi parë kurrë! Si më njeh!?

— Kollaj fare.

Lulan Ostrovica mblođhi supet i habitur. Ndërsa tjetri nisi të shpjegonte aty për aty.

— Ta njoju dorën në pyll Refati. Edhe këtë këmborë që na lezetoj rrugën... Nisu, më tha. Arrije. Është Lulani i fshatit tonë. Është yni. Të shpie ai në fshat...

— Pa shiko, pa shiko! Fatja thotë? — u gëzua si fëmijë fshatari. — Si është trimi?... Po e gjëzoke plakun Myslim, o shoku partizan.

— Thashë unë... — Do ta shikosh vetë si do të të mblidhet fshati sonte.

— Qiqër me shëndet e trim si e thirre ti, o xha Lulan. Një torbë plot me të fala më mbushi. Ndërkohë tjetri u bë i menduar.

— Po Faten ku e ke? Përse nuk e more me vete?! — pyeti nxituar Lulani.

— Më pret lart në pyll. Ashtu duhej, — tha partizani. — Po le të shpejtojmë një çikë se na mbajti llafi.

— More, shpejtojmë ne, vç më thuaj, mos i ka ndodhur gjë djalit?

— Asgjë, xhaxha. Të thashë, qiqër është.

— Ti, o shoku partizan, se çfarë më fsheh. Kot nuk është gjithë ky vrull që ke marrë. Mos ndoshta...

— Hiç mos të të shkojë mendja për të keqë të madhe. Po ja, ashtu na ndodhi. Dhe në vend të Refatit më duhej ta bëja unë këtë rrugë.

— E po për krushk nuk na vjen, de. Oj ky!  
— shfryu Lulani.

Partizanit iu qesh, por u përmbyt. Tani po u afroheshin shtëpive të para të fshatit e aty-këtu dëgjoheshin zëra njerëzish, blegërima e të lehura qensh. Lulan Ostrovica, pas fjalëve të

fundit që këmbyen, dukej i shqetësuar: Deshi të pyeste përsëri, por nuk mundi. Partizani, me sytë mbërthyer përpara, tha:

— Xha Lulan! Thua e gjejmë babanë e Re-fatit në shtëpi?

Tjetri u drodh nga një rrëqethje e fortë që i përshkoi gjithë gjymtyrët. Iu bë se në trup iu derdh gjithë uji i lumit që kishin lënë pas. Shqetësimi i parë e mbértheu përsëri. Me shkak pa shkak, zemra i ndolli keq. Dhe tha duke përtypur fjalët:

— E gjejmë, pos! Veç plaku Myslim nuk është kryetar i qëllimit. Kryetar kemi Sulon ne... Në vjen për punë të luftës, ec e tako Sulon... Në vjen për... — gjer aty e fshatarit i ngeci fjala.

Por nuk qe nevoja. Partizani e kuptoi ku donte të dilte Lulan. I erdhi keq që nuk mundi të bënte një pyetje tjeter.

— E shoh që padashur ta theva zemrën xaha. Më beso që nuk po vij të sjell gjëmë.

— Mirë, po të besoj, — tha me bindje Lulan Ostrovica. — Ja dhe shtëpia e plakut Myslim. Ajo që ka përpara atë lisin e madh në oborr, — e bëri përpara ta kthente Larën e tij në të majtë, ku ndaheshin rrugët.

— Epo, tokemi tani... Si të mbarosh punë, hidhu edhe në shtëpinë time. Nata e vjeshtës është e gjatë për llaf edhe për t'u çlodhur. Dije se të pres, o...

— Sadri, — tha emrin e vet partizani pa ia zgjatur dorën.

— Ta gëzosh! Hë, nuk po e tok!?

Më tej Lara e mbetur vetëm, pa e ngarë kush, kishte nisur të nuhaste bar anës mezhdës.

— Dua të trokasim bashkë në portën e plakut Myslim, — iu lut partizani.

— Dije se më lodhe, sot, o Sadri, — tha edhe me shaka edhe qortueshëm Lulan Ostrovica mbetur në këmbë. — Po përse, xhanëm?

— Si të ta them. Të më ndihmosh. Kam frikë se nuk do të merrem vesh.

— Lëre — lëre. Pus i thellë paske qenë, o i uruar! Mezi nxirrke ujë.

Sadriu qeshi i përbajtur e përqafoi fort Lulan Ostrovicën.

— Si e ke hallin? — pyeti Lulani e ndolli që aty manaren, në mënyrën e vet. Lara në çast iu afrua me hingëllimë duke tundur këmborën. Lulan Ostrovica e ngau djathtas atë dhe shtoi:

— Nuk më the gjë, o Sadri partizani.

Sadriu e nxori në krahun e pushkës fshatarin, i futi krahun e në të ecur e sipër nisi të fliste:

— Gjer në majë të ahishtës erdhëm mirë. Refati hiqte përpara se e njeh vendin. Unë pas tij, duke ngarë e yshtur përrugë katër mushka të ngarkuara me bereqet për spitalin partizan. Duke, rruga e gjatë, me të përpjeta e të tatëpjeta, na i këputi kafshët. Kur dëgjoj të më lëshojë zë Refati. Dal anash mushkave dhe e arrij. Njëra ishte rrëzuar. Këmba i ishte futur në një kllapë guri dhe i ishte thyer në kërci. Ishte e kotë të përpinqeshim ta ngrinim në këmbë.

— Ç'thuas, o Sadri? — tha Lulan Ostrovica me dhembje.

— E shkarkuam njëherësh. Ta ndanim atë barrë, ishte gjë që s'bëhej. Edhe thasët e tjerë i kemi mbushur dëngëz. Ramë në hall. Ika, më thotë Refati. Më prit këtu. Ku do të shkosh, i them. Në shtëpi, ma pret. Të marr mushkën. Babai nuk ma mban. Jo, i them. Nuk bëhen kështu këto punë. Unë jam intendant i them... Nuk bëhen kështu këto punë. Unë jam intendant i them...

Atëherë dëgjuam sëpatën tënde. Ai të njohu. Dhe, si të tregova më parë, të rashë në gjurmë e ja ku më ke tanë.

— Po ta kishe lënë, o Sadri. Ta shihnim e të na shihte Fatja.

— Nuk e ke keq, xha Lulan, por plaku Myslim nuk e ka gjetur në udhë mushkën. Ka rrëgulla lufta. Edhe intendentët kot nuk i ka nxjerrë.

— Oj! — bëri fshatari. — Mushkë do të merrte Fatja, mushkë do të marrësh edhe ti. Me bisht e me këmbë njëlloj...

— Nuk është njëlloj, — tha partizani duke ngadalësuar hapin në të përpjetën e selishtës, fare pranë shtëpisë së plakut Myslim, ku nxinte nga nata lisi i oborrit. — I ati do t'ia falte. Kurse unë do të bëj pazar. O me lekë të thatë një pér një, o me vërtetim.

Lulan Ostrovica qëndroi e i preu udhën. Sepse mori inat nga ato fjalë që i vranë veshin.

— Mos të të vijë keq, partizan Sadriu, por ja ku po ta them: Ose je intendent kërthi, ose nuk e njeh hiç Gurakuqin me njerëzit që ka. E bëre hak të të lëshojë qentë plaku Myslim, por shpëtove mirë.

Në këtë e sipër ky ndolli Larën. Kafsha qëndroi duke hingëllirë.

— Hajde shkarkojmë. Dil e zër litarët, — tha me ton urdhërues Lulani. — Hë, deee! Zgjidh, o Larën, o... — sepse nuk deshi t'ia përmendte fjalët: «qentë e plakut Myslim».

— Më ndihmo, të thashë!

Partizan Sadriu u zu ngushtë. Doli në anën tjetër, lëvizi barrën e druve ngathët me gishta e sakaq ato iu derdhën ndër këmbë gjithë zhurmë. Nga ana e tij fshatari po mblidhët litarët e baltosur që i shtrëngoi në samar. Kafsha turfulloj

nga lehtësimi e fërkohej me hundët futur në gjoksin leshtor të të zotit.

— Të ma kishe thënë më parë, o i uruar. Kot e hoqe gjithë këtë rrugë,

Tjetri shtangu e nuk po dinte të ngiste llafin.

— Merre. Të qoftë... Hipja tani e arriji sa më shpejt, se mund të të zërë shiu.

— Pa dale... Ne... Unë jam intendent... — dhe diçka nxori nga xhepi.

— More, merre, po të them, se nuk ta dhashë ty... Në spital presin bereqetin e ti më tregon letra.

Duket, zhurmën dhe fjalët që këmbeheshin aty i dëgjuan në fshat. Dikush thirri:

— Ehej! A ka njeri, more?

— Jam unë, Lulan, — u përgjigj fshatari. — I thuaj plakut se po vij aty, — pastaj bëri ballë nga partizani e shtoi:— Hajde, udha mbarë, o Sadri! Faten ma puth, ja kështu, — dhe e puthi në ballë.

Edhe Sadriu e përqafroi i mallëngjyer nga ajo bujari e bashkudhëtarit.

Ndërsa troku i Larës bënte poshtë, sipër ngjitej Lulan Ostrovica me këmborën në dorë, që tringëllinte e mbushte natën me kumbime të embla. E kishte vendosur të rrinte një hop të madh me plakun Myslim, që kishte kapërcyer oborrin dhe e priste me portën hapur. Lulan ishte i sigurt se ky plak i mirë dhe i sertë do të zemërohej keqas me intendent Sadriun, kur t'i zinte në gojë atë punën e lekëve e të vërtetimit.

## Në një mëngjes me shi

Ishë mëngjesi i një së diele nënitori. Si përherë atë muaj, dita qe gdhirë me mjegull dhe me tingëllimin e çangës së varur në degën e gorricës së vjetër. Me atë tingëllimë të zgjatur ishin mbledhur e kishin shkuar në punë kooperativistët. Të parët kishin marrë përpjetë pendarët me qetë e mbrehur përgjysmë, me bishtat e damalukëve që hiqeshin zvarrë me zhurmë të mbytur, pas tyre kafshët e ngarkuara me farë e pleh të paketuar në thasë plastmase të bardhë.

Sektori i Malajt e kishte vënë punën përpara aq mirë, sa nuk mbahej mend ndonjëherë. Në të korrat e atij viti atë kishin arritur të prodhonin grurë sa gjysma e planit të të gjithë kooperativës. Për këtë gjë flisnin edhe gazetat, që ruheshin edhe në koleksionin e shtëpisë së kulturës.

Aty nga ora tetë mjegullat u shtynë përrenjve, të harbuara, e papritur nisi një shi dëbore. «Po kjo kështu», bënë çudi pleqtë e mbetur në fshat e hodhën sytë nga arat e malit, ku kishin përcjellë djemtë, nuset e fëmijët e shkolles. Secili prej tyre doli në oborr të shihte ç'bëhej përjashta dhe ndërkohë gjer në veshët e tyre, bashkë me oshëtimën e erës, erdhën të përzier tingujt e një orkestrine. Tingujt zinin fill

nga ndërtesa e re e shtëpisë së kulturës. Kishte vite që fshati ishte mësuar me këngët njëloj si me punën, por asnjëherë nuk kishte ndodhur që shtëpia e kulturës të gumëzhinte nga muzika që në të gdhirë të ditës. Dikush u zgjat mbi gardhin e oborrit e pyeti fqinjin:

— More, veshët më bëjnë mua apo vërtet bien saze!?

— Harrove nipërinë, o Kasem, — ia ktheu tjetri, duke hedhur supeve një thes leshi.

Nuk kaloi shumë dhe rrugëzat e fshatit u gjallëruan. Në oborrin e shtëpisë së kulturës, shtruar me rrasha guri, hidhrin hapa të nxituar njerëz me mbulesa të hedhura mbi kokë, me çadra për t'u ruajtur nga lloha e dendur. Hynin brenda në sallën e ngrohtë e ndienin t'u ngatërrroheshin nëpër këmbë mbi njëzet vogëlushë, të veshur me përparëse të bardha, që loznin e guitnin si pëllumba. Në njërin cep të skenës, përgjegjësi i shtëpisë së kulturës, Zakja, ishte harruar pas fizarmonikës e me sa dukej ende nuk kishte marrë vesh çfarë bëhej përjashta. Zakja i kishte hyrë thellë një valleje, mbante ritmin duke pérplasur në dysheme këmbën e djathtë, ndërsa me kokë i bënte shenja lodraxhiut të vogël që t'i vente pas. Në anën tjetër fyelltari, me veglën e drunjtë gati më të gjatë se vetja, bënte ecejake nëpër skenë pa u shqetësuar fare nga fizarmonika e Zakes e as nga dumdumet e lodrës.

Midis grave e burrave të moshuar, që po mbushnin sallën, dhe fëmijëve, që bënin potere duke ndjekur njëri-tjetrin, dukej trupi i gjatë i edukatores së kopshtit, që rrinte mbështetur në murin e dritates e nuk ia ndante sytë rrugës së përbaltur, ku pikat e rënda të shiut vazhdonin të mbushnin me ujë gjurmët e vrugat e qerreve. Nga mënyra si qëndronte atje dhe si fshinte me

pëllëmbë avullin që kishin veshur xhamat, të linte përshtypjen e një njeriu të merakosur. Përkrah saj, dy pleq të moshuar bënин të njëjtën gjë. Të gjithë dukeshin të shqetësuar. Pleqtë pinin duhan të dredhur, hiqnin tymin thellë e, ashtu në pritje e sipër, ngitnin fjalën pér festat, pér grurin e mbjellë, pér djemtë, nuset dhe fëmijët e tyre të rritur, që i kishte zënë shiu i beftë lart në arat e malit.

— Pér besë, ilaç i vajti farës së mbjellë ky shiu i sotëm, — tha njëri prej tyre.

— Kaluar ilaçit, thuaj! — pohoi tjetri me ballin mbështetur në xhamin e dërsirë, — vetëm tē kishte pritur tē paktën gjer në drekë, sa tē hidhët kooperativa edhe dorën e fundit tē grurit dhe tē kishin sosur ata njomëzakët e Llëngores, se na vunë në merak, — shtoi ai duke u kthyer me fytyrë nga edukatorja.

Vajza dëgjoi fjalët e plakut Balë. Psherëtiu thellë e përsëri fshiu xhamin me pëllëmbë. Ndërkohë pranë saj u afroa fyelltari i vogël, një flokëzi, djali i bariut Muço, me fyellin nën sqetull. Duke hukatur gishtat, ai foli si me ankim:

— Edukatore! Mua m'u lodhën buzët, — dhe u dha atyre një tē fshirë me kurrizin e dorës tërë.tul.

Ajo u përkul mbi fëmijën e buzëqeshi lehtë.

— Mirë! Pusho paik atëherë, — i tha me mirësi e i ledhatoi flokët e butë. Pér qeif tē fyellit, pas tij ishin turur edhe disa djem e vajza që filluan ta mbyttnin edukatoren me pyetje.

— Po fëmijët e kopshtit tē Llëngores përse nuk po vijnë? — pyeti një vajzë pak e imët, me emrin qëndisur bukur në përparëse.

— Harrove shiun, moj Gonxhe, — dhe edukatorja e ngriti hopa në krahetë dhe e uli në parvazin e drıtares.

— Oboboo, sa shi që bie! — bëri habi vogëlushja duke përplasur pëllëmbët.

Atë kohë u përsërit një gjëmim që bëri të dridheshin muret. Llambat e varura në tavan u luhatën një copë herë.

— Hë, se dimri ka edhe bereqet! — tha një zë andej nga kreu i sallës, ku kishin zënë vend burrat e prisnin të shikonin shfaqjen që kishin përgatitur fëmijët e kopshtit.

— Shiko, o Lame vëllai, shiko ç'bëhet andej, — ngriti zërin plaku Balë e ngau me bërryl shokun.

— E de, sikur nuk kam sy e shikoj unë, — u përgjigj tjetri.

— Jo, more, jo! Them të shikosh zjarret që u ndezën arave të malit dhe në ato të Llëngores.

— Plaku Lame lëshoi xhaketën e shajaktë mbi një stol aty afër e bëri prapë në vendin e parë. U ngjesh puq me trupin e plakut Balë e po vështronë me kureshtje përjashta.

— Ngrohen!... Thajnë rrobat djemtë! Se hëngrën shi në trup, jo llafe, — tha me vështrimin e mbërthyer larg.

Edukatorja e kopshtit me sytë disi të përskuqur nga të mbajturit gjatë në rrugëzën e ngushtë, që lidhte Malajn me Llëngoren, pas fjalëve që shkëmbyen pleqtë, numëroi me vete më shumë se njëmbëdhjetë zjarre e fjolla tymi, që bënин përpjetë me vrull. Pesë prej tyre digjeshin në sinoret e fshatit fqinj. E, ndërsa në trup ndjeu mornica, belbëzoi: «Ah, sikur Verorja të mos i ketë nisur për këtej fëmijët!».

Tingujt e veglave muzikore që nuk kishin të pushuar dhe gjithë ata sy njerëzish që drejtoheshin nga ajo e sikur pyesnin: «Po hë, moj bijë!», e kujtonin se programi i fëmijëve nuk duhej të vononte. Ata, që porsa kishin hyrë bre-

nda, kishin thënë se me atë shi që ishte derdhur përjashta, edhe përrenjtë po i ngjanin lumi të tyre. Por ajo kishte vendosur të priste edhe më. Nuk i bënte zemra që fëmijët të këndonin e të hidhnin valle në kohën kur asnjeri nuk e dinte me siguri ç'bëhej me të vegjlit e Llengores.

Dikush nga burrat nxori nga xhepi i jekut orën me zinxhir e i foli shokut që kishte në krah:

— Kapërceu dhjeta e shiu nuk ka ndër mend të reshtë.

Vajza pranë dritares e dëgjoi dhe shikoi andej. Vështrimet e tyre u shkëmbyen gjatë. Njerëzve të mbledhur në sallë ajo u jepte të drejtë. I pati njoftuar nëpërmjet fëmijëve, me ca ftesa të shkruara bukur me dorë, ku shënonte se në orën 9.30 fëmijët e kopshtit, për nder të Festave të Nëntorit, do të jepnin një program artistik. Dhe ashtu siç ishin në garë dy sektorët fqinjë për punët e bujqësisë edhe kopshti i Malajt ishte në garë me kopshtin e Llengores. Në ftesë kishte edhe një shënim tjetër: «Programi artistik do të përsëritet edhe pasdite, në orën 16 për prindërit kooperativistë».

Deri atë çast ajo e kishte arsyetuar vonesën, sepse ende vazhdonin të vinin të ftuarit që priteshin me thirrje të gëzuara nga fëmijët.

— Hoplala, Erdhi gjyshi im!

— Ja, edhe mua më erdhi nënë Xika!

Ajo kthehej andej nga turreshin fëmijët dhe përshëndeste me krye herë një burrë thinjosh e herë një grua me shall të leshtë hedhur në kokë, që çapitej po me vrullin e rrugës drejt sobës së skuqur nga zjarri.

Zakja qe ngritur nga karrigia dhe po shikonte sallën disi i çuditur.

— Heu! — bëri ai kur pa tërë ata njerëz që i njihte kokë më kokë, por që nuk i kishte parë kështu asnëjëherë edhe kur vinte autokino-maja për të shfaqur film. — I paskan shkulur nga vatrat nipëria, — shtoi ai duke qeshur. Zakja montoi shpejt mikrofonin dhe zuri të numëronte me zë të lartë: një, dy, tre..., ashtu siç bëjnë teknikët e zërit në sheshet e mitingjeve.

Ky veprim i Zakes, që kishte mbetur në fshat për të shoqëruar të vegjlit me fizarmonikë, e bëri plakun Balë të thoshte:

— Drita, moj bijë!...

— Urdhëro, xha Balë! — tha edukatorja.

— Pa qasu pak!

— Duken gjë? — pyeti ajo me një frymë, duke i shkuar pranë.

— Jo, moj, jo! Them të nisim Zaken gjer tej, pastaj shohim e bëjmë.

Vajza mbledhi supet pa ditur ç'të thoshte.

— Unë gati jam, — tha Zakja.

Plaku Balë i bëri shenjë me dorë të zbriste nga skena.

Atë çast salla gumëzhiu koras nga thirrjet e vogëlushëve. Sa ishin në atë sallë, u kthyen dhe panë brenda pragut komandantin e nënrepartit kufitar, të lagur gjer në mish nga lloha. Sa hap e mbyll sytë, atij iu pre rruga prej gardhit të dendur të fëmijëve. Vogëlushët shtyheshin drejt tij dallgë-dallgë dhe pa pritur radhë i kërcenin në qafë. Komandanti qeshte i habitur nga ajo e papritur e bukur dhe nuk e gjente dot se përsë ishin mbledhur fëmijët e kopshtit në atë sallë. I rrëmbente një nga një në krahë, i përkëdhelte e i lëshonte ngadalë në anën tjeter. Po ku mbaheshin ata. Më të voglin e fëmijëve, një vajzë faqekuqe, që mundi të zinte vend e fundit në krahët e tij, komandanti e pyeti:

— Pa i thuaj xhaxhait, moj Mira, pérse qen-keni mbledhur si bletét këtu?

— Pér këngë e pér valle, xhaxhi! — ia pati vogëlushja duke tundur mbi supet e lagura të tij një shami të vogël gjithë lule.

— Oh, sa mirë, sa mirë! — tha ai pér t'i bërë qejfin e shtriu dorën pérpara të vështron-te orën.

— Xhaxhi! Rri, mos ik, aman, — iu lut që poshtë Vjollca, duke ia marrë dorën në pällëmbët e ngrohta të saj, siç bënte çdo mbrëmje me të atin, kur kthehej nga ara.

— Nuk do të shkoj, jo. Po qëndroj t'ju dëgjoj edhe unë, — premtoi ai.

— Po xhaxhi kufitarët pérse nuk i solle? — e pyeti një fëmijë, por komandanti i postës nuk e dëgjoi, se ndërkokë plaku Balë i zgjati kutinë me duhan, kurse një tjetër, që kishte në krah, i afroi çakmakun e ndezur.

— Shoku Benan!? — tha Drita. — Ju po ngjiteni në postë, apo tani po vini prej andej?

Tjetrit iu duk e çuditshme ajo pyetje, ndaj po e shikonte vajzën me vëmendje. Pastaj ai vështroi vrullshëm majtas, djathtas. Edhe në sytë e të moshuarve gjeti të njëjtën pyetje.

— Pér lart e kam rrugën. Malkina e pati zor në baltën që u bë dhe e lashë në hyrje të fshatit. Dëgjova zëra këtu dhe u ktheva.

— Na gëzove, o shoku Benan. Po hajde, hajde të marrësh një të ngrohur, — tha plaku Lame, duke i hapur rrugë drejt sobës. Drita dëgjoi përgjigjen e tij e lëshoi sytë përdhe. Padashur asaj i shpëtoi një psherëtimë e thellë. Komandanti e kapi përnjëherë pezmatimin e vajzës dhe pyeti me kureshtje të hapët:

— Po ju nuk më thatë, shoqja Drita, pérse më pyetët?

— Ka hall bija jonë, o komandant. Pret që-kuri të vijnë këtu fëmijët e kopshtit të Llëngores, por ata nuk duken. Ka meraq se i ka zënë lloha rrugës, — shpjegoi plaku Balë.

— Po në telefon a pyetët?

— Provuam tërë mëngjesin por është prerë linja, — u hodh e foli që prapa një burrë thinjosh me llullën kafshuar ndër dhëmbë.

— Kot të presim më! — tha Zakja duke lëvizur dorën në erë. — T'i hipi në skenë fëmijët unë? — iu drejtua ai Dritës.

— Dale, mor i uruar. Nuk të pritet, a!? — u nxeh plaku Balë — Hajde, shtrëngo opingat e ngjitu përpjetë në breg. Atë bëj ti, se m'u theke mirë sot...

— Se mos më tha njeri mua e nuk shkova, — tha Zakja, i druajtur nga hakërrimi i plakut.

— Dëgjo ti, djalë! Më kollaj e ke të zbresësh në fund të fshatit, — tha komandanti i postës. — Merr makinën se ia vlen të bëjë rrugën gjer në Llëngore.

— Të lumtë, goja, o shoku Benan!... — uroi dikush.

— Ika, — thirri Zakja dhe mori vrull të dilte. Por vrulli iu pre në mes. Atë çast në derë u dha një kufitar bojalli me dy fëmijë në krahë. Të vegjelvë vetëm fytyrat u dukeshin nën pelerinë. Ata e kishin rrrokur për qafe kufitarin dhe e shtrëngonin sikur nuk do t'i shqiteshin kurrë. Në gjurmë të të parit kapërcyen brenda pragut edukatorja e kopshtit të Llëngores dhe shtatë kufitarë të tjerë me fëmijët në krahë.

— Erdhën pëllumbat e Llëngores! — tha plaku Balë.

Grumbulli i burrave dhe i fëmijëve që ndodheshin në sallë u shtynë anash dhe hapën sa-

kaq, në mes tyre, një shteg nëpër të cilin zunë të kalonin të porsaardhurit, që dihatnin të loddhur.

— Këtej, këtej, — u bënte zë e hiqte udhë plaku Lame, i gëzuar si i vogël.

— Ju lumtë, djem, ju lumtë! — u dëgjua një zë gruaje.

— Paçi faqen e bardhë! — uroi plaku Balë.

Kufitarët kalonin pranë burrave e grave që ndodheshin aty, të ndjekur nga urimet që nuk i thoshin veç buzët, por edhe zemrat e tyre. Ndërsa komandanti i nënrepartit vetëm u rrihte supet me pëllëmbën e madhe, pa thënë dot as edhe një fjalë. Në fytyrën e tij rrudhat sikur u shkri-në e humbën brenda minutës. Ajo fytyrë, që pak çaste më parë dukej e shqetësuar, tani rrëzëllente nga një ndjenjë krenarie e veçantë.

Edhe Drita nuk nxori fjalë nga ajo e papritur. e bukur. Sytë iu njomën nga tronditja e brendshme. Ajo, pasi i shtrëngoi dorën sérishmi komandantit në shenjë mirënjojeje, u shkëput prej tij dhe rrëmbeu nga krahët e shoqes dy fëmijë që qeshnin e gëzonin. Një gjë të tillë kishin zënë të bënин me kohë edhe gratë. Ato shtrëngonin të vegjlit, por, për çudi, ndienin se ata ishin të ngrohtë vetë, sikur gjithë rrugën të kishin qenë mbështjellë në lesh. Pranë tyre afro-heshin fëmijët e fshatit Malaj, me një lloj hutimi të papërcakuar që u shkaktoi ardhja e kufitarëve.

— Uluni të ngroheni edhe ju! — u lutej plaku Balë dy prej kufitarëve.

— Faleminderit, xhaxha — tha një djalë turpmadħ dhe, ndërkohë, nxori përpura vetes edukatorët e kopshtit të Llengores, Verën, që ishte lagur keq. Flokët e saj ikullonin.

— Po folu, o komandant, de, folu, — u nxeh

plaku 'Balë. — Nuk e sheh që nuk dëgjojnë të marrin një sillë?!

Oficeri qeshi pa të keq me fjalët e plakut dhe tha:

— Mos ua vini re, xha Balë. Janë rini ata, jo si ne.

Si tha kështu, u hoq më tej. Pas tij shkuan të tetë kufitarët.

Ai qarkoi sytë mbi kufitarët me një vështrim të émbël dhe tha:

— E nderuat postën, o djem, ju lumtë!

Në veshët e kufitarëve fjalët e komandantit tingëlluan si një përgëzim solemn, si të kishin kryer jo një detyrë të thjeshtë në kohën e lirë, por një detyrë të rendësishme luftarake.

Ndërsa skuadra e kufitarëve dhe komandanti i nënrepartit ngjiteshin përpjetë bregut, nën tisnin e llohës, që s'kishte të pushuar, ndihej jehona e gëzueshme e këngëve të vogëlushëve.

## Tri krisma në fushë

Korriku i vitit 1948 hyri me mot të qëruar dhe dielli me ditë e me orë po u jepte grunjérave nga ngjyra e tij. Zverdhëllimi i menjëhershëm i arave i kujtoi fshatarët e Lulëzës të nxirrin nga hatullat drapërinjtë pér t'i mprehur në kovaçhanë, ndërsa kryesinë e kooperativës, të mendonte edhe pér një rojtar të dytë fushe, meqenëse vitin e kaluar u ndien dëmtime në pronën e përbashkët.

Me përjashtim të shamatës që u bë me djemtë e Sinapllarëve pér duajt që u vodhën dhe pér zjarrin që ra në mullarët e jonxhës nuk u mor vesh asgjë tjeter.

Përderisa nuk ishte arritur të mbërthehej në çark keqbërësi, edhe dhembja e hamendjet e fshatarëve ishin të shumta. Flitej se që të gjitha zullumet i kurdisnin Sinapllarët, po kishte edhe nga ata që nisen të shihnin me sy të dyshimtë edhe ato katër a pesë familje që ende nuk kishin hyrë në kooperativë e vazhdonin të punonin pér hesap të tyre si individë.

Po sidomos që mendohej e flitej, një gjë ishte e vërtetë pér të gjithë: lëmi po i trokiste i mbarë kooperativës së Lulëzës, e nga ky shkak ndoshta dikush ziente nga marazi e përpinqej t'i vinte këmbën asaj, ta kafshonte si mundtë e ku mundte.

Si rojtar u vendos Luman Bresheniku, një ish-partizan i vjetër, që për pushkë e për punë shok kishte velen. Ndoshta ngaqë kishin luftuar bashkë a ndoshta ngaqë Lumani ishte nga të parët anëtarë të kooperativës, kryetari e kishte atë më shumë si vëlla, sesa si bashkëfshatar.

Që nga ajo ditë që Lumani hodhi në krahë pushkën dhe në qafë dylbinë, fushata kishte hyrë në javën e dytë. Fshatarët kishin zbritur në ara me drapërinjtë e mprehur e kishin rrëzuuar më shumë se gjysmën e grurit. Në depon e drithit qerrexhinctë shkarkonin thasët e mbushur dëng. Nëpër lëmenj fëmijët ngitnin kuajt me të thirrura të gëzuara.

Gjithë atë gaz e vrull të punës së përbashkët, që bëhej për të futur bukën brenda, Lumani e kishte aq pranë, si të ishte vetë midis tyre. Ndërsa, që kur ky u caktua rojë fushe, asnjeri nga fshatarët nuk e kishte parë më. Dhe ata bënин çudi, për më tepër, se ia dinin huqet. Lumani i tyre edhe cigaren nuk e pinte dot pa shok e jo më pastaj të mos shkëmbente fjalë me ditë e me javë të tëra me njeri. Por a menduan keq ndonjëherë? S'mund të thoshe dot se humbja e tij nuk ngjalli dyshim. Vetëm të vegjlit, që kullotnin mezhdave shqerrat e kecat, e talkonin dendur e u gëzoheshin bilbilave prej shelgu që u bënte me thikën e xhepit.

Dhe ja. Ndodhi që në mbledhjen e fshatit brigadier Metja shfaqi dyshim për Luman Breshenikun.

— Pojaku nuk po bëhet i gjallë. Neve na u rrop lëkura në diell, kurse ai mérzen hijeve e merret me kalamajtë, — hodhi gurë në pellg ai.

— More ty të ha meraku për Lumanin, apo çë? — qe ngritur një anëtar i kryesisë në këmbë e kishte folur me nervozizëm, meqë i dukej se

tjetri po tallej. — Ja, brigadier tē kemi e tokēn nē sinor me Grepshtēn e ke. Ke pikasur gjë zarar?... Kêtē na thuaj! — kishte pyetur prapē e qe ulur i nxehur.

Po nē vend qē tē përgjigjej Metja, doli njē zē tjetër qē i mbajti ison:

— Mirë, o, mirë, po tē mos harrojmë se nē luadh tē shkretë kullotin edhe pelat e verbrā!

Ky ishte njē mesoburrë, i qullët, qē i bënte bisht punës. Fjalët e këtij kishin bërë qē plakut Beshir t'i ngriheshin flokët e thinjura përpjetë. Lëvizi më zor nē bankën e ngushtë tē asaj klasë ku bëhej mbledhja e iu lëshua me fjalët:

— Kush éshtë e shkretë, more edepsëz? Po ne vetë jemi kooperativa... Si ta nxë goja, xhanëm? Pastaj, puna ashtu ia do rojtarit tē fushës. Qē i ligu tē mos ia dijë gjurmën. — Xha Beshiri pëshpëriti edhe diçka tjetër, po nuk u mor vesh. Ndoshta u druajt nga gratë qē ishin fare pranë tij. Tak, tak, tak, përzihej me zhurmën e njerezve goditja é çibukut tē plakut mbi bankë.

— Për besë, more shokë, kot marrim nëpër gojë Lumanin, si tē jetë i huaj nē fshat e tē mos e njihnim. Edhe ai nuk e ka më tē lehtë se ne punën, joo.

Ata qē qenë me ballë nga presidiumi kthyen kokat prapa. Tē tjerët zgjatën qafat tē mos u shpëtonin fjalët. Ishte çuar e fliste e para vajzë, gjatë atyre dy vjetve kooperativë, nē një mbedhje tē gjerë. Edhe Shemsiu po e shikonte nē sy e bënte çudi me tē bijën, ishte apo nuk ishte ajo. Ndërsa dikush si Metja e si ai qulli prisnin qē Shemsiu ta pickonte me ndonjë llaf tē madh, po plaku i jepte zemër me kokë si t'i thoshte: «Ashtu, bijë, ashtu...»

— Në arat e brigadës sonë, — vazhdoi ajo,  
— as unë e as shokët nuk kemi parë tē na bë-

het dëm. Mes arave tona ne kemi çiban tokat e kulakut, po gëk s'po bën se... E meqenëse u hap ky problem, këtu në mbledhje, them që ta syrgjynosim kulakun me gjithë ara në shurishtat e lumit. Kaq kisha, — përfundoi ajo e u ul, e kuqe flakë, në mes shoqeve që zunë t'i çuçuritnin në vesh.

— Llaf me konak, — u tha nga fundi i bankave. Ata të presidiumit i buzëqeshën vajzës në kohën kur ajo ngriti kryet e po fshinte djersët në ballë e në faqe.

— Po, shokë, — e mori fjalën kryetar Dalipi, që u ngrit në këmbë, ndërsa njérën dorë e mbështeti mbi bllokun e shënimëve të sajuar me fletë parullash. — Këtë vjeshtë arat e Syko Sina-pit do t'i shtyjmë në anë të lumit. Kështu e pleguam edhe në kryesi dhe ata të rrëthit na e dhanë aprovimin. Në fund të mbledhjes do t'ju njoftonim edhe ju.

Pa u ulur mirë kryetari, klasa gumëzhiu nga zërat e fshatarëve. Ç'qenë brenda, ishin harruar pas mbledhjes dhe nuk po vinin re tymin e duhanit që po u merrte frymën. U desh prapë një zë gruaje që t'i kujtonte. Ata që rrinin ulur mbi pragjet e gurta të dritareve hapën kanatet. Pas-këtaj, bashkë me zërat e atyre që morën fjalën, u përzien edhe tingujt e këmborëve të dhënve që po zbritnin në lumë dhe çak-çuket e varesë së Beharit në kovaçhanën aty pranë.

Ndërkohe filloj të errej. U vu përrugë tufa e lopëve të kooperativës me gjintë të mbushur me qumësht nga kullota e ëmbël e arave të korrura. Ca nga ca zhurmat e ditës po fashiteshin. Gërvima e qerreve të fundit që po hynin në fshat të ngarkuara me duaj, palljet e lopëve, thirrjet e loparit që i ndiqte pas, po ia linin vendin korit të insekteve dhe cicërimës shurdhue-

se të zogjve të trembur, që fluturonin rrerës së gorrices së egër aty në fushë. Frushullimi i krahëve dhe ato cicërima ankuese ishin të vetmet zhurma që mund ta tradhthonin rojën. Por ai nuk zemërohej me shpendët, paçka se ato nuk u mësuani me të. Përkundrazi, i vinte keq që ndodhët ashtu.

Kur u err, mbi lëvoren e ashpër të trungut të gorrices rrëshqiti poshtë një trup njeriu. Kur preku tokën e u shqit nga pema, mbi supiu dallua tyta e pushkës. Ai u dha krahut të djathët pak anash e nxori para gjoksit dylbitë e futura në këllëfin prej lëkurë. Pastaj nga flokët e ashpër e nga xhaketa e shajaktë shkundi fije kashte nga ato që kishin ngetur degëve të gorrices, kur patën kaluar qerret e ngarkuara me duaj.

Pas një gjysmë ore, mbi rrugë e nën rrugë, Luman Bresheniku arri i afër sinorëve që ndanin arat e kooperativës me ato të kulakut Syko Sinapi. Më tej kapérceu kanalin e zuri vend pas një pirgu shëlgjesh të prera rrafsh me tokën. Vec trungjeve të mbëtura, aty ishin rritur sa një bojë njeriu edhe filizat e rinj. Atij vendi ia kishte vë në syrin që ditën nga pozicioni i tij i përhershëm. Përballë kishte rrugën. Në të majtë arën me duajt e grurit. Prapa kurrizit, një arkë me jonxhë të korrur. Për nga e djathë... ata. Sipas mendjes së rojës gruri i kooperativës i kishte joshur djemtë e Sykos. Sytë e qelqtë të dylbisë nuk e kishin gjennyer. Kot nuk ishin sjellë rrötull gjithë ato ditë e sidomos atë ndajnatë. Kërkoi me këmbë një vend të sheshitë e u shtri mbi bërryl. Trupin e ndjeu të lodhur e nuk e mbajti dot një psherëtimë të thellë. Sido që brenda kurorës së gorrices kishte sajuar një si shtrat të vogël, shtruar me gjethë

plepi e kashtë gruri, prapëseprapë këmbët nuk i shtrinte dot.

Freskia e natës bëri që t'i jepte jakës së xhaketës lart e me kindat e saj të mbulonte kërcinjtë. Piste në heshtje e me veshët ngrehur. «Po nuk i bëra të kërcejnë si ariu, mos më thënëtin në emër», — i kishte thënë kryetarit atë mëngjes herët, kur e thirrën në kryesi e i caktuan detyrën e rojtarit të fushës.

Një erë e lehtë filloj të frynte nga ana e grykës së lumit. Kallëzit e grurit zunë të fërkohej me njëri-tjetrin e bashkë me fëshfërimën e tyre u dëgjuan ca zëra të largët. Lumani u rrrotullua në krah e pa nga ana e fshatit. Në lagjen e sipërmë dalloj vagëllimin e dy-tre fenerëve që lëviznin së toku, që pastaj një e nga një u shpërndanë. Pas disa minutash mbeti një i vetëm që bënte përpjetë. Në atë drejtim ishte shtëpia e kreut, e Zaçes. «Ku të ketë mbetur kaq vonë», mendoi. Po zërat e mbytur që sapo dëgjoi dhe ata fenerë që lëviznin e kujtuan se atë ditë bëhej mbledhja e fshatit. Ndoqi me sy atë drithë të vágëlluar derisa ajo u fsheh pas avllisë a kushedi pas kujt, në kthesën e kroit. I erdhi për të qeshur e në të njëjtën kohë u tërbua nga inati. Gozhdë në zemër i kishte mbetur ai turpërimi i Zaçes para fshatit, e përsë pa, për zullumet e finokllékun e Sinapllarëve. Në mend i erdhi ajo ngjarje dhe filloj ta kujtonte nga e para. «Nuk kishte mbushur ende vitin si rojtar fushe. Djemtë e kulakut ia kishin hedhur me dhëpëri. Ata ishin futur në arën e kooperativës si nië mall të té atit, e ec e jak kishin bërë nga tetë rrugë ngarkuar me duaj gruri. Në anën tjetër, pas sinorëve, ishte edhe një i tretë që i priste e çoc bënte me duajt e vjedhur. Ato tetë rrugë që bënë ata ishin barabar me një vrah lëmi. Zaçja i

pikasi po nuk u lëshoi zë. Që atë natë frymën e mbajti në fshat. Mëngjesin që gdhiu, në fushë u bë shamatë e madhe. Sinapllarët kërcenin përpjetë e ankoheshin se kot u binte më qafë fshati. Ishte ujk plak Sykoja. Mbillte misër kooperativa, misër mbillte edhe ai, aty pranë. Hidhte farë gruri kooperativa, farë si ajo hidhte edhe ai në arat e tij. Zaçja betohej për tokën e përiqellin që ata po e vidhnin fshatin. Po më shumë mallkonte veten që nuik iu dha të shtrinte mbi sarrishtë ndonjërin prej tyre, pa të dilte ku të dilte. Ç'kishte ndodhur? Në kohën kur Zaçja ngjitej natën për në fshat, Syko Sinapi kishte zgjedhur selgjishtat e duajve e fët e fët i kishte lidhur me kashtë thekre, si ato të arës së tij. Kjo dhëlpëri e kulakut ngatërroi gjithë punën. Megjithatë, pa lagur nuk shpëtuan, jo. Këshilli ua skuqi mirë pas ca ditëve.

— Po tek unë do t'u ngecë keq, — pëshpërti Luman Bresheniku me duf. — Kot nuik e kam bërë gjumin haram.

U ngrit ndenjur, rregulloi pushkën në mes të gjunjëve e mbajti vesh. Po mbusheshin tri orë të mira që priste aty: Sytë e lodhur nga vëzhgimi i gjatë iu kapitën për gjumë. Afroi torbën që e kishte lënë ménjanë e nxori që andej një copë lakrori të tharë si kockë nga vapa. Nisi të përtyponte e hetoi nga ana e Moravës. Sipas tij hëna nuk do të vononte të dilte dhe... Po atë qast u dëgjua një shkrofëtimë kafshe. Me shkrofëtimën ai ndjeu edhe një sharje të ndyrë a një mallkim. Bëri torbën shuk në grusht, dhe pështyu ndër këmbë kafshatën. U ngrit më gjunjë e përgjoi nga ana e sipërme, andej nga nuik e priste. Sa vinte e bëheshin më të qarta ca trokëllima të ngadalta potkonjsh. Kur ja, zhurma u ndje në rrugë e mu përpara pritës së tij dalloi dy silueta kaf-

shësh. Mbi samarë të tyre të zotët. Nuk i kishte më shumë se dy hostenë larg e megjithatë nata e errët e pengonte t'i dallonte. Njerëzit nuk bëzanin.

— Thua të jenë kalimtarë? — pyeti veten Lumanin me sytë e përlotur nga përqendrimi i gjatë. Ndërkokë vendosi të dilte që andej e t'u binte pas, me shpresë t'i dëgjonte kur të hapnin gojë. Kafshët herë ndalonin e herë shtyhesin përparrë. Kjo lloj lëvizjeje i ngjallti dyshim Lumanit.

— S'e luan topi. Ata janë. Nuhatin, qentë, nuhatin, — pëshpëriti nëpër dhëmbë e qëndroi në vend. Nuk vonoi e ndjeu se trokëllimat e kafshëve po ndiheshin më afër. Më parë njëri, pastaj dhe tjetri, u hodhën në tokë. Zunë kafshët për kapistre, gjetën shtegun e qerreve e hynë në arë.

— E lëmë për sonte, vëlla, — u lut me gjysmë zëri njëri nga ata. — Dëgjomë mua. Ku fle uji, është më thellë.

— Kyçe, të shkretën... Lepur je, a ç'dreqin? — shfryu tjetri nën zë dhe e shtyu përparrë. — Dhe hëé, oburra, lësho litarët, se po del hëna.

«Trim i madh je, o i biri i Sykos.. Hajt, pa taq tregoj unë ty. Po nuk të bëra të mbash erë që një orë larg, po mos më thënçin në emër», fliste me vete Lumani e mezi e mbante vendi. Aq sa kohë duhet për të nxjerrë kutinë nga xhepi e për të dredhur një duhan, aq vonuan ata të ngarkonin kuajt. Vjedhësit rrëmbyen kapistrat e bënë të dilnin nga shtegu që hynë. Atë kohë bëri ballë Lumani.

— Pojakuuu! — thirri me tmerr ai që kishte thënë pak më parë «e lëmë për nesër», e u ngjesh me kurriz pas duajve të ngarkuar.

— Ku është, more? Apo të bëjnë sytë? — pyeti tjetri vrazhdë e doli përparrë.

— Këtu më ke, o trimi i Sykos, — qesëndisi me zemërim të patreguar Lumani. — E tashti, hajde të bëjmë një copë rrugë bashkë gjer në fshat... Me këtë rast takojmë edhe Zaçen, — Pas atyre fjalëve të thëna me një frymë kërcitj thatë edhe shuli i pushikës.

Ishte natë e Lumani nuk ua dallonte dot fytyrat, që me siguri duhej t'u ishin verdhur, djersët e ftohta, e atë lëvizjen që bëri dora e të madhit në brez. Heshtjen që pllakosi ato sekonda e prishnin vetëm mbllaçitjet e kuajve, që zhvatin kallinj gruri nga barra. Lumanit i theri në zemër ajo mbllaçitje e kafshëve që shpinin dëm bukën...

— Hëë, more edepsëzë, — lëshoi zë Lumani. — Zini kapistrat e dilni në rrugë!

Atëherë njëri nga vjedhësit kapérceu kanalin e doli në rrugë duke folur me të butë:

— Njerëz jemi e të merremi vesh njëherë.

Tjetri hoqi kuajt në anë të kundërt, nga ana e sinorëve të vetë me mendje t'u afrohej ca nga ca e t'i fshikullonte me litarin vitheve. Pastaj gjithçka mbaronte paq. Lumanit i shkuau mornica, kur nuhati dhëpërinë që po i kurdisnin. Të merrej me fjalë, do të thoshte të humbiste davanë. Dy krisma shurdhuese mbushën natën. Kuajt hingëllinë të trembur.

— Na vrave, o i marrë, — thirri me ankim ai që kishte dalë në rrugë. — Të thashë të merremi vesh.

Ndërkohë Lumani ndjeu diçka që i fërshëlleu hidhur mbi kokë. Brenda sekondës në trungjet e shelgjeve ku kishte zënë pritën, u ngul diçka me tërsëllimë, që ngjante me zhurmën e tehet të sqa-parit kur gdhend.

— Thikë, — belbëzoi Lumani me inat. Ja mbërtheu sytë siluetës që kishte pranë, e zbriti

poshtë tytën e pushkës dhe e mori nishan në kofshë. Atëherë hoqi këmbëzën e një krismë e tretë çau prapë natën. Sipër tij harkuan ca zogj të trembur, ndërsa më tej u palos vjedhësi, duke ulërirë nga kafshimi i plumbit.

Mbi Moravë kishte dalë hëna. Në fushë ishte ndërë një qdrithë e zbehtë e argjendtë. Duajt në arat e korrura fëshférin është nga era që i trazonte pareshtur. Mbi supe dhe mbi flokët që i vareshin ballit, Lumani ndiente vesën që tretej. Ndërsa përbrenda gjoksit një lehtësim të madh të paprovuar. Pushkën ende e mbante në dorë. Çapitej me hap është matur drejt rrugës për në fshat. Nën driën e hënës shikonte shpatullat e kërrusura të vjedhësve, që kishin ndërë dorën në arat e kooperativës dhe atë curril gjaku që kishte zënë fill atje. Po më shumë se fjalët, dhe kuajt e ngarkuar me duaj do të tregonte ajo thika e ngulur në trungun e shelgut, që Luman Bresheniku e la atje pa e hequr.

Në fshat xixëllonin kandilat. Tingëllimi kumbues i çangës nuk reshtte. Fshati ishte ngritur i gjithi në këmbë e njerëzit po vareshin poshtë drejt fushës. Më tej u dalluan siluetat e tyre. Në krye të tyre ai njohu kryetar Dalipin, Zaçen, brigadier Meten e të tjera me radhë.

## Gjurme

Ishte dimri i vitit 1949. Atëherë punoja si mësuese në fshatin Bukmirë, bashkë me një shoqë tjetër, që rrëmbente mbi mua edhe në moshë edhe në trup. Shoqja ime kishte qenë partizane dhe për mua ishte një shoqë e vërtetë. Më shumë sesa arma që mbante në brez, e burrëronte fjala. Në Bukmirë atë e dëgjonin dhe e nderonin të gjithë, sikur të ishte një bashkë-fshatare e vërtetë e tyre. Kurse ndaj meje njerëzit tregoheshin të kujdeshëm e disi të dhimb-sur, sikur të isha fëmijë e jo goxha vajzë e rritur. Por ata që ma largonin mërzinë e më lehtësonin punën e ditës, ishin nxënësit e mi, ca kolopuçë të vegjël e të bukur. Gjatë orëve të mësimit më shikonin në gojë si zogjtë dhe ndieja kënaqësi për këtë, sepse vërtet i mëkoja me abc-në.

Një mes javë, kur shoqen time e kërkuan të paraqitej urgjent në komitet për ta ngritur në përgjegjësi, unë e mbajta veten dhe nuk dhashë të kuptohej se sa më mërziti ikja e saj. Qaja nën jorgan. Pas dy ditësh shokët e këshillit të fshatit më thirrën e më njoftuan se më kishin caktuar në një bazë të re.

— Do të bëj si do të bëj këtu në shkollë, — u thashë unë.

— Vetém as qyqja nuk rri, — bëri shaka Banush Tarba, kryetari i këshillit.

— S'prish punë. Nuk kam as kohë të mërzi-tem, — ia ktheva.

— Léri ato! — më tha me habi njëri nga anëtarët e këshillit, i cili qëndrontë në krah të kyetarit e ngrohej pranë sobës, që bubullonte zhurmshëm në mes të zyrës.

— Harron shoqja Lenë se... — shtoi ai duke më shikuar vëmendshëm.

— Dilo! — thirri qortueshëm Banushi, duke i folur në emër shokut të vet.

S'ishte nevoja që Diloja të vazhdonte më. Isha e sigurt se ai do të më thoshte kështu: «Harrove ti, mësuese Lena, se me cilët shkëmbëjnë pushkë forcat e ndjekjes në anët tona? Nuk paske frikë të rrish vetëm?».

— Atëherë u vendos, — tha Banushi, kur unë heshta dhe nuk u përgjigja fare. — Hëpërhë do të qëndrosh në shtëpinë e Dilos.

Përsëri as fola, as premtova. Kur dola nga zyra e vogël dhe e ngrohtë, jashtë binte dëborë me flokë të mëdhenj, të dendur, sikur qellit të mos i kishte mjaftuar gjithë ajo masë e bardhë që kishtë situr tërë javën e javës, Frymën e mbajta në shtëpinë e një nxënëses sime. E quanin Manushaqe. Manushaqja ishte një vajzë trupgjatë, që nga shtati barazohej me mua. Për këtë kisha menduar qysh atë natë, që qaja nën jorçan. Ashtu si Banushi, edhe i ati i saj, Muho Shkëmbi, nuk mundën të ma kthenin mendjen, duke m'u lutur që të qëndroja në shtëpinë e tyre.

— Ti je e mençur vetë, — e mbylli bisedën më në fund ai. — Bëj si të jetë më mirë. Manushaqen ja tek e ke! — dhe, pasi hoqi pushkën nga gozhda në mur, doli me nxitim.

Nuk e di si e kuptoi këmbënguljen time nëna e saj. Ajo nuk u ridje e nuk mori pjesë në bisedën tonë, vecse doli e na përcollti deri në rrugë duke m'i mbushur xhepat me arra e mollë të mëdha të brydhëta. Kurse vëllai i Manushaqes, Masari, gjatë kohës që qëndrova brenda, rrinte galiç mbi detyrat që u kisha dhënë atë ditë. Ai ishte më i vogël se e motra, por, ngaqë mësonte shumë, shoqja ime, që iku, e kishte kaluar atë nga klasa e dytë në të katërtën menjëherë. Kështu ai e kishte arritur Manushaqen. Vura re se edhe atij nuk i erdhi mirë që u largova. Atë natë ne u vendosëm në dhomën time në shkallë. Atje u mbyllëm brenda që herët. Manushaqja iu përvesh ca punëve të lëna përgjysmë dhe m'u zotua se do të më kënaqte duke gatuar gjëra të vecanta të krahinës, ndërkokë që më tregonte lloj-lloj historish nga të fshatit, të cilat nuk i kalonin caqet e moshës së vet.

Gjatë natës kishte rënë përsëri dëborë e madhe. Në mëngjes, deri në dhomën tonë vinin zërat e burrave të fshatit që shkundnin dëborën nga pemët e çatitë e shtëpive. Ndërsa unë vazhdoja korrigjin e fletoreve, vajza rrëmbeu gjymin e zbriti në burimin e përroit për të mbushur ujë. Veç ta shikoje si ngrihej përpjetë avulli mbi burrim. Kur u kthyesh që andej, më tha:

— Mësuese! Janë ca gjurmë në oborr!

Mua më hipi frika, por e mbajta veten përrpara Manushaqes së vogël. U ngrita nga tryeza dhe dola nën tremën e sofatit mbi shkallë.

— Ja, ja! — tregoi vajza me gisht.

Vërtet, nën dëborën e re, që vazhdonte të binte, të zinte syri disa gjurmë të mëdha, por unë, duke qeshur, u përpoqa ta qetësoja.

— Kot mërzitesh, Manushaqe! — i thashë.

Ato janë gjurmët tona të mbeturat që në mbrëmje.

Pas një ore oborri u mbush me zërat e fëmijëve, që zunë të vinin me çantat prej lecke krahaqafë e me nga një kopaçë dru nën sjetull. Në të dyja klasat u ndezën sobat dhe unë fillova mësimin me nxënësit e mi. Në klasën e shoqes që mungonte, dhashë detyrë me shkrim dhe atje lashë ku destare Manushaqen. Si gjithmonë, edhe atë ditë fëmijët kishin ardhur të përgatitur e nuk prisin radhë të përgjigjeshin. Vetëm Masari në bankën e fundit kotej për gjumë. Unë nuk e ngacmova. E dija që ai nuk ishte nga ata që mund ta bënin me kast për t'u shpëtuar detyrave. E kisha parë me sytë e mi si përgatitej në shtëpi. Mbështetja ishte i sëmurë.

E gjithë dita më kaloj pa e ndier. Gjurmët e mëngjesit pothuajse i kisha harruar fare. Le që ku më linte Manushaqja, të mërzitesha me pyetjet që s'kishin të mbaruar. Po, për çudinë time, të nesërmen ndodhi e njëjtë gjë. Dukej hapur se dikush vërtitej në oborrin tonë, dikush përgjonte rreth shkollës. Ato ishin disa gjurmë të një këmbe të madhe, që i kishin rënë rreth e rreth ndërtuesës pikërisht nën strehët e ulëta. Natën nuk kishte rënë dëborë dhe ato tanë dallohen në shumë qartë. Të them të drejtën, përsëri pata frikë. Ku nuk më shkonte mendja. Thua të ishin gjurmë të njerëzve të dyshimtë? Apo bënte ndonjë shaka ai; Diloja!... Jo, jo! Atëherë ç'mund të jenë? Vendosa të njoftojë Banushin. Sa turp më vinte prej këtij! Por Manushaqes nuk ia tregova fare atë që pashë. Përkundrazi, zbrita shkallët e shprisha gjurmët me çizme deri tutje oborrit. Isha e sigurt se ajo do të alarmohej. Të gjitha këto pastaj ndonjë mund t'i shpjegonte si pas qejfit. Si i futa nxënësit nëpër klasa, frymën

e mbajta në zyrën e këshillit. Banushi u çudit kur më pa. Kushedi si isha bërë në fytyrë.

— Ç'të ka ndodhur, mësuese?! — më pyeti ai.

Unë nuk hapa gojën, se e dija që zëri im do ta bënte kryetarin e këshillit të vinte buzën në gaz.

— Ti kot nuk ke ardhur. Ke një hall...

— Dikush ka lënë gjurmë në oborrin e shkolles, — thashë unë e tronditur.

— Si kështu?! — pyeti me zë të lartë Banushi. — Shiko se gabohesh!

— Jo, — ia ktheva unë.

— Shkojmë, dhe i shkojmë njëherë, — tha ai më një frymë e kapërceu pragun. — Më duket një gjë e çuditshme!

— Prit, xha Banush. Gjurmët i prisha... Desha të mos trembej vajza, — fola duke i prerë rrugën.

— Keq, shumë keq, Lena! — tha Banush Tarba, duke më parë mendueshëm. Pastaj, duke kruar kokën, tha me ton të vendosur: — Nuk është e mundur. Ne e kemi gdhirë natën jashtë bashkë me forcat e ndjekjes. Në fshat nuk hyn dot më as miza e jo një njeri i dyshimtë.

— Më beso, xha Banush. Është e vërtetë kjo që po të them, — ngulmova unë.

— Po më çudit, moj bijë! — mërmëriti ai.

— Ç'ke ndër mend të bësh sonte?

— ...Nuk e di, — fola unë me gjysmë zëri duke mbledhur supet.

— Atëherë dëgjo këtu. Më mirë shko në shtëpinë e Dilos. — Toni ishte i prerë e urdhërues. Unë ngrita supet dhe po hetoja fytyrën e tij. Sesi më vinte të pranoja tanë... Duket se kryetar Banushi më kuptoi.

— Kur nuk do, qëndro në shkollë pa frikë.

Ne do të vijmë edhe andej. Veç të porosit që të mos e bësh fjalë me njeri punën e gjurmëve.

— Mirë, — premtova unë dhe u largova e lehtësuar. Më dukej se barrën e atij shqetësimi të paprovuar e kisha shkarkuar në pragun e asaj zyre. Merrët me mend se si kaluan orët e mësimit atë ditë. Megjithatë Manushaques së vogël, që më ishte bërë edhe motër, edhe shoqe, nuk i dhashë rast të kuptione gjë. Në dhomë u mbyllëm më herët se ditët e tjera. Prisja me ankth të zbardhët mëngjesi.

Të nesërmen u ngrita dhe e veshur përgjysmë nxora kokën në derë. Përsëri gjurmë në dëborë. Por këtë herë të shumuara. Midis tyre dallohej edhe ajo që më kishte shqetësuar e më ishte ngulitur në mendje. Nuk kisha dyshim se atë lloj gjurme e njihja mirë. U tremba e zura të dridhesha më tepër nga frika sesa nga të ftohtët. Hyra me rrëmbim në dhomë pér t'u veshur. Dukej lajmëruar Banush Tarba. Por nuk arrita të bëja asgjë, sepse ndërkohë ia behën fëmijët grupe-grupe e i shkelën të gjitha gjurmët. Ardhja e tyre, në vend që të më gëzonte, si përherë, më shqetësoi. Hyra në klasë e me një gjendje të turbulluar hidhja pyetje e dëgjoja përgjigjet e nxënësve. Po sepse në një qoshe të klasës fëmijët bënин potere. Ata flisin e qeshnin pér diçka. Ngrita kokën e hodha sytë andej. Masari kotej në gjumë dhë ata po e ngacmonin. Afrohem. Nxënësit më dégjuan dhe u qetësuan, kurse Masari u hutua. Koka i varej e sytë e tij puliteshi si në éthe. Thashë se nervat më ishin acaruar e nuk mendova më gjatë. Krahu më lëvizti në erë dhe pëllëmba, duke fshikur më parë faqen e tij, u ngjit me forcë në bankë.

— Kjo të bën mirë, ta nxjerr gjumin! — thashë me zë të lartë.

Në klasë sundoi një qetësi e nderë. Të dukej sikur edhe fryshtimarrjet e tyre kishin reshtur. Masari me mundim ngriti sytë drejt meje. Atë çast ndjeva të më digjinin majat e gishtave. Në këtë kohë trokiti dera. Pastaj ajo u shty e në të u duk Banush Tarba, që më bëri shenjë të dilja.

Xha Banushi kishte ardhur bashkë me Dilon. Shkova pas tyre dhe i arrita në krye të shkallëve. I toka të dy me dorën që akoma më përcëllonte. Ata më shikonin në bebëzat e syve e përdicëka nënqeshnin. Merrej vesh se nuk kishin dijeni fare për atë që kishte ndodhur në klasë pak përpara.

— Hë, moj Lena? — pyeti kryetari. — Po sot?

— Përsëri, — thashë unë nxituar.

— Je trembur? — pyeti Diloja.

“Këtij sepse nuk desha t'i përgjigjesha, prandaj ula kokën e shikoja dëborën me vështrim të përhumbur.

— Këtu në Bukmirë të duan të gjithë, mësuese Lena, — dëgjova zërin e kryetar Banushit.

— Si ta kuptoj këtë? — pyeta unë, e bërë flakë në fytyrë.

Mënyra si po flisnin me mua, më futi në mendime. Që të fitoja kohë e të blua ja me vete këtë gjë, nuk u përgjigja, por nisa të ndiqja më sy nxënësit që luanin të gëzuar e të shkujdesur nëpër dëborë.

— Gjurmët ishin të Masarit, — më tha përritur kryetari.

— Është e pamundur! — kundërshtova unë.

— Gjurmët ishin të mëdha!

— Ne e pamë me sytë tanë... — Nuk beson?!

— E përse ta bëjë ai/këtë?! — pyeta unë, e hutuar nga fjalët e tij.

— Të dë/ ndaj dhe të ruan, — tha Diloja, nje seriozitet.

Në fshat këtë njeri e mbanin si hokatar dhe unë mezi i besoja ndonjë fjalë.

— Këtë na e tha me gojën e tij. Veç ta shikoje e ta dëgjoje, ja, mbi këto shkallë ku jemi edhe tani. Na la pa mend, — tha kryetari i këshillit duke më lëshuar dorën në sup e vazhdoi:  
— Çdo natë, sa binin të flinin njerëzit e shtëpisë, rrëmbente opingat e të atit, gozhupin e tij, sëpatën latoshe e vinte këtu. I mbështjellë i téri si një deng.

Unë dëgjoja e më dukej e pamundur, madje qesharake një gjë e tillë, prandaj u mata të kündërshtoja.

— Prit, prit, — tha Diloja.

— Do të thuash si e duronte të ftohtët e natës? — shtoi kryetari. — I kishte pjellë mendja edhe pér këtë. I gjetëm me vete edhe një plloçë sa një gjysmë buke, të nxehur në zjarr, dhe ajo e mbante gjallë deri në mëngjes.

Më dukej se ato po më ngatërronin përsëri. Isha zënë ngushtë e nuk dija si të përgjigjesha. Vetëm ofshava e lehtësuar.

Kur u larguan ata, hyra në klasë më parë se fëmijët, që t'i shtija sobës dru. Papritur në bankën e fundit më zunë sytë Masarin. Ai nuk kishte dalë jashtë të luante me shokët. Kishte mbështetur kokën në llérën e djathët e ishte përhumbur në gjumë. Harrova sobën e iu afrova ngadalë duke shkelur në majë të gishtave. Më theri zemra e u ligështova. Disa çaste më parë isha rrëmbyer e kisha kryer një gabim të pandreqshëm. Sjelljen time asnjë nxënës i Buk-

mirës nuk e kishte hak e jo më Masar Shkëmbi. E përkëdhela lehtë në kokë e nisa t'i hidhja mbi shpatullat e imta pallton time të trashë. Pastaj e kuptova se po lotoja përsëri. Një pikë u rrëzua padashur mbi faqen e skuqur të Masarit...

## Kryetari

Ishite një natë qershori e vitit 195.., nga ato që e mbajnë hënën të fshehur diku larg dhe e rrëfejnë papritur vetëm kur afron mëngjesi, të përgjysmuar e të zbehtë, aq sa është e vështirë ta dallosh në kupën e qiellit, që ka zënë të marrë dritën e agut.

Sabah Çeta ecte i vetëm në xhade. Çapin e bënte të madh, të rëndë e të zhurmshëm ngaqë njérin gju e përthyente me zor. Këmishën e bardhë e kishte zbërthyer gati gjer në bel, kurse xhaketën e lehtë prej doku e kishte hedhur supeve. Në buzë i ishte ngjitur cigarja e ndezur, që, kur e thithë, ngjante me një xixëllonjë. Edhe aromën e barit të kositur në luadhin buzë xhadesë, edhe freskinë, edhe zërat e natës ai i shijonte me ëndjen e njeriut që ka lënguar gjatë në shtrat dhe natyra e befason. Po sepse mungesa e hënës i ngallte një ndjenjë trishtimi të papërcaktuar; Thua të bëhej shkak për këtë ai pikimi i predhës së mbetur diku midis mishit e kockës që nga koha e luftës?

Mënyra se si çapitej e tregonte të lodhur e njëkohësisht të ngutur për të arritur në fshat sa më parë. Për çudi të tij, lodhja e kujtonte zakonisht kur zbriste në qytet, edhe pse aty me raste ulej një copë herë në atë lokalini e vogël në fund

të rrugës së pazarit. Në të kundërtën, rruga e përpjetë e stanit, ecejaket gjatë ditës nëpër fushë, mbledhjet e gjata të kryesisë, e rrëmbejnë të terin, aq sa nuk e kishin dëgjuar kurrë të lëshonte nga goja një «oh, ç'u lodha». Jo vetëm kaq, por atje në fshat edhe gjuri sikur s'e kujtonte.

Po ja që Sabah Çetës, si kryetar që ishte, puna ia donte të zbriste në qytet tri, katër a më shumë herë në muaj. Sa në seksionin e bujqësisë, sa në ndërmarrjen e farërave, sa në atë të grumbullimit, sa... Në fillim shokët, që ia dinin këtë huq, e këshillonin të merrte me vete kalin larash të kooperativës, por Sabahu nuik e kishte pranuar një përkujdesje të tillë. «Pse, ore, Ago Qafoku jam unë që të kapardisem kaluar, si në vakt të tij?» — i kishte thënë një mëngjes stallierit, kur ky i kishte trokitur në derën e zyrës së kryesisë me larashin, të nisur e të rregulluar me fre e shalë, si për krushk.

Si bëri edhe një copë rrugë, u ndodh mbi urë, aty njsi të hetonte me vëmendje. Nën këmbë kërcitnin dërrasat e armaturës, mbi të cilat ato ditë do të shtroheshin gardh shufrat e hekurave e do të derdhej betoni. Më tej ishin shkarkuar thasët e çimentos që ngriheshin mal nën një tremë të sajuar shpejt e shpejt. Sabahu qëndroi për një çast për të hetuar punën që ishte kryer atë ditë. Pastaj mati me hapa gjatësinë e gje-gjerësinë e urës, sikur të vinte aty për herë të parë. «Oj, të marrë se! Këtu mund të këmbohen kur të duash dy makina bashkë», foli me zë, sikur të bisedonte me dikë aty pranë. Lëvizi më tej e preku një përnjë parmakët e armaturës. Ai mendoi se punëtorët e ndërmarrjes së ndërtimit kishin nevojë të ndihmoheshin me krahë pune nga të fshatit, ndryshtë ura do të

zgjaste një javë a më shumë që të përfundonte.

«Do të vij nesër me dhjetë a njëzet djem të rinj», mendoi dhe u nis duke u çapitur.

Nga ana e qytetit dritat vezullonin e kjo e ndihmonte të shikonte disi hijet e armaturave, që ashtu, më parmakët rresht e rresht, ngjanin me një pyll të vogël me drurë të prerë. Përreth vendi mbante erë rrëshirë. Në të larguar, ngriti një thes që kishte shkarë buzë urës dhe mori rrugën e Melanit, që çante përmes arave me grurë. Kallëzit e rënduar e preknin në gjunjë e në duar si të ishin qenie të gjalla që kërkonin përkëdhelje prej tij. Gëzimi i asaj dite në çast iu dyfishua.

Makina shirëse që rrethi i kishte premtuar kooperativës së Melanit që në dimër kishte ardhur. Atë ditë kryetar Sabahun e kishin thirrur të kryente formalitetet e kontratës e ky kishte zbritur më një frymë në komitet. Atje, e kishte pritur shefi i seksionit të bujqësisë, që melanasit e kishin edhe deputetin e tyre dhe agronomi i bimëve të arave. Këta e kishin shoqëruar deri në oborrin e SMT-së.

Kryetarin e kishte befasuar makina shirëse më atë ngjyrën e kuqe zjarr, ngritur mbi rrota hekuri e me lloj-lloj rripash që kapértheheshin kryq e tërthor në të dyja anët. Dhe qe hutuar e mallengjyer atë çast, aq sa nuk mundi të nxirrte dot një faleminderit, kur shefi e uroi: «E punofshi gëzuar, o kryetar!» Gëzimin e ndjeu vërtet, sepse nuk kishte si të ndodhë ndryshe. Sabahu i kishte lënë të dyzetat, po për herë të parë shihte me sy një makinë të tillë. Për më tepër, me sot e me nesër, makina do ngjitej në Melan të shinte grurin e kooperativës. Në oborrin e SMT-së koha kishte rrjedhur si pa e

kuptuar dhe në mbrëmje Sabahu ishte nisur për udhë.

Ja, këto sillte ndër mend kryetari i kooperativës së Melanit, teksa ngjitej për në fshat. Në dorë mbante disa kokrra grurë të shkërmorë nga kallëzit që i përkëdheleshin pas trupit. Herë pas here fuste në gojë ndonjë syresh ende të butë. Gëzimi e kishte mbushur të tèrin. Bënte përpjetë e mendja i rrihte në fshat, ku njerëzit e prisnin e donin të mësonin prej tij. «Si ishte ajo makinë, si punonte, sa vrahe mund të shinte brenda një dite, a e shpinte grurin dëm siç pëshpëritez nga gojët e liga?».

Dhe iu bë se makina shirëse ishte ngjitur në fshat, atje në lëmë, ku ngriheshin mullar duajt e grurit. Sitat troshiteshin të harbuara e thasët mbusheshin deng me grurë të qëruar kokërrmadh, si thana të arrira.

I doli para sysht edhe kali larash, me litarin qarkuar pas qafe, që mblidhej e mblidhej në strumbullar, duke parë vëngër nga makina shirëse, sikur donte të thoshte: «Jemi edhe ne këtu... Mos na harroni!»

Ndonja pesëqind metra më larg kryetar Sabahu brofi i shqetësuar. Përmatanë kanalit dicëka plaquriti në pellgjet e ndenjura të ujit e sakaq fëshfëriti gruri, sikur dikush të hiqej zvarrë.

Sabahu ndaloi në vend e mbajti vesh gjatë. Atëherë qetësia u bë më e thellë. U përkul, mori një plis dhe e hodhi në drejtimin nga kishte ardhur zhurma. Pas pak u nis me mendimin se ndonjë shpend do të ishte ngritur nga kanali a ndonjë begun që kulloste bar të njomë do të ishte trembur prej tij dhe kërceu i frikësuar.

Por nuk vonoi dhe, pas krahëve, dikush i thirri me hakërrimë:

— Kush je ti, more, që na shkel bukën, hëëë!?

— Jam Sabahu, o Meleg, — ia ktheu kryetari, që e njoju në zë rojtarin e fushës.

— Si, ore, kryetari qenke! — tha tjetri e ungjit mbi mezhëdë, ku kishte qëndruar e priste Sabahu.

— Si më je?... — e pyeti Sabahu.

— Mirë, o kryetar, mirë. Veç ti, si gjithnjë, më këmbë dhe vonë. A m'u lodhe?

Ata zgjatën e tokën duart në errësirë.

— A kishte ardhur makina, o bir? — pyeti roja i fushës me një frymë.

— Kishte ardhur, pos... Veç ta shikoje...

— Ashtu, ëëë! Po si ishte? Ndonjë bina e madhe apo... se çfarë nuk po dëgjojmë... Ca e ngrenë në qìell e ca e nxijnë si katrani që lyejmë qerret tonë.

Po kryetar Sabahu nuk iu përgjigj. Duket i bëri përshtypje, frymëmarrja e shpejtuar e tjetrit.

— Më dukesh i lodhur, — i tha rojës.

— Hë dee! M'u bë se dikush u hodh nga rruga në arë e i rashë pas. Ja, atje sipër, te kryqëzimi. Po kjo kështu thashë!? Ç'kérkon njeriu natën udhë e mbi udhë?! Paštaj nuk m'u ndenj. Më hynë Mizat e nisa të varem poshtë, që t'i pres rrugën. Kur të ndjeva, të mora për të ligun e t'u hakërrova sìç më dëgjove. Po ku ta dija unë, o shoku Sabah, — u shpjegua gjatë rojtari me ton të tillë, si të kërkonte të falur.

Për disa çaste midis tyre ra heshtja e thellë. Sabahu kishte kthyer kryet prapa, në drejtim të vendit ku, pak më parë, i kishte tërhequr vëmendjen zhurma e dyshimtë. Vendi ishte larg e ai diçka bluanë me mendje. Grushti që mbante kokrrat e grurit, herë shtrëngohenj si darë e herë

çlirohej si shoshë e rrallë. Nëpër gishta i derdheshin kokrrat qumështore, të zbrujtura nga ai shtrëngim i fortë.

Ishte errësirë e rojtar Melegi nuk mundi të vërente shqetësimin e Sabahut, ndaj e ngau me ngulm:

— Të pyeta për makinën...

Po ndërkohë hetoi se kryetari qe harruar në një mendim të thellë që po e mundonte. E mblo-dhi aty për aty e shtoi:

— Pse, ore, nuk paske qenë ti ai?!

— Jo, — tha prerë kryetar Sabahu dhe i futi krahët xhaketës. — Unë tani po ngjitem.

— Ptuuu! — pështyu thatë rojtari dhe diçka shau nëpër dhëmbë. Ndërsa turfullonte, arma që i varej në sup i peshoi në të dyja duart.

— Hë dee! — bëri rojtari. — Gruri akoma nuk është arrirë e s'ka ç't'i bëjë i ligu... Veçse në kërkon ta bëjë lëmazhdë me këmbë...

— Ka, o Meleq, ka. Po më thuaj, ç'vragë ndoqi zhurma që dëgjove?

— Ta thashë një herë, — u përgjigj gati me ankimi rojtari i fushës. — Si kapërceu kryqëzimin, mori mezhdën e kanalit, ja këtu ku jemi unë e ti që u harruam...

— Ika, unë, — tha kryetar Sabahu. — Ti zbrit më poshtë e dil pastaj të zësh rrugën e fshatit. Unë po zë xhadënë. Atje kemi çimenton. Kushedi kush ia ka vënë syrin të na e vjedhë a të na e hedhë në lumë.

Të dy lëvizën vendit e humbën nëpër natë.

Sabahu nxitonë më shumë nga sa i lejonin fuqitë dhe ai pickimi therës i gjurit, që po vihej në provë të rëndë pas tetë a më shumë vjetësh. Pas pak në gjurmë të tij filloi të zbrishte edhe rojtari i fushës, me mendje ta arrinte e të mos i ndahej kryetarit të kooperativës. Por

ishte i moshuar, e sa vinte mbetej prapa. Bënte poshtë e hahej me veten që nuk mundi të nuanhastë vetë se çmund të bënte i ligu në një natë si ajo, kur në fshat ishte hapur lajmi i gëzuar se makina shirëse kishte ardhur në qytet e prisnin të ndërtohej ura që ta kapërcenin përkëtej.

Sabahu po ndiqte një rrugë të tertiortë përtë dalë në vendin kù kishte menduar. Arat e kooperativës i njihet me pëllëmbë e nuk e pati të vështirë të gjente shtegun që e nxirrte më shpejt. Sa më poshtë bënte, aq më kujdes tregonte përtë mos u hetuar. Ca nga ca, shtegu e nxori në xhade. Ishte lodhur si kurrë ndonjëherë e vetëm aty mundi të mbushej me frymë e të fshinte djersët që i kullonin çurg. Nisi të mbante vesh rrëth e rrotull. Pranë tij oshëtintë lumi. Nga ura e ndanin vecse tridhjetë hapa. U shty përtatje, duke rënduar mbi këmbën e shëndoshë. E ndau me mendje të ruante nëse do të shfaqej njeri aty, siç kishte kujtuar. Ja, atë qast mundi të shquante një hije të zezë që lëvizte mbi urë më ca zigzage të çuditshme, që në një rast tjetër cilindo do ta kishin bërë përtë qeshur. Hija edhe trajtat i kishte të çuditshme. Ajo herë rritej në përmasat e një njeriu, herë tkurrej e përdridhej, por gjithnjë lëvizte më të majtë e më të djathtë, sa e lejonte gjerësia e urës. Dhe shkonte pa zhurmë. Ajo ecje lakedredhas tregonte se tjetri nuk kishte të bënte fare me thasët e çimentos siç kishte pandehur kryetari. Sabahu u shtri barkas pa ia ndarë sytë atij që kishte përpara dhe pas pak gjithçka e pati të qartë. Vendi përreth mbante erë vajguri. Një inat i papërbajtur e shtynte t'i thërristë e ta shante keq njeriun e pánjohur, por shtrëngoi dhëmbët. Keqbërsi mund të nxirrte shkrepësen e gjithçka mbaronte me aq. Ai duhej penguar

për këtë. Prandaj Sabahu zuri të hiqej rrëshqan-  
thi mbi sipërfaqen e qullët e dora-dorës t'i afro-  
hej. Tjetri vazhdonte të jepte e të merrte me  
ngut, duke lëvizur sa në një anë në tjetrën. Erdhi  
një çast e diçka u lëshua me zhurmë mbi dë-  
rrasa, u rrrokullis tatëpjetë e diku u ndal. Edhe  
hija ndali. U përdrodh në vend e pastaj bashkë  
me lëvizjen e tij u dëgjua një gurgullimë e zgja-  
tur. «Urrejtje të madhe paskërke, o qen i ndyrë!  
E shoh që nuk u ngopkërke të na djegësh vetëm  
me një shishe vajguri!» — murmuriti Sabahu.  
Por ende i ndanin edhe rreth dhjetë hapa nga  
njéri-tjetri. Përsëri iu kujtua rojtari i fushës, të  
cilit nuk arriti t'i merrte pushkën. Kryetari u  
shty në anën tjetër të urës, zgjati dorën e mundi  
të merrte shishen e zbrazët. Tani kishte një  
mjet që do t'i hynte në punë. Edhe pesë hapa  
e ndanin nga ai. Silueta dallohej mirë nën vezu-  
llimin e dritave të qytetit, por për të njojur nuk  
njihej cili ishte, gjë që po e mundonte qëkur.

Si zbrazi edhe një shishe tjetër, hija u  
ngrit dhe mori trajtën e një njeriu trupmadh.  
Një shkëndijim u reflektua në konturet e urës.  
Atë çast Sabahu brofi në këmbë e thirri me së  
kishte fuqi:

— Ndal! — e në këtë e sipër u lëshua mbi  
keqbërësin. Tjetri hungëroi në mënyrë tallëse e  
shau me zë Sabahun, melanosit dhe kooperati-  
vën e tyre.

— Kam hak për të marrë! — shfryu me  
mllef.

Sabahu e njoju në zë. Kishte përpara djalin  
e madh të Qafokut. Ja, ai villte vrer duke mbaj-  
tur shkrepësen e ndezur në dorë. Flaka e shkrep-  
pëses u bë e plotë dhe Sabahu mundi të dallonte  
atë fytyrë të egër si prej bishe. Ai po ngërdhe-  
shej i kënaqur që atë çast do të digjte bashkë

me urën edhe kryetarin e kooperativës, i cili nga zvarritja për të ardhur deri aty ishte ngjyer i téri në vajguri. Tani i kishte dalë anash keqbërësit dhe i kishte prerë udhën. Ata qëndronin përballë njëri-tjetrit në krye të urës, në kufirin midis dërrasave dhe çakëllit të xhadesë.

— Më hap rrugë! — thirri ai që mbante shkrepësen e ndezur. Në tonin me të cilin u thanë ato fjalë u ndje edhe zemërim edhe frikë njëköhësisht.

— Shuaje atë zjarr, o këlysh i Qafokut! — urdhëroi Sabahu gjithnjë i vëmendshëm, duke bërë edhe një hap përpëra.

Ndërkohë flaka u lëshua e mori udhë të binte mbi dyshemenë e urës. Por nuk arriti të prekte në të. Sabahu liroi dorën që mbante shishen, mori vrull e u hodh mbi djalin e kulakut që u përpoq të tërhiqej praptazi dhe e mbërtheu në grykë si me darë për të mos e lëshuar kurrë. Vrulli i nxori që të dy në xhade. Midis tyre mbeti edhe flaka e shkrepëses.

Atë çast keqbërësi ulériu llahtarshëm dhe në përpjekje për t'u çliruar nga shtrëngimi dhe përcëllimi i flakëve nisi të shante e të lutej me llahtarë. Por fjalët e tij dilnin të paqarta, pa u formuar të plota, se pengoheshin nga gishtat e mbërthyer në fyt. I mbuluar në flakë Sabah Çeta kishte harruar veten e përpiqej me ngulm ta mbante aty mbi xhade, larg urës, armikun e klasës, që mundohej t'i shpëtonte nga duart.

Përmatanë urës çau natën një krismë pushke që shungulloi gjatë, pastaj u dëgjuan edhe këmbë të nxituara. Sabahu u mundua të hapseytë që të shikonte andej, po nuk mundi. Ndërkakq arriti rojtari i fushës dhe me një të goditur të fortë me kondakun e pushkës hodhi përtej keqbërësin. Pastaj u lëshua mbi trupin e kryetarit

e u përpoq derisa i shoi flakët e trupit. E mori në prehër i mallëngjyer gjer në dhembje. Po nuk u përbajt nga gëzimi, kur vuri re që Sabahu ishte gjallë.

— Plagë të mëdha more sonte, o bir. Sa për dhjetë nga ato të luftës. Por ti ke zemër të madhe dhe do të rrosh...

Dhe u ngrit njëherësh në këmbë rojtari, e përsëri zbrazi pushkë.

## **Shqetësimi i Binan Vishnjës**

Benan Vishnja lëshoi një psherëtimë të zgjatur dhe, duke shtyrë karrigen prapa, e mbërtheu shikimin në dritare. Dukej sheshit se kishte qëndruar për një kohë të gjatë i përhumbur në mendime. Nxori nga paketa një cigare tjetër. Ë vuri në buzë me një lëvizje nervoze dhe e ndezi. Ngriti ca gulce të dendura tyrni, që e bënte të kollej e të përlotej njëherësh.

«Ptuu, o i mallkuar!» — shfryu me zë të vrazhdë. «Eh, ç'e pësova si ai që frëfejnë!» — foli nëpër dhëmbë. Por, ende pa e shfryrë gjithë dufin që i ziente përbrenda, këputi fjalën në mes dhe sepse u bë i përbajtjur. Afroi karrigen e u kërrus mbi togun e letrave. Nisi të kërkonte aty, duke shtyrë anash një regjistër me kapakë të trashë. Shkundi fletën e një projekti, shfletoi ca fije të tjera të kapura me gjilpërë, derisa gjeti atë që i duhej. Po me një frymë zuri të lexonte e të bënte llogari, duke i shoqëruar lëvizjet me pëshpëritje. Herë nënvizonte me të kuq përfund kolonave e herë ua niste veprimeve nga e para, si të donte të vërtetonte diçka. Kaloi kështu edhe ndonjë gjysmë ore a më shumë. Pastaj përbri njërsë prej kolonave ai formoi me numra tëpër të mëdhenj shifren njëqind. Tërhoqi kryet mbra-

pa e, duke e shikuar atë me sy të picërruar, foli me bindje:

— Ngado që t'i biesh kalemit, aty te një-qindëshi del... Gjë e mirë për kooperativën tonë kjo...

Në qoshe të zyrës soba po ftohej dhe qynjet po lëshonin ca kërcitje të mërzitshme. Kohë më kohë vështronë në dritare me një padurim të theksuar. Por përjashta s'dukej njeri. Veç dëbora vazhdonte të binte më dendur sikur në quell të ishin hapur sitat. Ndihej fërshëllima e erës së sertë.

«Po ky djalë... si e pati sot që s'po duket?!

— u ankua Benan Vishnja dhe i mbërtheu sytë mendueshëm mbi shifrën njëqind. Pastaj mori lapsin dhe e qarkoi me një rrëth të trashë, si të kishte frikë se mës do t'i shprishej sy për sy.

— Mos vallë iu ndërrua mendja!? Apo u tremb nga zotimi dhe...!? — i lindi vetveti ky dyshim. Po shpejt e mori në mbrojtje: — Jo, jo...! Ndryshe, do të vinte e do të më thoshte që edhe unë të mos e bëja proçkën në telefon. Të mos ia kisha dhënë as gazetës...»

Kur ja, papritur iu bë se rrëzë dritares dikush kaloi. Benan Vishnja fërgëlloi i téri. Zuri të hetonte me kureshtje nëpër të çarat e derës ku lëvizte hija e një njeriu dhë në të njëjtën kohë po mundohej të mbante zemërimin.

Ndërkokë nga përjashta trokiti një dorë e druajtur.

— Hyr, de, ç'pret!? — i lëshoi zë Benan Vishnja.

Dera e zyrës u hap menjëherë. Në të u shfaq një mesoburrë i veshur me xhaketë lëkure e me kasketë të ngjeshur fort në kokë. Dëbora e kishte zbardhur të térin. Ca fjolla fluturake u derdhën pas tij të harbuara dhe i porsaardhuri e mbylli

derën me kurri e shpejt, si të donte të mbrohej prej dikujt.

— Si të kam, o kryetar Benan, — foli burri me kasketë, me një ton tepër intim dhe zuri të shkundte dëborën me pëllëmbë.

— Mirë, — iu përgjigj ftohtë Benan Vishnja.

Burri me kasketë u çapit drejt sobës, duke bëré çudi me qëndrimin e kryetarit, që vetëm pak më parë i kishte thënë gjithë zjarr: «Hyr...». Zuri vend mbi një stol të vogël dhe, duke mos ditur çfarë të bënte, po provonte nxehësinë e qyngjevë me gishtat e mërdhirë.

— Paskeni pasur mbledhje, ë? — ngau burri më kasketë duke shëtitur vështrimin sa mbi tryezën e mbushur me gjithë ato letra e sa mbi taketuken e duhanit.

— E ç'mbledhje, a derëbardhë! — tha Benan Vishnja, duke qeshur hidhur me atë hame ndje të çuditshme të tjetrit.

— Atëherë paske hall të madh, o vëlla.... Ora akoma s'ka shkuar nëntë, kurse ti paske pirë duhan sa për pesë burra bashkë.

— Kam dalë herët, — ia preu Benani dhe fshehu shikimin. Por, ndërsa bëri Kështu, sytë i ndeshën në shifrën e rrëthuar me të kuq dhë shqetësimi për mosardhjen e bariut iu dyfishua.

Atë gjendje të turbulluar të kryetarit dukej se e nuhati burri me kasketë, prandaj, si për ta shtruar fjälën; tha:

— Na kishte marrë gazeta, o shokui Benan!?

— Merre! — tha Benan Vishnja pa e pasur mendjen;

Tjetri u skërmis e mblođhi supet, i habitur nga hutimi i kryetarit që, si duket, mëndoi se ky i kërkoi gazeten.

— Them që shkruante gazeta për kooperativën tonë... Për atë zotimin e Jetmirit....

— E, po! — u përmend Benan Vishnja.

— Mbrëmë, Lame Bariu bëri fjalë me të bërin...

Kryetar Benani ngriti kryet vrulltas dhe i hodhi burrit me kasketë një shikim zhbirues. Ku donte të dilte ai me ato fjalë? Diçka u mat të thoshte, por tjetri e hapi gojën më parë:

— «Pse, ore, rashë e vdiqa unë që nuk e pleqëroje me mua njëherë, — i hakërhohej i ati.

— Apo di pak kjo koka ime, që m'u bë dele pas deleve një jetë të tërë?! — Pse, ore, ç'e di ti sisën e deles, si lëfytin e çzmës, që më ngrihet e thua se do të marrësh njëqind litra përkokë?....». Veç të ishe e të dëgjoje, o shoku Benan. U mblohdhën njerëzit si miza e lisit. Një palë u bënë më plakun Lame e një palë me të birin, Jetmirin..., dhe me atë Nikon, zooteknikun... Unë përvete, ja, atje e mora vesh, o shoku Benan. se ai buzëqumështori paska bërë me kokë të vet dhe, të them të drejtën, nuk më erdhi hiç mirë. S'ka mbushur akoma tre vjet bari dhe...

— More Vahit! Po që kur ke filluar të marrësh andej e të sjellësh këtej? — e ndërpren rreptë Benan Vishnja.

— Përse më thua kështu, o shoku Benan?! — foli burri me kasketë. — Unë thashë ato që dëgjova mbrëmë në shtëpinë e kulturës.

— Të flas kështu, se bëj çudi me ty, që kurrë nuk ke pasur merak për hallet e kooperativës, e ca më pak për qumështin, — iu zbras i nxehur kryetari dhe u ngrit më këmbë. — Nuk më the, përse u lodhe gjer këtu? — e pyeti, sikur donte t'i lhoshte: «Më thuaj ç'hall ke dhe shko në punë».

— Dëgjova së do të na mungosh ca ditë. Se

do të shkoni me Jetmirin në një aktiv jashtë rrrethit.

— Ke njeri tëndin andej e kërkon t'i shpie të fala?

— Jo, — u skërmit burri me kasketë. — Erdha për atë punën e patentës. U bënë plot një-mbëdhjetë muaj që ata të inspektoriatit ma kthyen...

— Por edhe ne që atëherë ta kthyem përgjigjen, — ia priti zë më zë kryetari.

— Nuk them se jo, — tha ngadalë burri me kasketë, — po...

— Përvishju punës si shokët, Vahit, — ia preu kryetari. — Nuk harron kollaj fshati që na shtype lopën më të mirë të tufës. Atë më qumështoren.

Por atë çast biseda u ndërprer, se nga përjashta u ndje një zë i njojur dhe Benan Vishnja shkoi e hapi derën me një frymë. Te pragu ndeshi me Jetmirin. Ky ishte një djalë trupmadh, veshur me të shajakta e me fytyrë të përskuqur nga thëllimi. Kërrabën e kishte ngulur në dëborën që kishte shtruar trashë. Djalin e kishte lodhur rruga dhe nga goja i dilte avull. Ai e kishte parë që nga jashtë burrin me kasketë dhe sepse po ngurronte të hynte brenda.

— Po ti ku humbe? — pyeti kryetar Benani.

— Nxora Nikon deri në xhade. Veç pritëm shumë atje, sa u dha një makinë dhe e hipë në të, — u shpjegua Jetmiri.

— Nikon the?! — pyeti me kureshtje kryetari. — Po ai zbriti dje në qytet.

— Jo, o shoku kryetar. Ai u ngjit mbrëmë te ne, në Manas, e ndenjëm bashkë deri pas mesnatës. Kishte merak të madh për atë punën e zotimit, sidomos pasi kishte lexuar artikullin në gazetë...

— Unë thashë, po ti nuk më besove, — ndër-

hyri burri me kasketë që aty ku ishte, pranë sobës.

— Kryetar Benani e shikoi me mërzi.

— Andej nga ne po zien kazani, o shoku kryetar. Apo e ke marrë vesh, — tha Jetmiri e bëri shenjë me krye nga burri me kasketë.

— Ato të xha Lames? Po, m'i thanë, — tha Benan Vishnja, duke zënë vend në karrigen e vet. — Të tjera nuk kam dëgjuar.

— Vahiti mbajti anën e tim eti, — vazhdoi Jetmiri, duke u ulur edhe ai pranë kryetarit.

— Më rëndoi ca si tepër, por inat nuk do t'i mbaj. Ja, mbrëmë e mësova se ma dashka shumë babanë.

Burri me kasketë lëvizi zhurmshëm mbi stol, se i dogji shpotia e Jetmirit. Për të fshehur shqetësimin, u ul gjunjas përdhe e hapi derën e sobës.

— Çfarë të tha!? — pyeti Benan Vishnja.

— I qau hallin fshatit... Se gjoja këtë vit do të bëhem shkak unë që të shterojë burimi i stanit, — foli djali. — Se do të mbushen bidonët «një nga dhia e shtatë nga vija».

Benan Vishnja u vrenjt në fytyrë. U mendua një copë herë para se të hapte gojë. Pastaj iu drejtua burrit me kasketë:

— Vahit, lëré zjarrin dhe shko, se bashkë mbaruam!

— Po unë bëra shakà, o Jetmir! — mezi tha Vahiti me ton pajtues. — Unë...

Kur ata të dy mbeten vëtëm, kryetari tha:

— Për pak u ngatërruam, o Jetmir!

— E përsë e prish gjakun kët, o shoku kryetar? Vahiti...

— Nuk them për atë, jo, — tha kryetari...

— Thashë se mos ishim shkëmbyer në rrugë. Kur pashë se ti nuk po vije, të gjykova keq.

Ndérroi mendje, u tremb, thashë. U turpëruam me fshat e me njerëz dhe u bëra gati të ngjitesha deri në Manas... Po nejse. Tashti hajde më thuaj se çfarë ikë menduar të flasësh në aktiv. Dhe mos harro, o djalë, se atje nuk është si në mbledhjet tona.

— Kollaj fare ajo punë, — tha Jetmiri. — Më ndihmoi mbrëmë Nikoja dhe i mbusha dy fletë me të shkruara. Por unë, ama, kam ndër mend të flas pa i lexuar ato...

— Pa t'i shoh njëherë, — tha kryetari duke i zgjatur dorën djalit, që atë çast nxori nga xhepi i brendshëm i xhaketës fletët e palosura.

— Në zotimin që kemi marrë, do të gjesh një ndryshim të vogël, — tha Jetmiri, duke ia lëshuar fletët në dorë.

→ Pse!? — pyeti me habi kryetari.

— Shokët nuk janë të një mendjeje me mua. Ata... — nisi të shpjegohej Jetmiri, por nuk arriti ta mbaronte, se Benan Vishnja e ndërpren:

— Pse, ore, përkëtë u mblodhët mbrëmë? Që të bënë ndryshime?... Ç'është, more, kjo proçkë që na paskeni bërë?! Përse nuk thoni që u turpëruam, — u shkreh ai. — Na rrofshin një-qind litrat e kësaj këtu, — ngriti zërin Benan Vishnja e rrëmbeu gazeten ku shquhej një artikull me rreshta të nënvizuar vende-vende.

— Kot merr zjarr, o shoku Benan, — tha Jetmiri, me të butë. — Më lër të shpjegohem njëherë.

— Si, more, kot?! E paktë të duket ty kjø-që po na bëni? — foli kryetari me një frymë dhe përplasi pëllëmbën mbi tryezë.

— Shokët kërkuan ta rritim zotimin edhe dhjetë litra të tjerë përk Kokë, — foli me ton të vendosur Jetmiri. — Ja, kjo është «proçka» që i kemi bërë zotimit tonë.

Kur dëgjoi ato fjalë, kryetar Benani u lëshua rëndë në karrige, me një pamje të hutuar, sikur të mos u besonte veshëve.

— Ti po më qmend sot, more djale! — tha duke psherëtirë i lodhur kryetari. — Ç'është kjo e luajtur me shifrat kështu?

— Nuk do të të turpërojmë, o shoku Benan. Jemi gjithë ata shokë në një mendje. Do të punojmë me tufën e dhenve... — po fjalët e djalit Benan Vishnjës i tingëlluan me një kuptim tjetër, sikur ai të kishte thënë «Përse nuk na beson neve».

— Mos jeni rrëmbyer? — tha kryetari me zë të lodhur e me pamje të menduar.

— Jo, — ngulmoi Jetmiri, — e rrahëm gjatë këtë punë. Ne nuk do t'u hyjmë në hak as lopëve dhe as qeve. Veç stallën e re e kërkojmë.

— Ajo është vendosur një herë! Në vjeshtë e keni të mbaruar, — tha Benan Vishnja. Pastaj, duke nxjerrë nga sirtari regjistrin, tregoi diçka me gisht. — Ja, shumë-shumë na del se mund t'ju japim për zotimin e parë vetëm disa kuintalë tagji nga mbetjet e furrës, një hektar jonxhë, një...

— Këtë shtesë ne nuk e kishim parashikuar fare, — tha Jetmiri. — Megjithatë, po që se lind nevoja, mund ta marrim...

Teksa Jetmiri fliste, Benan Vishnja përfytyronte veten në atë sallën e madhe të aktivit, ku qindra sy e ndiqnin me vëmendje bariun nga Manasi. Fytyra e tij cikë e nga një cikë po çelej e lumturohej, si kurrë ndonjëherë. Ai po e shikonte djalin me admirim.

— Jetmir, këto që po më thuq mua a i ke shënuar në diskutim? — tha dhe shtriu dorën të merrte letrat e harruara mbi tryezë.

— Po! — u përgjigj djali menjëherë. — Ka

aty edhe të tjera. Po unë kam frikë se me të lexuar ngatërrohem e do të lë ndonjë gjë pa thënë.

— Atje, bëj si të të vijë më mbarë, djalë,  
— i tha atij kryetar Benani e i rrahu supin me dashuri.

Ra heshtje! Nga jashtë dëgjohet vetëm fërshëllima e erës. Pas pak Benan Vishnja ngriti shikimin nga letrat dhe po vështronte Jetmirin. Djalit se si iu duk ai vështrim dhe s'duroi të pyeste:

— Përse më shikon ashtu, o shoku Benan?

— Më duken të rëndë këto dy fije letre, — iu përgjigj Benan Vishnja me një ton të atillë, ku nuk ishte e vështirë të dalloje krënarinë, shqetësimin dhe përgjegjësinë të përziera bashkë.

— Po edhe ne më të rëndë e më të mirë do t'ia bëjmë punëri tufës së dhene, — ia ktheu Jetmiri, duke vazhduar ta shikonte ngultas e me buzëqeshje kryetarin.

## **Qenka bukur dhe kështu**

Dárka e së dielës kishte tri orë që qe shtruar, edhe fjala që ngitej, edhe dollia që ngruhej, edhe kënga me vallen, ndiqnin radhën e tyre. Edhe kur ndonjëherë kandari rëndonte ca më tepër nga kënga e vallja, që ishin bërë strumbullari i dasmës, dollibashi nëntëdhjetëvjeçar, Malkë Bozhari, hiqej sikur harrohej pas llafit të burrave, për të mos ua prishur të rinxve, që më shumë se rakia e rrushit i kishte bërë më qejf gjëzimi i asaj nate.

Pas çdo urimi ca shokë të dhëndrit, të mbledhur si me kokrra, ngjitur me tryezën e orkestrës, ia nisin këngës papritur. Pastaj, kur shihnin se plaku Malkë nuk i trazonte me ndonjë shenjë, ngriheshin e thureshin gardh në valle, mu në mes të dhomës. Ata dinin shumë valle. U kërkoje të hiqnin atë të të vjelave, ata hop në këmbë. U kërkoje atë të të mbjellave, fap në majë të gishtave një palë të tjerë. Le ato të festivaleve.

Atë natë nënë Zanoja sa nuk fluturonte prej gjëzimit, ndiente një lehtësim të paprovuar. Në ballë e në faqe sikur i qenë sheshuar rrudhat. Atë javë kishte pritur e përcjellë njerëz që i vinin mbrëmjeve për urim dhe, për çudi, nuk ndiente as lodhje, as gjumë. «M'u ndrit shtëpia»,

— u' kishte thënë krushqvé ajo, kur nusja e të birit i kishte shkelur pragun. Tani nënë Zanos i bëhej se' edhe koha i kishte ndihur siç ia dönte zemra. Dita qe ngrysur me diell, kurse natën papritur kishte nisur të shtronte dëbora. Ja, një natë të tillë kishte lëkmuar ajo, që njerëzit të rrinin aty të shkujdesur. Vinte rrötull nëpër shtëpi e përpinqej t'i nderonte si e si më mirë të gjithë sa kishte mbledhur në dasmën e të birit.

«Matkë» e thërritnin graria. Majën e gjësë, nga ato që kishte ruajtur në magjen e shtëpisë, tani ua kishte lëshuar dasmorëve përpara.

Aty nënë Zanoja ishte vetë burrë e vetë grua, ndaj ngriti e para dollinë e mirëseardhjes në dhomën e burrave dhe hapi këngën te gratë. Ajo kishte mall të mbushte prehrin me fëmijët që do t'i lindte nusja e të birit, ndaj ngrihej dhe afronte fëmijët e fshatit që gëlonin qysh nga mëngjesi nëpër këmbët e dasmorëve. Dhe nënë Zanoja atë natë mund të zemërohej po të shihte se dikush qortonte fëmijët që bënin, prapësira gjithandej.

Herë-herë ajo sikur i fshihej syrit të njerëzve, por jo syrit të të birit. Ylli, që ia dinte huqin, nuk i ndahet dhe, me ta vënë re, i shkonte pas për të mos e lënë gjatë në kthinën e veçuar të qoshkut.

— Nënë! — i thërriste pas derës me zë të përbajtur, për të mos ngjallur kureshtjen e atyre që i kalonin pranë.

— Ja, erdha, bir, — i përgjigjej ajo që brenda e dilte sakaq, kur me një tepsi në dorë, kur me një qese miell a me një kurorë qepë.

— Mungon gjësendi lart!? Më thuaj, mos na kurse.

Përfund shkallëve ata ndaheshin, por atij nuk

i shqiteshin nga mendjë sytë e lëngështuar të saj. Ai qe mësuar me ata lot që ia shihte shpesh nënë Zanos, që nga dita kur mbetën vëtëm, pas vdekjes së të atit. Atëherë nënë Zanoja javë të tëra përsëriste vazhdimisht amanetin dhe dëshirën e të shoqit: «Dasmën e Yllit bëje shpejt, që mos të të mposhtë dhembja.»

Erdhi viti rrrotull, kaloi edhe ca kohë dhe ja ku u ndez dasma. Vajzat, që sillnin ujë nga burimi, thoshin se nuk kishte mbetur njeri nga fshati pa ardhur aty. Sa e gjëzonin nënë Zanon, ato fjalë!

— Nuset e nënës, — thoshte ajo tek i ndihëtë shkundnin nga kryet kristalet e shndritshme të dëborës.

Ashtu, me faqet e përskuqura nga thëllimi i natës dhe të mbuluara nga pahu i bardhë që sitte qelli, ato ngjanin edhe vetë si nuse.

Por erdhi një çast dhe ca seç nisën të pëshpëritin me zë të ulët e vesh më vesh. Askush nuk donte që ato fjalë t'i mësonte nënë Zanoja, por edhe që t'ia fshihnnin, nuk e shikonin të udhës. Atëherë një grua e moshuar iu afrua dhe i tha cfarë kishte dëgjuar.

— Luaj vendit, moj e Kasos! — u habit nënë Zanoja, e brenda sekondës u bë lule kungulli, në fytyrë. Doli nga dhoma e pyeti: — Po përse të kenë ikur, vallë?!

— Po hë, de, — tha tjetra. Nga mënyra se si i shqiptoi ato fjalë, kuptohej se diçka i fshihtë.

— Mos pati ndonjë zënkë dhe nuk u mor vesh?!

Nga tronditja, edhe zëri edhe trupi i dridhesin si në ethe.

— Zënkë jo, po... thonë se kanë zbritur në fushë.

— Sonte në fushë?! — gati sa nuk thirri nënë

Zanoja. — Po përse nuk thua që u prish dasma? — dhe hodhi shikimin nga dritarja e hajatit, ku fjollat e dëborës lëpiheshin pas xhamit.

Ndryshe nga gratë e moshuara, që u lexohej shqetësimi në fytyrë, çüpëria lëviznin nëpër shtëpi me një shqetësim të ri. Tri a katër prej tyre qenë mbledhur pas nuses e bisedonin me zë të ulët. Nënë Zanoja pa andej me keqardhje. U mundua t'i buzëqeshte nuses, por nuk mundi.

— Zano! Mos rri, po hajde t'ia shtiem në vesh plakut Malkë, se di ai të bëjë zap edhe fjalët, edhe njerëzit.

Tjetra rrinte në këmbë si e ngrirë. Sytë i dukeshin të menduar. S'dinte si të sillej. S'po dinte kë të besonte: fjalët që dëgjoi, apo atë pamje që kishte ndër sy.

Përballë ishte dhoma e burrave. Pranë derës, që ishte lënë hapur për shërbimet, rrinin në këmbë ca vajza që shikonin me kureshtje ç'bëhej brenda. Nga fytyrat e skuqura kuptohej se pak më parë kishin dalë nga vallja. Nënë Zanos i tërhoqi vëmendjen një shami e kuqe që valëvitej në ajër, si një zog që përpiquej me ngulm të shpëton-te e të merrte fluturimin. Hera-herës ndihej edhe gërneta e Sulos.

Ndërsa dëgjonte tingujt e gjëzueshëm që e kishin sjellë në vete pak më parë, këmbët po e shtynin për andej. Vajzat e ndien dhe i hapën rrugë. Tani gjithë sa qenë në dhomë i kishte fare pranë. Suloja kishte shtyrë karrigen pas murit e qëndronte me trupin anuar përpara. Qafën e rrotullonte si t'i therte nga ndonjë ngërç. Ky e vuri re dhe i qeshën sytë. Ai shikimi i tij iu duk sikur e pyeti: «Përse më je mërzitur?» Kurse ajo, nga ana e saj, tha me vete: «Po si nuk pushove një herë, o i uruar!» e vazhdoi t'i hetonte fytyrën. Në krye të valles njoju të birin, që edhe luante,

edhe këndonte me zë të lartë. Ndryshe nga më parë, tani sepse iu bë se ai luante me shaminë e kuqe si me një copë flakë që ia kishte rrëmbyer zjarrit të vatrës atje tej. Nga kreu i tryezës plaku Malkë ndiqte me sy valltarët. Çibukun e rrihte në pëllëmbë si të ishte një çekiç i vogël, Nuk merrej vesh në bënte ashtu pér t'i shkundur hirin apo kishte një merak që e shprehte në atë mënyrë.

«Kot u drithërove, moj Zano, — foli ajo me vete, — pa shiko ç'bëhet këtu!».

Vendosi të kthehej me një frymë në dhomën tjetër të qetësonë gratë, por atë kohë vallja mbaroi.

— Hë, më ju lumshin këmbët, se e tundët! — thanë burrat në një zë, duke u cuar nga vendi.

— Të të trashëgohet Ylli! — e uruan vajzat që i rrinin pranë.

Në anën tjetër Suloja dukej sikur po thyente klarinetën, kurse xha Malka nga kreu i tryezës po thërriste:

— Shpejtoni, o djem, se u bëtë vonë!

— Ja, po dalim, — tha dikush duke u përtypur.

Nënë Zanoja shtangu nga ai tjetërsim i beftë i dhomës, që vetëm disa sekonda më parë buçiste nga gazi i dasmës. Provoi të thërriste: «Daleni, ku shikon!... Nuk ju lë»... Por ndjeu se nuk kishte pikë fuqie të bënte ashtu. Vetëm gjashtë-shtatë hapa larg e kishte Malkë Bozharin, por e kishte të zorshme të arrinte gjer atje. Dikush i dilte përpara ta tokte, një tjetër e pengonte padashur, duke u munduar të fuste krahët në mëngët e xhaketës, kurse të tjerët shtyeshin tek dilnjnë kundruall saj.

Më në fund u gjend ballë pér ballë me do-

llibashin dhe e pyeti atë me zë të penguar nga shqetësimi:

— Ç'bëhet kështu, o<sup>2</sup> plaku i Goranit!?

— Dasmë, o Zano, dasmë, — ia ktheu plaku, duke shtyrë prapa kokës festen me push të butë. Në ballë të tij mbëti si e vizatuar një vijë e hollë ngjyrë trëndafili.

— Po këta që dalin, për ç'nusë i përcjell tanë natën? — shtoi nënë Zanoja dhe në zemërim e sipër shtriu dorën në drejtim të derës.

— Thashë t'i ndjek njëherë që të të kursej rakinë, — iu përgjigj shpotisë gojë më gojë tjetri dhe u kthye si me vrull nga dritarja që kishte prapa kurrizit. Shtyu perden prej basme e hapi kat më kat kaçatet ei drunjta. Atë çast mbi gjoksin e tij u shkund një degë molle e ngarkuar me dëborë. Mësë e bardhë ra në qilim me një zhurmë të butë. Pastaj dega e mollës, si u lëkund disa herë e lehtësuar, bëri përpjetë.

— E ndezi me drita fushën Namiiku. I gjithë fshati ka zbritur atje, o<sup>2</sup> Zano. Po ti qasu, qasu e shiko! — tha plaku Malkë, duke u hequr më-njanë e duke mbërthyer kopsat e këmishës.

Nënë Zanoja u capit si e përhumbur dhe mbështeti pëllëmbët mbi pezulin e ftohtë. Trupi iu mbush me mornica. Për një çast kujtoi se po shikonteën idërr. Larg në fushë rrëzellenin llambat elektrike sikur mbi atë vend të ishte këputur një copë quell i madh korrikù, mbushur me yje.

— Po përsë të prishet dasma kështu!? Se mos ra sheqeri në ujë! — tha ajo më gjysmë zëri.

— Hë de! Ashtu thashë dhe unë, po ku marrin pykë këta! — pasoi një mesoburrë, që rrinte në shesh, në një cep të dhomës, me buzë të përflyera e i djersitur i terti, sikur t'i kishin derdhur mbi kokë një gjym me ujë.

— Naa! Po të lë dhe gotën time! — iu lëshua atij një djalë kuqalosh tek mundohej t'i vinte flakën fenerit. — Se, po pate raki përpara, ti, Lame, edhe zjarri të të bjerë nën vete, nuk lëviz.

— Shko, ore buzëqumësht... Arriji shokët se mos mbetesh prapa e humbet rrugën.

— E po ne nuk e hamë fjalën e dhënë, siç e ha zotrote thelén e pulës, de!

— Rri, o Lame, për kokën tënde! Përse u ngatërrohesh djemve nëpër këmbë! — i foli një burrë thinjosh që i rrinte në krah Malkë Bozhari.

— Po unë Namikun e ula këtu kur shtruam darkën, — tha nënë Zanoja.

— E ngrita unë, — tha Malkë Bozhari. Ash tu, duke mbërthyer këmishën, u duk sikur rrahu gjoksin. — Atë dhe agronomin... Na e zë ngrica panxharin në arë dhe...

— Bukur, besa, — tha me millef nënë Zanoja. — Sos që s'erdhi kryetari dhe... — por aty për aty e kapërdiu fjalën.

Dhjetë a dymbëdhjetë burra të mbetur në dhomë dhe ca gra që kishin hyrë aty, nuk po ia shqitnin sytë së zonjës së shtëpisë, që nga shqetësimi i dridhej edhe zëri, edhe trupi.

Plaku qeshi lehtë. Me sa dukej, ia bleu mendimin, se ia pati me zë:

— Medemek, harrove që më le kryetar të dasmës?

Nënë Zanoja pshëretiu gjatë. Duke mos du ruar shikimin e plakut, nisi të hetonte përreth ata pak njerëz që rrinin në këmbë, pa ditur cilën anë të mbanin, dhe tha:

— Përse, o xha Malkë, përse ma bëre kështu?! Do të rrëfehet me gisht nga bota kjo dasma e tim biri.

— Hee-hee... — qeshi plaku. — Ca më mirë do të jetë pér ty, pér fshatin, kur të dëgjojmë të thonë: «Si dasma në Goran».

«Mirë thotë ky», tha ajo me vete e u lëshua në karrige sikur të mos e mbanin më këmbët. Tani ndihej e pafuqishme pér të ikur andej. Në ballë rrudhat i qenë ngushtuar. Ca prej fjalëve që u këmbyen aty e ca nga shqetësimi që lexohej në fytyrën e nënë Zanos, gratë sikur u ligështuan. Ndërkohë nënë Zanoja lëvizi njërin krah sikur të thoshte: «Pa rrini një çikë këtu.» Dhe ato u ulën të heshtura rreth saj. Në veshë i oshëtinin të pérziera bashkë edhe zérat e gëzuar të dasmorëve, edhe këngët, edhe poteret e fëmijëve e sidomos ato fjalë të fundit që hodhi e priti me Malkë Bozharin, Dhe asaj sepse iu kujtua ajo ditë e largët kur ai i kishte trokitur në derë e i kishte thënë: «Zano, moj motër... Kjo shtëpi do dasmë».

— Mylleni dritaren — sekush thirri dhe asaj iu këput mendimi në mes.

— Të marrim një këngë, — tha njëri nga burrat. — A e vendosëm ta vazhdojmë dasmën?

— Sulo! — O Sulo! — kërkoi pas derës një burrë i shkuntër djalin që i binte klarinetës.

— S'është këtu, u përgjigj që nga hajati një zë i hollë gruaje. — Thonë se iku edhe ai me shokët në fushë.

— Nuk ikën ai, jo! — tha me ton të prerë plaku Malkë. — Vetëm atë mbajta nga të rinjtë. Atë dhe dhëndrin.

Nuk vonoi shumë dhe në derë u shfaq trupi i Sulos, zbardhur nga dëbora.

Malkë Bozhari po shikonte me qortim Sulon e nuk iu durua të pyeste:

— Ç'e bëre dhëndrin?

— Ku e di unë! — u përgjigj djali duke kafshuar cepin e buzës.

— Ylli doli përpara meje, — shtoi ai e nisi të zbërthente tokëzën e metaltë të kutisë që mbante klarinetën,

— Edhe kjo më duhej sonte, — tha nënë Zanoja dhe psherëtiu!

«Po sikur të marrë vesh që bashkë me Yllin ka shkuar edhe nusja?»

«Lëre, lëre si i vajti filli», pëshpëritnin gratë.

— Do të vijë, — tha më bindje plaku Malkë.

— Nuk vjen, — kundërshtoi një tjetër. — është me sedër ai djale. S'dahet dot nga shokët.

— Nuk po flet mirë, o Fate. Kot që i del krah. Kështu si mendon ti, nuk u bën mirë as të rinxve, as zakonit, — ndërhyri në bisedë ai plaku i thinjur që tanj rrinte pranë vatrës. — Ne jemi mbledhur sonte të bëjmë dasmë e jo të hamë bukën e Zanos.

Të a katër burra të mbledhur kokë më kokë ia nisen këngës me zë të lartë, si përinat të atij që quhej Fate dhe për qejf të thinjoshit.

Vetëm kaq u desh. Njerëzit sikur u zgjuan. Dasma u ndez përsëri.

Suloja, që u çlodh një copë herë, nuk po mbahej gjékundi. Ai, sa mbaronte një kaba të shtruar, ia niste një valleje të rëndë. Dhoma u mbush me tringëllimën e gotave dhe më urimin: «Zano, të të trashëgohet djali!»

Ato urime ia ngrohën zemrën nënë Zanos:

— Sulo! Bëj një valle për mua! — thirri ajo. Vetë nuk u ngrit, por futi gratë ta hiqnin, vallen që kérkoi.

— Ashtu, de! Ashtu, tē lumtē! — tha plaku  
Malkë i kënaqur.

— Po dal dhe unë, — tha burri i thinjur.  
Ky hoqi xhaketën e shajaktë dhe, tek i kaloi  
pranë nënë Zanos, i pëshpëriti duke qeshur me  
shpirt: — Të paktën tē hidhem një herë tanë, se,  
po erdhën djemtë, s'më mbetet radhë mua.

Nënë Zanoja qeshi me fjalët e tij, po përgjigje  
nuk i ktheu. Atë kohë asaj i shkuan pranë i  
biri me nusen.

— Të erdhën pëllumbat, — e ngau Malkë  
Bozhari.

— Më erdhën tē bukurit e nënës, — tha  
ajo.

— Mos m'u mërzite? — pyeti Ylli.

— Jo, tē keqen..., po ku ishit ju?

— Përcollëm shokët gjer përtej.

— Përse nuk thua që ma paske lodhur nusen?

— Ç'qenka kështu te ju, o nënë? — shpreh  
hu habinë ajo. — Kurre s'do ta harroj këtë natë!

Nënë Zanoja u bashkoi duart, i puthi në ballë  
e i shtyu në valle.

— Qofsh i nderuar, o plak i Goranit!... Qenika  
bukur dhe kështu!

— Prit,.. ti, prit, — tha tjetri e tundi kokën  
më tē majtë e më tē djathëtë. Në tē folur e si-  
për u ngrit dhe hapi përsëri dritaren.

— E di ç'do tē më thuash, — tha nënë Zanoja.  
— Hajde e shiko ato drita që ndezi Namiku, —  
në tonin e fjalëve tē saj u ndje një-  
farë ndjese.

— Jo, Zano, nuk do tē tē them ashtu.

— Po çfarë atëherë?, — pyeti ajo me kureshtje  
e hodhi shikimin jashtë.

— Të kujtoj se ndaj tē gdhirë tē gjithë sa  
janë në fushë do tē vijnë këtu... në dasmën e  
Yllit.

Dhe vërtet, ashtu si tha plaku Malkë, ashtu doli. Pas mesnate dikush thirri: «Dilni e shikoni në dritare!» E para vështroi nënë Zanoja dhe bëri habi. Ishin dhjetëra fenerë që po lëviznin drejt Goranit. Në ato drita ajo përfytyronte djemtë e vajzat e fshatit që vinin drejt shtëpisë së saj, në dasmën e të birit.

## Një mësuese në Larishtë

Nga qendra e zonës, në Larishtë, të çojnë dy rrugë. Njëra është xhadeja e re me truall shkëmbo që, pasi qarkon ndonjë orë a më shumë malin e Kozitës, hyn në fshat, e gjerë sa mund të lëvizin njëherësh tri qerre bashkë. Më tej xhadeja futet në pyjet e ahut, ku drurëve u humbasin majat në mjegull tërë vitin. Kurse tjetra është një rrugëz këmbësorësh, e vjetër sa nuk mbahet mend. Kjo vjen e përpjetë, në faqen e zbuluar e gutishtë të kodrës dhe me bërrylakë të shumtë e të çuditshëm. Në krahanë njihet me emrin Litari i Dystbregut. Thonë se ia kanë ngjitur kështu për shkak të gjithë atyre përdredhjeve dhe meqenëse në krye maja e kodrës vjen e sheshtë, si një lëmë. Aty dherat janë të buta dhe lëndina gjithë beharin rri e qëndisur nga luleshqerrat. Rrugëtari mezi pret të arrijë deri atje, që të ngopë gjoksin me frymë dhe të clodhet një copë herë para se të hyjë në fshat. Që aty mund të soditësh shtëpitë e bardha, një më një, si në pëllëmbë të dorës.

Tani që xhadeja ka ardhur në Larishtë, me gjithë ato lëvizje makinash në mëngjesherë dhe pasdite, njerëzit janë mësuar që ecejaket për në qendër të zonës t'i kryejnë në këto orë. Duke pasur këtë lehtësi, janë të rrallë ata larishtarë

që varen tatëpjetë nëpër Litarin e Dystbregut, por edhe më të rrallë ata që marrin të përpjetën. Vetëm një gëzim i madh apo një hall i tillë mund të të kandisë të zgjedhësh atë udhë, pa pritur ndonjë makinë.

Pasditen e një së shtune nëntori dikush mundi të shquante së largu një siluetë njeriu që ngjitej në atë të përpjetë dhë bëri çudi.

Panë andej edhe të tjerët që mbushnin she-shin e agjencisë së zonës, në pritje të urbanit. U përmend aty një emër vajze, pastaj dikush provoi të lëshonte zë me pëllëmbët nxjerrë hinkë përpara buzëve:

— Boranaaa. Bo...ra...naaaa!

Po njeriu që ngiste me ngut nëpër përdredhjet hollake të kodrës ishte larg e zëri tretej pa arritur deri atje.

— Kot sa thérret, moj Lumto. Ajo nuk është Borana, — foli një vajzë e re.

— Nuk e kam kot, doktoreshë, — ia ktheu prë tjetra. — Borana është. Ne zbritëm bashkë përkëtu, — shtoi në mënyrë këmbëngulëse, pa vështruar prapa atë që i foli.

— Si, nuk të tha gjë!?

— Jo! — u përgjigj mendueshëm vajza që quhej Lumto.

— Po atëherë përse të kthehet? — pyeti mjekja e spitalit.

— S'di, si të them, — pëshpëriti tjetra dhe supet për një çast i mbetën mbledhur.

— Kushedi si e ka hallin bija e nënës, — tha me ton të dhimbur një grua vendase, duke iu afruar të dyja vajzave. Pastaj i pyeti disi fshehtas: — Mamia e Larishtës është?

— Jo, moj nënë, mësuese!... — iu përgjigj Lumtoja me mirësi, por, edhe pse vuri buzën në gaz, në fytyrë dukej e tronditür. U mat të thë-

rriste edhe një herë, por ndërroi mendje aty për aty e dikë nisi të kërkonte me sy në turmën ku-reshtare.

Përreth, njerëzit ishin shumë. Vendas që kishin dalë aty të prisnin urbanin apo makinat që mbartnin lëndë druri. Të tjerët ishin anëtarët e një ekipi shëndetësor, disa mësues të shkollave të zonës dhe katër a pesë punëtorë të sektorit të sharrave. Secili, mbledhur në shoqërinë e vet, shfaqte hamendje nga më të ndryshmet për njeriun që ngjitej përpjetë kodrës. Por erdhi një çast e ç'qenë mësues aty u bënë tok mënjanë. Dikush po tregonte arsyen e vërtetë, përse Borana Markaj po kthehej atë pasdite në Larishtë. Ish-te drejtori i shkollës së zonës që njerëzit brenda sekondës e gardhuan dhe po e dëgjonin vëmendshëm. Ky ishte i ri në moshë dhe i shkurtër në trup, aq sa ata që e rrëthonin ngriheshin në majë të gishtave për të mos u shpëtuar asnjë fjalë. Nga gjestet dhe mënyra se si fliste, kuptohej qartë se nuk po e bënte atë rrëfim për t'u dukur, në sytë e të tjerëve se dinte ndonjë gjë kushedi se çfarë, por vetëm që të qetësonte shoqet e Boranës, që dukeshin të tronditura.

Si u mor vesh e vërteta, gardhi i njerëzve ku-reshtarë u shthur një e nga një dhe pas kësaj secili nuk po shprehte më shqetësim si pak më parë, por mendimin e vet, si e kuptonte dhe si i vinte për mbarë.

— Ama kjo na qenka!? — nuk u mbajt të thoshte një burrë thinjosh, duke shtyrë kapelën me strehë prapa. Pastaj shtoi: — Po përse u voneve të vish, o drejtor i çunave, se u shtimë në merak, si ne dhe ato, — e tregoi me gisht Lumbton dhe mjeken e spitalit të zonës.

— Uaaa. Sa mirë! Po më bëhet qejfi, — po i thoshte atë kohë mësuese Lumtoja drejtorit të

shkollës dhe këmbeu krahët në gjoks sikur ta kish-te aty Boranën dhe po e rrëmbente pas vetes.

— Ehh, Si jemi ne vajzat, — tha mjekja e spitalit, — shqetësohem i për hiçgjë.

— Po si kështu!? Kur?! — pyeti me habi një mësues i një fshati fqinj.

— Sot. Ma tha në telefon shoku Mato, — tha drejtori e lëvizi dorën në erë sikur të thoshte: «E c'rëndësi ka se kur».

— O, po ç'bëhet, jo! — u ngrit një zë i trashë. — Nuk i mbush çupa as dy vjet larg shtëpi-së dhe fup, në prehër të mamasë... — foli një punëtor i sharrave që kishte zënë vend në shkallët e gurta të agjencisë, ulur mbi xhupin prej pambuku të kthyer së prapi.

— Përse flet kështu ti, shok? Mos e ngarko tjetrën pa të drejtë. Se mos është me qejf kjo punë... Dua unë, rri, s'dua, iki...

— Ashtu thua ti, doktoreshë. Eëë? — ia rrëmbeu asaj fjalën nga goja një burrë me fytyrë të rreshkur nga dielli si baltë e pjekur, i veshur i téri me të shajakta e me kërrabën pranë të ngulur në dhe. Ky rrinte ulur qëkur në lëndinë e priste më nga urbanin.

— Ne këtej nga anët tona edhe çobanët e dhënvë i ndërrojmë njëherë në katër a pesë vjet. A në mos më shumë. Nuk e di, a më dëgjove, moj ti?...

— pyeti me shpoti dhe aty për aty nisi të shkundte çibukun në kupën e pëllëmbës së madhe sa dy duar bashkë, ashtu qetë e qetë, sikur të mos ishte ai që u përzie në bisedë.

Nga ato fjalë, mjekja e re ndjeu të prushitej gjer në rrënje të flokëve, më shumë nga logjika e çobanit sesa nga shpotia e tij.

Ndërkohë mësuese Lumtoja iu qas me takt shoqes së saj dhe i pëshpëriti:

— Është nga Larishta ky. Ka dy vajza binjake që ia mësonte Borana...

Në sheshin e agjencisë, rrugëtarët sa vinin e shtoheshin më shumë dhe bisedat ishin ndezur si në një kuvend të vogël që u mbyll papritur vetëm kur ia behu urbani, me atë uturimën karakteristike që ia njihnin të gjithë. Njerëzit, si të ishin kujtuar atë çast përsë kishin dalë aty, rrëmbyen placat dhe me biletat në duar nisën të zbritnin në xhade.

Atë uturimë e njohu së largu edhe mësuesja e Larishtës dhe u drodh njëlloj si pak caste më parë, kur kishte dëgjuar ato thirrjet këmbëngulëse të shoqes së saj. Por meqënëse hëpërëhë nuk kishte ndër mend të qëndronte e të hidhte një sy andej, me zor të madh po mposhtte tundimin, ndaj shtyhej **me përtim**, me ca hapa të vegjël e të **ngadaltë**, **vetëm** e vetëm pér të mos u lënë shoqeve të kuptonin se ishte ajo, megjithëse e shihte se kjo që bënte s'kishte kuptim.

Pa bërë as gjysmën e së përpjetës fytyra i kishte marrë ngjyrë të kuqe, thuajse kishte ndenjur gjatë pranë një zjarri bubulak. Përfund mjekrës hollake i këputeshin pikë-pikë bulëzat e djersës si kurrë ndonjëherë në jetën e saj. Pallton prej stofi të leshtë ngjyrë hiri e kishte zhveshur, por e mbante varur në supe, duke e shtrënguar fort në të dyja cepat e jakës, nga frika se mos ftohej. Në faqen e kodrës frynte era e ndajnatës dhe **kindat** e palltos, flokët e gjatë, bishtat e shallit i ndeheshin gjithandjej, si në një lojë marramendëse. Gjithçka e lirshme në veshjen dhe trupin e Boranës luante me erën e dimrit.

Kur poshtë në xhade u përsërit uturima e njohur, vajza mori me mend se urbani po nisej. Pa e kuptuar as vetë ndali në vend e u kthyte me ballë andej. Atë kohë makina po qarkonte në she-

shin e vogël të agjencisë, me një rrëshqitje të kujdeshme buzë ledhit të lumit dhe sa hap e mbyll sytë mori tatëpjetë xhadesë, duke lënë prapa shtëllunga pluhuri që mbetën pezull për një hop të madh.

— Ikën! — belbëzoi Borana me psherëtimë sikur dikush t'i kishte hequr nga supet një peshë të rëndë, që po e mundonte deri atëherë. Por pamja që kishte ndër sy, në vend që ta qetësonë, e ligështoi edhe më shumë. Nga kjo, zemra në gjoks filloj t'i rrihte harbuar, si në një çast trembjeje. Aty mbi Dystbreg, vetja iu duk krejt e vëtmuar. Me largimin e makinës, iu bë se Lumtoja, shoqet, të niohurit dhe të gjithë ata me të cilët kishte shumë se një viti në atë krahinë, po e braktisin. Nga kjo ndjenjë që e pushtoi papritur u mallëmë këmbë, vazhdonte të sodiste poshtë me ngulm. Por ngaqë sytë i qenë lëngështuar, pamja i shfajë e zbehtë, sikur të shikonte nëpërmjet pluhurit që la prapa urbani. Të qarta, të patrazuara arrinin deri lart në kodër vetëm uturimat dhe boritë e makinave që venin e vinin nëpër xhade. Aty, era frushullonte e lozte me flokët e gjatë, me bishtat e shallit, me kindat e palltos dhe vajza ndjeu rrëqethje në trup. Të ftohtët e kujtoi të lëvizte vendit dhe Borana nisi të capitej me hapa të shpejtuar në rrugëzën e ngushtë që vinte ende e përpjetë.

Më tej ajo ktheu kryet të shihte prapa dhe një herë, si të donte të sigurohej për diçka. Sollë ndër mend atë çast tundimi e qortoi veten gati me zë, kur mendoi që njerëzit ikën, e harruan, e braktisen dhe qeshi hidhur me atë kokëshkrepje të çastit. Po si mund ta besonte një gjë

të tillë, kur vetëm për te qyteti kishte flutuar kohë pa kohë mendja e saj? «Jo, unë nuk jam braktisur nga askush dhe as po braktis njeri... Veç po largohem nga fshati dhe kaq. E cilën nga shoqet nuk do ta gëzonte transferimi. Cilën?» Teksa arsyetonte e fliste kështu më vete, u lehtësua njëherësh sikur lodhja pati genë një send që qe shkundur përdhe, në atë vendin ku qëndroi për pak kohë e hutuar dhe e përlotur si një fëmijë. Ca e nga ca, fytyra iu çel, thuajse nuk ishte më ajo Boranë, por dikush tjetër në vend të saj. Tani gjithë përkujdesi dhe mundi i njerëzve që e donin dhe e prisnin me ankth, në shtëpi, përmblidhej në atë fjalën «transferim», që e ngutte drejt Larishtës për të mbledhur plaçkat. Nata e dimrit, sado e gjatë të ishte, do të gdhinte shpejt dhe e nesërmja do ta gjente të rrethuar nga një kurorë fytyrash të dashura.

Midis tyre do të gjente edhe xhaxhi Fotaqin, me gotën e urimit përpara, si në çdo fund jave, kur ajo kthehej në qytet me urban, e lodhur, e përmallur.

Ashtu në ecje e sipër vetëm një gjë nuk po mundte që nuk po mundte të përfytyronte ajo, edhe pse përpiqej qëkur. Si do ta priste babai? A do të gëzohej edhe ai si të tjerët? Apo... do të skërmitej hidhur? Po sidoqoftë, tani që gjithçka kishte marrë fund, ai nuk do t'i përgjigjej të vëllait ftohtë dhe me ton të vrazhdë: «Rri, o Fotaq, për kokën tënde, mos më turpëro së gjalli me larishtarët, që u kam borxh jetën. Në më do mua, nis një llaf tjetër e mos i fut mizat kot së koti çupës. Nuk e dinë ata se çfarë kurdis ti këtej, por do të mendojnë se unë, unë vetë kam filluar të zbuloj plagët e luftës»...

Tek ngjitej përpjetë nëpërmjet përdredhjeve të asaj rruge që e shkelte për herë të parë, dielli kishte perënduar dhe rrëth e rrrotull po binte mugëtira. Ku e ku më larg, ca re të mbetura pezull mbi kreshtat e maleve ngjanin të kuqërremta, sikur poshtë tyre të digjej një zjarr i madh «Kjo është nata e fundit», foli me vete Borana dhe aty për aty vendosi që në mbrëmjen e së dielës të dilte e të shëtiste deri vonë, mes gëlimit të njerëzve dhe vezullimit të dritave të bardha inkandeshente.

Por nuk vazhdoi dot më se mendimi iu këput në mes. Atë kohë iu bë se dëgjoi ca zëra fëmijërorë si të ishte mes nxënësve në oborrin e shkollës. Megjithatë nuk i kushtoi rëndësi kësaj pandehme se nuk mund të besone që nxënësit e saj të shkonin aq larg fshatit. Qeshi lehtë e qarkoi shallin pas qafës për t'u mbrojtur nga era. Nga kjo u kujtua ta përfytyronte veten në njérën nga shkollat e qytetit, me oborr të gjerë, me muret e jashtme të zbukuruara nga basorelieve, me klasat gjithë dritë, ku dhjetëra sy fëmijësh e hetonin me kureshtje.

Po, për çudi të saj, sa më shumë i afrohej majës së kodrës, aq më tepër zérat forcoheshin. Ato herë i vinin fare të qarta e herë të përziera gjer në vesh me një zhurmë të ngjashme si rrapiellima e gurëve që rrukullisen tatëpjetë. Thua të ishte era që përplasej në fytyrën e zbuluar përgjysmë dhe férshëllima e saj i sillte mbresa të tilla!? Donte ta hiqte mendjen nga ky ngacim, por ishte e pamundur. Si bëri edhe ndonja dhjetë hapa, nuk iu durua, ndaj shpështolli shallin me një lëvizje të vrullshme të dorës dhe ngriti kryet të shihte përpara. Nga pamja që iu shfaq ndër sy shtangu në vend e habitur dhe fuqiprerë. Veshët nuk e kishin gënjiyer. Te kreu

i rrugës, në kufirin midis lëndinës dhe faqes së pjerrët të kodrës dalloj siluetën e një fëmije që thirri me zë të alarmuar.

— Mos shtini gurë... Po ngjitet mësuesja. Moss...  
Sakaq në sfondin ereve të kuqërremta u shfa-

qën një e nga një edhe dhjetë a dymbëdhjetë silueta të tjera fëmijësh që u varën tatëpjetë. Gjithçka ndodhi aq shpejt dhe papritur, sa Borana nuk arriti të mendonte se si të sillej me ta. «Po kjo kështu»!? — vetëm kaq mundi të thoshte me të belbëzuar. Në gjoks të rrahuat e zemrës nuk po mbaheshin. Erdhi një çast dhe pas trupit të Boranës ndali vrulli i vajzave që u ngjitën e u shtrënguan fort, si bletët mbi një degëz peme të lulëzuar. Kurse djemtë zunë të vinin rrotull, vetëm një hap larg mësueses së tyre. Të gjithë dihatnin nga turravrapi dhe Boranës i bëhej se nga buzët e secilit dilte një «oh» a një «ah» i thekshëm habie. Atëherë ajo u përpoq t'i përshëndeste, por nuk mundi të shqiptonte as edhe një fjalë, ndaj, për të fshehur tronditjen, nisi të përkëdhelte me ca lëvizje të ngathëta flokët e njërs nga vajzat.

Dukej sheshit se ajo buzëgreshje e mekur e saj dhe ato veprime të çuditshme nuk shpëtuan pa u vënë re nga fëmijët. Fytyrat e tyre i mbuloi pezmatimi.

— Oh... sa të ftohta i paske duart! — bëri çudi një vajzë trupvogël dhe, si të donte ta ngrohte me trupin e saj të brishtë, i afroi pëllëmbën në faqe dhe herë pas here i lëshonte gulçe-gulçe firomën.

— Ashtu të duket, moj Vjollca, — tha Borana për ta qetësuar, e prekur thellë nga ajo përkujdesje.

— Të la urbani, mësuese!? Përse nuk prite ndonjë makinë?

Borana u zu ngushtë. Kafshoi cepin e buzës dhe nuk po dinte si t'i përgjigjej. Lëvizi rrëshqanthi krahun e lirë, përmbi kryet e vajzave me flokë të shpupurit nga era, derisa pëllëmba pushoi në supin e vogëlushes që pyeti:

— Jo... po..., — u ngatërrua keq Borana nga ajo situatë e vështirë e krijuar nga ky takim i papritur me nxënësit. Pastaj shtoi nxituar:

— Sot e kisha vendosur të qëndroja në fshat. Zbrita vetëm sa të përcillja mësuese Lumton.

— Uaaaa... sa mirë, — s'u përmbajtën fëmijët që zunë të hidheshin pupthi nga gëzimi.

Si kaluan kështu disa minuta, Borana u mat të çlirohej prej krahëve të tyre dhe të nisej përrugë, kur fare pranë dëgjoi ca pëshpëritje që i têrhoqën vëmendjen.

— O Luli! A e gjen përse u khye mësuesja?

— Jo, more, jo. Vjen për Kreshnikun. Dëgjomë mua ti. Harrove që i është rënduar sëmundja?

— Mirë e ka Isai. Kot më kot nuk e merrte të përpjetën e Dystbregut.

Ajo rrrotulloi kryet andej dhe hetoi me bisht të syrit djemtë e klasës së tetë, që çuçurinin kokë më kokë. Po frynte erë dhe fjalët e thëna me zë të ulët nuk u dëgjuan të plota. Gjithsesi diçka nënkuptoi, se psherëtiu thellë. Ai dialog i fëmijëve u bë shkak të kujtohej se kishte premtuar për... Futi dorën në xhep dhe gishtat i prekën në një copë letër të palosur më dysh. Fëshfërima e lehtë e bëri të drithërohej dhe në fytyrë ndjeu zjarrmi prej turpit. «Sa keq! Po tani!» mendoi dhe vetveti pëllëmba iu tkurr, iu bë grusht, sa ndjeu t'i thernin gishtat.

— Ma jep mua çantën, — i tha Vjollça e vogël

duke i dalë përpara si një manare që, tek i lutej, i vuri re sytë e njomur nga lotët.

Atë çast Borana, e turbulluar prej shqetësimit, po hante inat me vete: «Si e harrova Kreshnikun! Po nënë Mara ç'do të thotë kur ta marrë vesh? Përse nuk i dhashë Lumtos recetën!» Por u kujtua aty pér aty, se edhe me shoqen e saj qe treguar e padrejtë. «Përse të ndodhë kështu me mua, pérse? Thua kaq shpirtvogël të jem unë!... Dhe atë kohë vuri re sytë e fëmijëve që, duke ecur të heshtur, shprehnin një dhembshuri të rrallë.

— Sonte do të vish në shtëpinë time, mësuese, — i tha një vajzë e rritur, me flokët lidhur gërshet, duke e prekur lehtë në bërryl.

— Jo, mësuese, jo. Do të të marrë unë. Nëna të është lutur sa herë, — u hodh Luli që pértej e bëri të afrohej. — Ja shtëpia ime. Ajo me atë manin e madh buzë avllisë. E shikon?

Borana u pérpoq të buzëqeshte, po turbullimi që ndiente përbrenda i pengoi buzët të çeleshin plotësisht. Qëndroi në vend, u përkul mbi nxënësit që i rrinin ngjitur e puthi me radhë disa prej tyre. «Ç'zemër të madhe e të dhembshur që kanë», mendoi. Jo, kurrë nuk e kishte besuar se i donte aq shumë. E si mund të ndahej aq lehtë prej tyre. Ata nuk e meritonin zhgënjimin. Ata meritonin shumë, shumë.

Ecnin së toku në pjesën e rrafshët të kodrës. Mbrëmja porsa kishte rënë dhe nëpër oborre zunë të ndizeshin dritat. Era rrëmbente zërat e fshatit e i shpërndante gjithandej. Në këmbët e tyre herë-herë ndihej zhaurima e guriçkave.

— Nuk ju pyeta, — tha Borana pér të ndërruar bisedë, — si u ndodhët këtu?

— Ndihamjë kooperativën, — ia priti menjëherë Isai.

— Kooperativën!? Po, si? — qeshi e habitur ajo.

— I pastrojmë gurët lëndinës, që në verë të rritet bari për qengjat e tufëzuar.

— Edhe ti, moj Vjollca?

— Ehëë. Edhe ne vajzat, mësuese. Po sot bëri ftohtë dhe shoqet e vogla i kthyem në shtëpi. Ja Kreshniku këtu...

— Ulemi, këtej, mësuese. Ky shteg na nxjerr në shtëpinë time, — tha Luli.

Po Borana nuk foli. Kishte hapur krahët anash si t'u thoshte fëmijëve «pa prisni njëherë» dhe mbante vesh e përqëndruar. Atë kohë nga ana e xhadesë u dëgjua një uturimë makine dhe pas një bërryli u shfaqën ca fasha të fuqishme drite.

— Isa! Më nxirr për shkurt në xhade, — tha ajo papritur. — Ju të tjerët shkoni nëpër shtëpi. Nesër ejani në shkollë të zbuluojmë së bashku klasat. Natën e mirë, — tha dhe u vu të ecte pas nxénësit që printe rrugën me një lloj ngutjeje të guditshme. E kishte vendosur që me njeriun e parë që do të gjente në atë makinë të niste recetën në shtëpinë e saj dhe kishte besim se babai do të bënte çmos për të gjetur ilaçet e nënë Marës. I gjuar, nga vendimi që kishte marrë ajo për të qëndruar në fshat, mbase do të ngjitej vetë të nesërmen deri në Larishtë.

## Po të njoh tani

Sadri Memushi e cte rrëzë trotuarit me cigaren e shuar të harruar në buzë, çehrevrarë e i menduar si kurrë ndonjëherë. Ai, ndryshe nga disa orë më parë, po kthehej aq i turbulluar, sa nuk ishte në gjendje të ndiente as dosjen e rëndë nën sjetull. Porsa kishte dalë nga mbledhja e komitetit të kulturës dhe të arteve në rrëth ku, ndryshe nga q'e pandehte, tërë rrëketë e kritikës ishin derdhur mbi të.

Kishte marrë inat të madh me Nestorin, përgjegjësin e sektorit të muzikës, që e kishte në varësi, sepse ai, në prani të njerëzve të mbledhur në zyrën e kryetarit, kishte shfaqur mendim të kundërt me raportin dhe kishte ngulur këmbë që shkakun për mosngritjen e ansamblit artistik të mos e kërkonin gjetkë, por të vetë drejtore Sadriu, që e kishte zakon t'i zvarriste punët.

Gjer këtu kishte mundur të duronte Sadri Memushi e më tej jo. Ai që ngritur ta kundërshtonte Nestorin, por i kishte mbetur fjala në gojë, kur shoku Bako e kishte bërë të ulej në vend vëtëm me një gjest të dorës, si t'i thoshte: «Rri e dëgjo, se të bën mirë».

Që nga ai çast Sadriu ishte bërë i heshtur, si pa gojë. Ajo Shenja e kryetarit e kishte vënë në siklet, ndaj balli eshtak i ishte bu-

lëzuar me djersë të ftohta, sikur një dorë e padukshme e lagtë vazhdimisht me ujë. «Jo, jo! Shoku Bako nuk më tha ashtu! Rëndoij më shumë se një muzikant unë», kishte menduar dhe kishte parë me ngulm nga ai se mos i kapte vështrimin. Por çdo përpjekje i shkoi kot. Kryetari dëgjonte Nestorin me vëmendje e seç shkrante herë pas here. Pas çdo çasti që kalonte, Sadriu e ndiente se po gërmuqej dhe më në karriqe, kurse në tëmth i rrihte me forcë një damar inatçor.

Vonë, shumë vonë, kur kishin mbaruar diskutimet, dikush që i rrinte pranë i kishte pëshpëritur:

— Shoku Sadri!... — dhe e kishte çokur me gju.

— Eëh! — kishte bërë ai i hutuar.

— Po flet shoku Bako... Nuk e dëgjon!?

— Atë po dëgjoj edhe unë, — ishte përgjigjur Sadriu, pastaj me shumë kujdes kishte hedhur vështrimin nga tryeza e kreut dhe atë kohë ndeshi me vështrimin e përgjegjësit të arsimit dhe të kulturës që qortueshëm kafshoi buzën.

«Edhe kjo më duhej!» — mendoi e nxori nga xhepi i brendshëm i xhaketës një bllok të vogël, me kapakë të butë ngjyrë kafe dhe një stilolaps të kushtueshëm, të cilët, siç thoshte ai, ia kishte falur për kujtim një personalitet në fushën e artit. Kishte filluar të mbante shënim, të nënvizonte, të mbyllte në kuadrate çështjet më të rëndësishme, por, ndryshe nga herët e tjera, nuk i kishte kushtuar rëndësi shkrimit.

Pastaj, për të lehtësuar në njëfarë mënyre përgjegjësinë dhe për t'u treguar eprorëve se ishte operativ në korrigjin e të metave në punë, posa kishte mbaruar mbledhja e komitetit kishte urdhëruar me zë të lartë që në orën dy-

mbëdhjetë të asaj dite të bëhej një takim me të gjithë përgjegjësit e sektorëve të institucionit. Për këtë qëllim kishte nisur përpara Nestorin, që t'i njoftonte pa umbyllur orari zyrtar.

Sadri Memushi, tek ekte për atje, e parandiente me dhembje se atij djali çapraz nuk do t'i rrinte goja pa folur me shokët për ato që pa e dëgjoi në mbledhje, se, duke filluar nga ajo ditë, autoriteti i tij si drejtor do të lëkundej disi. Por në të njëjtën kohë ai ishte i bindur në afësitetë e veta se ajo gjendje nuk do të vazhdon te gjatë. Ai, në rrugë e sipër, po e pikte me mend që në takimin me vartësit ta merrte punën urtë e butë e sidomos me të dy piktorët, me të cilët para një javë kishte bërë debate, kur kishin diskutuar dekorin e komëdisë «Mos prit ujë nga poçi i thyer.»

Ta kundërshtonin Sadri Memushin për problemet e artit, për të cilat mbëhej se i njihtë me themel, apo ca më keq, ta detyronin të hiqte dorë nga mendimet e veta, ishte njëlloj si t'i shkulnin nga gjoksi një brinjë. Le pastaj kur mendime të tilla ia shfaqnin ata që i kishte nën urdhra. Sa herë që i ndodhë kështu, ai vuante tmerrësisht nga marazi. Po për fat natyra i kishte falur vetinë që të kapërdinte çfarëdolloj mlefi a hidhërimi. Ai qeshte me ata njerëz delikatë që në çaste të vështira humbasin toruan e bien në gabime për shkak të gjaknxehtësisë.

«Le t'u shkojë e tyrja sot», mëndoi ai. Kurse me Nestorin do të mëdiqte një taktkë tjetër. Do ta mbante afër ca kohë, për të krijuar përshtypjen të të tjerët se në shpirtin e tij nuk zinin vend kollaj vogëlsirat. Pastaj me të parë e me të bërë. Gjer të mbollej viti kishte edhe ca muaj të tjerë.

Afër kreut të rrugës, përtej çative të mbu-

luara nga gjelbërimi i pemëve, u dukën konturet e pallatit të kulturës. Sadriu përveshi mëngën dhe vështroi orën. Për çudi, edhe pse kishte ka-luar nga ajo anë, duke iu shmangur qëndrës së qytetit, përsëri kishte arritur më parë nga sa e mendonte. Nuk i erdhi aspak mirë që ndodhi kështu. Filloi t'i bënte hapat gjithnjë e më të vegjël, me qëllim që të vonohej edhe disa minuta. Ai provonte kënaqësi të veçantë kur i bënte vartësit që ta prisnin. Këtë zakon nuk donte ta prishte kurrsesi as atë ditë.

«Uff!» — psherëtiu i lodhur dhe shtyu mbi supe xhaketën. Por, tek bëri kështu, ndjeu t'i rëndonte në xhep blloku i shënimeve. Shpuri dorën në xhep dhe e preku gjatë me gishta. E përfytyroi veten për një çast pa të dhe u drithërua. Atje kishte mbajtur shënim problemet, detyrat, përgjegjësinë.

I shkrepit një ide: «Si të mbaroj punë me djemtë, po mbyllem ca orë në zyrë. Nuk është keq t'i formuloj që sot një informacion të hollësishëm shokut...» — por s'e shpuri mendimin deri në fund. «Jo, jo! — ndërrroi mendje. — Është shumë shpejt dhe kështu do t'i lë përshtypjen shokut Bako se i zgjidh problemet në mënyrë metafizike. Po e bëj pas një jave më mirë. Deri atëherë gjërat mund të marrin rrugë dhe... Më kërkuan të ngre ansambël e jo estradë.»

Por pas kësaj mëdyshjeje ndaloi në vend, sikur t'i ishin këputur gjunjët...

«Ç'po ndodh kështu me mua!? — pyeti vëten. — Përse më mbeti në mendje shoku Bako?! Përse gjithë kjo frikë?! Thua të ketë mbetur ndonjë gjurmë nga ajo puna e Miços, pa u soll ashtu me mua? Po unë atëherë vetëm sa propozova për largimin e tij nga pallati, kurse vendimin në komitet e paraqiti seksioni. Edhe

karakteristikën të mirë ia bëra... Jo, jo!... Në këtë pikë askush nuk më zë dot», arsyetoi me zemër të ngrirë.

Kushedi sa gjatë do të mbetej i harruar në mendime, po të mos ishte dhënë në krye të rrugës shpérndarësi i shtypit, hipur në bicikletë.

— Na, more Lame! — i lëshoi zë Sadri Memushi.

Tjetri ndali vrullin e iu përgjigj që përtej:

— Urdhëro, shoku Sadri!

— Ndalo, ndalo pak!

Shpérndarësi qarkoi në hapësirën e rrugës e frenoi zhurmshëm pranë tij. Sadri Memushi u tërhoq anash dhe atë çast ndjeu t'i rrihte zemra harbuar nga një parandjenjë e çuditshme. Ndonjë muaj më parë kishte nisur në redaksi një shkrim të gjatë për jetën kulturore artistike të rrethit dhe dita më ditë priste me ankth ta shikonte të botuar. «Ah, sikur të ma kenë nxjerrë sot, do të më bënин nder të madh!» mendoi e pshëritiu thellë.

— Ke ndonjë zarf për të nisur, shoku Sadri? — pyeti shpérndarësi, duke dihatur prej lodhjes.

— «Ncëq», — përplasi buzët Sadriu dhe shtriu krahuun drejt çantës, mbushur plot me gazeta.

— Sa t'u hedh një sy.

— T'i nxjerr Lamja, — tha shpérndarësi dhe aty për aty i lëshoi në dorë disa prej tyre. Pastaj tërhoqi bicikletën e u mbështet pas murit të një oborri për t'u mbrojtur nga dielli. Aty ndezi një cigare.

Sadri Memushi gjeti gazeten që i duhej, e shpalosi dhe nisi ta këqyrte me sy të picërruar, duke lëvizur kokën poshtë e lart, sikur të përshtendoste njeri. Erë nuk pipëtinte gjëkundi e megjithatë fletët e gazetës dridheshin.

— Qasu, qasu këtu nën hije, shoku Sadri,  
— foli shpërndarësi i shtypit duke hequr cigaren nga buzët.

Atë kohë Sadriu palosi më dysh gazetën i bërë prush në fytyrë prej zhgënjinimit. Ngjatjetoi me dorë Lamen dhe u largua. Me t'u kthyer në qoshen që të nxirrte në sheshin e asfaltuar të pallatit të kulturës, shpejtoi hapat. Aty u ndesh ballë për ballë me Nestorin. I ndezur nga mëria, ndjeu diçka t'i therte në gjoks. «Po nuk të bëra që t'i thuash derrit dajë, mos më thirrshin në emër», mendoi, kurse atij i buzëgoshi:

— Ngjitemi lart! — Dhe i futi krahun miqësisht.

— Unë kujtova se nuk do të vinit! — tha Nestori me ton të shqetësuar. — Nuk lashë telefon pa rrahu.

— Ashtu më doli një punë, — përligji vëten Sadri Memushi, duke lënë të nënkuptohej se diçka e rëndësishme e kishte bërë të vonohej.

— Ndonjë mbledhje tjetër kështu? — pyeti Nestori.

— Jo, jo! — kundërshtoi Sadriu me zë të butë dhe, ashtu trupgjatë siç ishte, e vështroi nga lart.

— Më mbajti shoku Bako për një kafe. Nuk e di, por sot më la pa mend. Veç të ishe e ta dëgjoje se me ç'pasion fliste për problemet e kulturës. Paçka se si u shpreh në mbledhje, por vlerësimin për punën... ma bëri hapur.

Nestori qëndroi në vend dhe po e shikonte i habitur, thuajse nuk po u besonte veshëve.

— Hehee! — qeshi nën zë Sadri Memushi e i rrahu supin lehtë. — E shoh që nuk të besohet, more djali. Po nuk të hedh faj, se... ende nuk e njeh drejtorin tënd.

— Ja, po të njoh tanë, — e ndërpreeu Nestori

duke nënqeshur. — Ti vetë po më ndihmon! —  
shtoi, duke e vështruar ngultas dhe me për-  
çmim. — Shoku Bako është lart. Ka gjysmë ore  
që po të pret.

Pastaj i ktheu krahët dhe nisi të ngjitte  
nxituar shkallët e pallatit.

155

## Pas largimit

Blerina doli nga dhoma, e veshur me një fustan të gjatë ngjyrëkafe të çelët dhe nisi të krihej me nxitim përpara pasqyrës së korridorit. Atë fustan ajo e vishte për herë të parë, ndaj po hetonte veten gjithandej me atë kureshtjen e përhershme që provojnë vajzat në të tilla raste. Copa prej basme që kishte zgjedhur në dyqanin e fshatit, ku punonte si mësuese, nuk ishte kushedi se çfarë, por të bukur atë e bënин jaka e vogël që i rrinte e ngirirë pas qafës, ca fruda të imta që i valëzoni mbi supe dhe ai rripi i mesit i lidhur në formë fjongoje anash belit. Duke u vështruar kështu, ajo qeshi e kënaqur. Për Milton, sipas mendimit të saj, ky fustan do të ishte një surprizë e vërtetë kur të takoheshin. Dhe atë çast i erdhën ndër mend fjalët që kishte këmbyer një fund javë, kur po udhëtonin në tren së bashku.

«Kot i gëzohesh kësaj!» i kishte thënë ai duke prekur copën me majat e gishtave. «Gjë e mbetur... Po mbushen pesë vjet që e shikoj në të njëjtin raft...»

«Uaa!» ishte habitur Blerina «Sadushi dje u furnizua!... Po ty vërtet nuk të pëlqen?»  
«Hiç fare!»

«Posi! Bën shaka më duket», — kishte shtuar Blerina, dhe ata kishin zbritur nga treni. Megjithatë, diçka si pezëm i kishte mbetur. Ai nuk e kishte pasur zakon të fliste me një ton aq, të prerë e përcmues.

Për një çast Blerina ndërprenë të krehurit përpara pasqyrës dhe, duke përfytyruar djalin që donte, pyeti me vete: «Po! tani si do t'i dukem, ë!?

U hap dera e kuzhinës, dhe ajo dëgjoi të emën që i tha:

— Poç'bëni kështu, moj, bijë!? Një orë që heq e vesh fustanet!

Blerina vonoi të përgjigjej, sepse e pengoi kapsja e flokëve që e mbante të shtrënguar mes buzëve.

— Ja, me këtë do të dal, — tha ajo pas pak dhe shikoi yeten në profil.

— I bardhi, të shkonte më shumë, — tha e ëma si me keqardhje.

Blerina nuk i foli. E puthi në faqe dhe bëri të dilte.

— Do të vonohesh sonte? — e pyeti e ëma, që vazhdonte t'i rrinte pranë duke e soditur me vështrim përkëdhelës.

Blerina mblodhi supet.

— Përpiku, të kthehesh shpejt, — shtoi e ëma si me të lutur. — Yt atë të shikon rrallë e ka mall të rrijë me ty. Ai nesër prapë do të niset herët dhe...

— Mire, — premtoi vajza më shumë me krye sesa me zë dhe vazhdoi të zbriste shkallët. Trokëllima e sandaleve, kumboj, gjatë në hapësirën e shkallëve.

Buzëmbërëmja ishte e ngrohtë, dhe në rrugë gëlonin plot njerëz. Shumë prej tyre ngjiteshin përpjetë me hap të ngadaltë, drejt shëtit-

res së madhe, ku shëtitja e zakonshme e mbrëmjes porsa kishte filluar. Duke nxituar mës lumit të njerëzve asaj iu kujtua Miltoja i saj. E përmendi me zë emrin e tij dhe iu kujtua ajo ditë... Por nejse, tani kishte kaluar një javë nga ajo ditë që ai s'i kishte dalë në takim dhe ajo po e priste me dëshirë. Edhe pse vëtmia dhe shqetësimi i gjithë atyre ditëve e kishin prekur pak, tani që çdo hap e afronte pranë tij, ajo lumturohej. Pikërisht se ndihej kështu, Blerina e kishte vendosur që të mos e mërziste atë me: «Si ndodhi e pse ndodhi». Sepse, kur njeriut i kalojnë ca dyshime e hamendje jo të mira, nis e mendon për gjëra krejt të tjera, ashtu siç po mendonte edhe Blerina.

Pak e nga pak po i afrohej shëtitores së gjëre që gumëzhintë nga zërat dhe uturima e makinave. Duke vështruar në atë drejtim, Blerinës iu lybyrën sytë nga dritat. Edhe për atë shëtitore të zhurmshme, me të cilën e lidhnin aq shumë kujtimë, ajo ndiente mall një lloj si për njerëzit. Po mbusheshin dy vjet që kishte mbaruar shkollën e purionte në fshatin Kthinëz të rrëthit N. dhe pothuaj se ishte bërë po kaq kohë që nuk kishte dalë të shëtiste as me shoqet e as me prindërit. Pikërisht për këtë shkak asaj shpesh i dukej vetja si mysafire e rrallë në qytetin e lindjes.

Çdo të shtunë (se të dielave udhëtonte për në N. me trenin e pasdites) ajo vetëm sa i binte kryq shëtitores duke kaluar përbimi urë gjithmonë e ngutur. Pastaj merrte krahun e djathitë të rrjedhës së Lanës, në rrötuarin e ngushtë midis plepave e trëndafilave të mbjellë dendur. Kjo që e vërmja rrugë që e shkelte rëndom, por që e pëlgente shumë sidomos në atë stinë kur degët e holla ngarkoheshin

me gonxhe tē porsaçelura. Blerinës i pëlqenin edhe ngjyrat, edhe aroma e tyre dehëse, por edhe fletët e brishta që lëpiheshin pas kërcejve me fëshfërimë. Diku më tej, nën hije, e priste Miltoja, tek i njëjt vend e në tē njëjtëni orë, gjithmonë. Ishte kjo një lloj marrëveshjeje e heshtur, e vendosur prej tē dyve që në ditët e para tē njoħħes, atje në Kthinëzén e largët e që gjatë gjithë asaj periudhe nuk pësoi asnjë ndryshim edhe pse Blerina, kohë më kohë, pati shfaqur ndonjë mëndim tē kundërt. Në këtë pikë Miltoja kishte këmbëngulur dhe ajo nuk kishte gjetur forca tē kundërshtonte arsyetimet që i paraqiteshin si në tē mirë tē marrëdhënieve tē tyre. Kështu, pas atyre fjalëve tē tij aq tē hidhura që «ju vajzat çdo gjë e kérkoni më bujë; ju vajzat më parë se dashurinë shikoni martesën», e tē tjera, pak e nga pak, ky mendim i Milto Tonarit kishte marrë trajtēn e një kushti...

Po ç'rëndësi kishte kjo më nё fund? Tani ai ishte kthyer në Tiranë dhe shumë gjëra patjetër që do tē ndryshonin. Pas kësaj, ditët dhe netët e tyre do tē kishin më shumë gëzime e drithë. Edhe koha e humbur, edhe ajo monotoni e casteve tē takimit nё atë rrugëzën e errët tē parkut, larg jetës së gjallë tē qytetit e syrit tē njerëzve, me siguri që do tē harroheshin shpejt.

Ja, kështu mendonte Blerina duke kaluar përmbi urë e duke e hedhur herë pas here vështrimin nё drejtim tē kullës së sahatit, e cila po zhëdukej prej muzgut, që sa vinte e bëhej më i dendur. Erdhi një çast dhe fusha e rrumbullakët e orës u ndriçua së brendshmi. Akrepat rrëfenin gjashtë pa tri minuta: «Qenkam vonuar!» — foli ajo gati me zë dhe përsëri shpejtoi hapat. Kishte dëshirë që atë copë rrugë që i kishte

mbetur ta shkelte me vrap, por e përmbajti vreten, se shëtitoren e kishte ende pranë. Si bëri ndo njëqind hapa, u dëgjuan këmbë që vinin në drejtim të saj. Blerina u bë e vëmenëshme. Përpara saj u shfaq një siluetë dhe ajo fërgëllloji nga e papritura. Njeriu që po afrohej ballas me të ishte i gjatë sa Miltoja dhe ajo, e gëzuar, gati sa nuk lëshoi zë. Por hoqi dorë shpejt nga ajo kokëshkrepje kur mendoi se ai kurrë ndonjëherë nuk kishte dalë ta priste deri atje; Vërtet, i panjohuri, sikur t'ia kishte kuptuar mendimin, zbriti nga trotuari dhe i liroi rrugë. Blerina qeshi me vete. Dritat inkandeshente, me qafat e përkulura brenda degëve, derdhnin mbi asfalt copa njollash verdhëreme që ngjajnë quditërisht me gjethet e rrëzuara nga era e vjeshtës. Më tej ndaloi hapat dhe u mbështet me sup pas trungut të plepit, që anohej pak mbi lumë. Aty ishte vendtakimi i tyre që Miltoja e quante «stacioni i parë». Blerinë po mbante vesh e përqendruar. Përreth nuk ndihej asgjë. Vetëm shushurima e rrjedhës së ujit e trazonte heshtjen që kishte pllakosur rrëth saj. Duke ndenjur ashtu e vetmuar, në kokë i vinin lloj-lloj mendimesh që nisen ta trish-tonin. Psherëtiu. Po atë kohë, bashkë, me fershëllimën që i doli nga buzët e shtrënguara u dëgjua edhe një zhurmë mbi bar, fare pranë këmbëve të saj. Blerina lëvizi e trembur dhe e gëzuar njëkohësisht. U tërhoq nga plepi kurriinte e mbështetur dhe po hetonte e përqëndruar në hapësirën e ledhit. Nga ana e lumit errësira ishte më e thellë dhe ajo s'po mund të shquante gjë. Ajo foli: «Milto», me zhë, por askush nuk iu përgjigj.

Një javë më parë Blerina kishte dalë aty, kishte pritur vetëm pak minuta dhe ishte lar-

guar e dëshpëruar, pa ditur shkakun e vërtetë.  
«Po sonte!? — pëshpëriti. — Mos vallë për këtë më mban mëri!?.» Por nuk e vazhdoi gjer në fund, se druhej mos nga dëshpërimi e gjykonte Milton padrejtësisht e pastaj turpërohej me velen. Vendosi të priste edhe më, duke kujtuar gjëra të gëzueshme e gjithçka tjetër; por pa i vajtur mendja të dyshonte. Por edhe të mendonte kështu, koka nuk i punonte nga turbullimi. Pa e kuptuar as vetë, u përkul mbi trëndafilat e mbjellë aty pranë dhe ndeu pëllëmbën mbi to. Sakaq degëzat u troshitën dhe pikuan përdhe me zhurmë të lehtë, siç bie shiu në pranyerë.

Si kaloi edhe një copë kohë, Blerina i ktheu krahët errësirës e mori të ecte ngadalë, e menduar dhe e pushtuar nga një lloj topitjeje e përgjithshme që po e bënte të vuante. Iu kujtuan shumë gjëra, e mbi të gjitha fytyra e Miltos, ai i téri, me bluzë të bardhë, në korridorin e spitalit të vogël të Kthinëzës, me stetoskop të varur në qafë, me duart futur në xhepa, aştu herë i gëzuar e herë i zvmtë, herë i dashur e herë mospërfillës, ku fjalëpakkë e ku... Po, deri këtu. Befas buzët sikur iu drodhën, sikur i belbëzuan në mënyrë të atillë si t'i rrëfente dikujt diçka tepër të rendësishme. Ja, atë çast ajo po përpiqej me ngulm të rikujtonte fjalë për fjalë cfarë i kishte thënë vetë e cfarë i kishte thënë ai atë ditë kur i kishte shpënë për vizitë mjekësore. Një nxënës, të klasës së parë që ankohej për sytë.

Ajo — Nuk po më përcjell?

Ai — A nuk e shëh sa njërz më presin pas derës!?

Ajo — As sot që jam e mërzitur?

Ai — E mërzitur the!? Po, përsë!?

Ajo — Në fshat po pëshpëritin...

Ai — Për mua jo, më duket. Kurse për ty mundet.

Ajo — C'flet kështu, Milto? Përse e bën këtë dallim?

Ai — Po mirë të të bëhet. Java shtatë e titëtë këtu. Mbive në spital, sikur fëmijët e shkollesë të mos kenë prindër.

Ajo — Milto!

Ai — Pa më thuaj, kush të paska fryrë kështu? Teuta, Nora, apo?

Ajo — Ty mendja gjithmonë tek ato të shkon...

Ai — Sepse ato kanë ca ide të «mencura» dhe mua më vështrojnë sikur t'u kem ngrënë bukën. Po mirë, mirë. Ik tani se, duke ndenjur këtu, ti vetë u lë rast këtyre të flasin përshtata. Takohemi të shtunën dhe... Prit! Fshiji lotët, pastaj dil që këtej.

Ajo — Sa turp më vjen! S'guxoj t'i shoh njerëzit në sy. Po mbushen dy vjet që mundo-hemi t'u vidhemi të gjithëve. Përse të presim më?!

Ai — Do të bëje mirë që nga dy vjetët të zbritje ditët e javës, duke filluar nga e diela deri të premten, që të lehtësoheshe ca. Unë për vetë nuk i kam numëruar këto, prandaj them se është shpejt.

Ajo — Seriozisht po flet?

Ai — Të kthehem në Tiranë njëherë, pastaj bisedojmë për këto gjëra.

Ajo — Edhe për këtë flitet këtu në Kthinëz, por unë nuk kam besuar se ti nuk ke thënë gjë. Vërtet të kanë kërkuar, Milto?...»

Por atë kohë një zë i njojur e përmendi:

— Ngadalë, moj shoqë, se do të na shkelësh!

Blerina ngriti kryet e bëri çudi. Përpara saj qëndronin Teuta me Norën. Nora që mbështetur

me bërryl në murin e urës, fare pranë një grupei djemsh që bisedonin mes tyre me zë të lartë. Njërin gjue mbante të përthyer e rëndonte lehtë mbi sandalen e zbërthyer. Blerina i përvshëndetë me krye, gjithë frikë se mos atë çast ia shkrepente të qarit.

— Unë për vete nuk të njoha fare! — tha Teuta duke rrahur pëllëmbët.

— Na mbetën sytë te fustani dhe po të shikojm që përtej, — tha Nora, kur, fap, na mbive ti!

— Të paska dalë vërtet i bukur! — shtoi Teuta duke iu sjellë rrötull e duke e prekur gjithandej. — E gëzofsh!

Ndërsa shoqet i flisnin, ajo i dëgjonte e përhumbur, si në ëndërr. Në veshë i tingëllonte ende zëri i Miltos.

— Pse, ty s'të pëlqen? — foli prapë Teuta.

— Kush!? — pyeti e hutuar Blerina.

— Unë të urova, kurse ti!

— Nuk të dëgjova, — u shfajësua Blerina, — Faleminderit!

— Këtë model s'ta lë pa ta marrë! — tha Nora.

— Lëvizim! — tha Blerina me vështrim nga turma e dendur e njerëzve që shëtitnin në shëtitore.

— Prit! — tha Nora. — Do të Remi të reja sonte. Mozën tonë e takoi përsëri ai djali flokë-verdhë dhe në po e presim këtu.

— Harrova të të pyes, — tha Teuta. — Hë, ku është vendosur me punë Miltoja? Në spital apo në ndonjë poliklinikë?

Me të dëgjuar ato fjalë, Blerina u drodh, si në ethe dhe sytë iu lëngështuan. Vajzat ia ndien shqetësimin e shkëmbjen vështrime të habitura.

— Nuk e di! — U përgjigji ajo me zë të penguar dhe supet i mbetën mbledhur për një kohë të gjatë.

— Pse, as sot nuk erdhi? — pyeti Nora e shqetësuar dhe i shtrëngoi krahun miqësisht.

Blerina pohoi me kokë dhe, tek bëri ashtu, dy pika lot i lanë gjurmë mbi faqe. Shoqet e tërhoqën mënjanë e ajo shkoi e bindur pas tyre,

— Të keqen motra! Mos kështu! — e lutti Teuta. — Kushedi si e ka punën. Ndoshëtë nuk ndodhet në Tiranë... Ndoshëtë... Apo jo, moj Nora?

Po Nora vonoi të përgjigjej. Shikonte herë njëren e herë tjetrën me sy të picërruar. Ajo fytyra e saj, e qeshur gjer më parë, tanë dukej e zyrtë dhe e trishtuar.

— S'di si të them, — nisi ajo, — edhe ikja e tij nga Kthinëza, pa njoftuar Blerinën, nuk më pëlqen... Në njëfarë mënyre unë e shfaqë mendimin që atje... Ai...

— Mos! Të lutem, mos! — e ndërpren Blerina.

— Po tjetra e prekur nga gjendja e shoqes, deshi të vazhdonte.

— Nora! — i thirri qortueshëm edhe Teuta:

— Mjaft me ato parashikimet e tua, sikur të jesh brenda lëkurës së tij. Le të gjykojmë me gjakftohtësi.

Pastaj, vetëm kur Nora u bë e heshtur, Teuta shtoi duke i theksuar fjalët:

— Dëgjo, Blerina! Kam mendimin që nesër të mos vish me ne. Qëndro në Tiranë dhe përpiku ta takosh. Sa për orët e mësimit, mos u bëj merak se i zhvillojmë unë e Nora... Hë! Si thua?

Blerina psherëtiu si e lëdhur. Nuk po diinte si të përgjigjej. Asnjëherë në jetën e saj nuk e kishfe ndier veten aq ngushtë.

— Apo do që të qëndroj dhe unë, — e ngau përsëri Teuta.

Blerina e vështroi me një buzëqeshje pa kuptim.

— Po vjen Moza! — tha Nora.

Ato kthyen kryet andej nga po vinte shoqja e tyre, që po afrohej me vrap, e shkujdesur nga njerëzit, si një fëmijë i gëzuar.

— Ua, çfarë tipi! — tha Moza porsa shkeli pranë tyre. — Më prezantoi me të vëllanë dhe me shokët, sikur t'ia kisha pranuar propozimin qëkur.

— S'ka ndonjë të keqe! — tha Nora duke i kërkuar shikimin.

— Le të ecim, — tha Teuta dhe u nis duke marrë me vete Blerinën. Pas tyre shkoi Moza. Kjo i doli në krahun tjetër Blerinës e iu ngjit fort në sup. Pastaj filloi t'i fliste nxituar:

— Kur po vija këtej, pashë Milton. I dola përpara që ta uroja për transferimin, por ai s'ma vari fare... Të them të drejtën, Blerina, më erdhi shumë inat e thashë me vete: «Mendjemadhi! Erdhi në Tiranë dhe kujton se zuri qiellin me dorë. Kushedi si i dukemi ne të provincës!» Por ti, aman, mos ia thuaj këto.

Ndërsa ajo fliste kështu, Nora, që vinte nga pas, u kollit me nënkuptim. Teuta, nga ana e saj, kishte ulur sytë përdhe. Kurse Blerina, pasi bëri edhe dy-tre hapa, qëndroi në vend, e pushtuar nga një dëshpërim i papërmabajtur. Pra, ai ndodhej në qytet dhe nuk kishte dalë ta takonte. Vetëm tani po e kuptonte se sa ishte nxituar, se ishte zhgënjyer në një dashuri që s'do t'i kthehej më. Ndiente dëshirën të shpërthente në dënesa, por, edhe për çudinë e saj, vetëm sa kapi Mimozen lehtë nga krahu dhe me qetësi i tha:

— Të jesh e sigurt se nuk do t'ia them kurrë.

Appena quei giorni furono passati, la vita  
non ebbe più il suo carattere di quiete e di  
soddisfazione. La casa di S. Antonio era  
una grande scuola di carità, dove gli  
uochi erano in ogni momento alle prese con  
moltissime miserie. I poveri venivano  
ogni giorno a supplicare ai piedi del santo  
solleciti di sollecitare alzate le loro speranze  
e confortate le loro fatiche. Tantissimi  
erano i casi di disoccupazione, malattia, di  
malattia mentale, di povertà, di orfani,  
ma non mancavano neppure di persone  
intelligenti, di persone colte, di persone  
con qualche talento, che avevano perduto  
ogni speranza di trovare un lavoro, e  
che venivano a supplicare al santo  
per essere aiutate. Il santo, che era  
un uomo di grande saggezza, sapeva tutto  
quello che accadeva nel mondo, e sapeva  
tutto quello che accadeva nella vita  
degli uomini. Ecco perché il santo  
era così famoso, perché il santo  
era così amato, perché il santo  
era così venerato. Il santo era  
un santo, un santo, un santo.

## P È R M B A J T J A

ARA E VOGËL BUZË XHADESË .....	3
DJEMTË E QARKORIT .....	16
ÇOBANI BENDO .....	29
RRUGË NËPËR NATË .....	41
KËMISHA E DHËNDERISE .....	52
LULAN OSTROVICA .....	65
NË NJË MËNGJES ME SHI .....	78
TRI KRISMA NË FUSHË .....	88
GJURMË .....	98
KRYETARI .....	107
SHQETËSIMI I BENAN VISHNJËS .....	117
QENKA BUKUR DHE KËSHTU .....	126
NJË MËSUESE NË LARISHTË .....	137
PO TË NJOH TANI .....	149
PAS LARGIMIT .....	156